

BARBARA-BURBUQE HEIM

LOTËT E TRËNDAFILES

roman

Redaktor: **Demir Reshiti**
Recensues: **Besim R. Cengu**
Redaktor gjuhësor: **Ekrem A. Kryeziu**
Korrektura letrare: **Zana Kryeziu**
Kopertina: **B.B. Heim**

BARBARA-BURBUQE HEIM

LOTËT E TRËNDAFILES

ROMAN

SHTËPIA BOTUESE

fidani

Prizren, 2010

Arditës nga Besiana të cilën e dua pa masë, si dhe Adelinës nga Deçani e Besartës nga Mitrovica.

Po të ekzistonte një shkop magjik, me të cilin çdonjëri do të mund ta përcaktonte fatin e vet jetësor, këtë nuk do ta kishin bërë vetëm këto, por edhe shumë e shumë të tjera...!

NË VEND TË PROLOGUT

I mbusha tridhjetë vjet pa mundur t'ia shprehja dikujt atë që më mundonte, pa ia qarë hallet dikujt në mënyrë shoqërore, përveç psikologes. Mërzinë dhe mallin gjithnjë i shprehja me lot. Nuk kisha me kë të bisedoja edhe pse shumë herë kisha dëshirë dhe nevojë të shfryhesha dhe ta qitja jashtë atë që ishte fshehur në mua, sikur të ishin të mbyllur në dry në mua dhe gjatë tërë kohës mundohesha ta gjeja çelësin që mund ta hapte këtë dry. Doja t'i tregoja shoqes sime, Marijes, përjetimet e mia. Ajo më tregonte mua gjithçka që e mundonte dhe e gëzonte. Rrëfimet e saj kishin të bënin me studimet, pasi që ajo ishte studente. Ajo më tregonte gjithçka për familjen e saj. Motra nuk kishte. E kishte një vëlla dhe prindërit të cilët jetonin në Bullgari. Mua më dukej se ajo ishte e lumtur, ngase hallet e saj më dukeshin të zakonshme. Nuk guxoja t'ia hapja zemrën asaj, sepse ia kisha frikën se do të mendonte se po fantazoja ndonjë ngjarje nga filmat tragjikë. Në raste të tilla vetëm heshtja, ndërsa në brendi lukthi më bëhej si një lëmsh dhe nuk e nxirrja dot asnjë fjalë nga goja. Ajo e dinte se nuk isha me familjen time në kontakt përpos me motrën time Teutën. Laura, gjithashtu një shoqe e ngushtë me prejardhje nga Italia, nuk i kuptonte shumë gjërat. Në të vërtetë kur i tregoja diçka, thoshte se për të tingëllonte e pabesueshme dhe, sipas saj, gjëra të tilla mund të ndodhnin vetëm diku larg në Arabi por kurrsesi në Evropë. Ishin shumë pak njerëz që e dinin në të vërtetë se çfarë fshihej në zemrën time.

Sot jetoj dhe punoj në Gjermani, në një fshat shumë të vogël

afër liqenit më të madh dhe më të famshëm në këtë shtet. Punoj në një restorant të bukur. Prej se kam arritur këtu, kam punuar në restorante të ndryshme. Në fillim kam punuar te një grek në kuzhinë, ku i përgatisja gjërat që ai më urdhëronte. I qëroja patatet, i grija qepët, laja enët dhe kur nuk kishte mjaft punë, e pastroja lokalin. Kjo nuk më pengonte aspak, sepse për herë të parë fitoja të holla nga djersa ime. Edhe pse nuk dija të flisja gjermanisht, shefit nuk i pengonte dhe ishte shumë i kënaqur me punën time. Ushqimin dhe pijet i kisha falas dhe pagesën ma bënte rregullisht në dorë, sepse aty punoja në mënyrë ilegale, ngase si emigrante që isha, nuk kisha të drejtë pune. Në atë kohë jetoja në një banesë të vogël dhe të vjetër, por ishte e rregulluar. Nuk dëshiroja të jetoja nëpër shtëpitë e emigrantëve ku qëndronin njerëz të nacionaliteteve të ndryshme, shumica e të cilëve ishin si qenë të uritur dhe mezi prisnin që t'u binte një copë mishi në gojë!

Nuk kisha përkrahje nga askush, por përpiqesha që t'ia dilja me ndihmën e Zotit të madhërishëm dhe me fuqinë time. Nuk dorëzohesha sepse e kisha Zotin që e ka fuqinë më të madhe se çdokush. Më mirë do të ndihesha sikur të isha ndonjë jetime që nuk ka farë as fis, sesa unë që i kisha të gjithë, e në fakt askënd! Kur nuk e ke askënd, ke vetëm një mall që ta kesh dikë, por po t'i kesh të gjithë e të mos e kesh askënd, i ke njëqind derte e mërzi, sepse nuk të kupton askush. Lëre që nuk të kuptojnë por nuk të lënë rehat as në hallet tua. Lëre që nuk të lënë rehat në punët tua, por edhe mundohen që të ta vështirësojnë jetën sa më shumë.

I

Oh Zot, po shumë e doja! Shumë herë as gjumi nuk më merrte, duke mos mundur ta largoja mendjen nga ai. E pyesja veten nëse edhe ai mendonte për mua sikur unë për të? Ndoshta as ai nuk mund të flinte sikur unë!

– Pse nuk fle moj Trëndafile, – më zgjoi nga mendimet e thella zëri i nënës.

– Unë nuk të zgjoj në mëngjes edhe nëse vonohesh për në shkollë. E paç veten në qafë që nuk po fle!

Nuk iu përgjigja fare, sepse nuk doja që të zgjoheshin të tjerët. Pastaj, që të jem e sinqertë, nuk e mbaj mend të më ketë zgjuar dikush për në shkollë. Madje, ta them të vërtetën, më erdhi mërzi që më zgjoi nga mendimet e ëmblla...

Sa e sa net kështu i kaloja. Nuk më pritej të zbardhej drita që të shkoja në shkollë e ta shihja prapë. Që prej ditës së parë kur e nisëm shkollën, u ulëm së bashku në një bankë afër njëri-tjetrit. Mirëpo, na ndanë vetëm pas disa ditësh kur mësimi nisi ta marrë të mbarën dhe e zbuluan se të dy ishim nxënës të mirë. Asnjëherë nuk flisnim shumë me njëri-tjetrin. Jo shumë, por pothuajse aspak. Vetëm kur kishim nevojë t'ia kërkonim njëri-tjetrit ndonjë laps, vizore, gomë etj. Ah sa kisha dëshirë t'ia dëgjoja zërin e tij të ëmbël si mjalti që e nxirrte nga ajo gojë e bukur, nga ajo gojë magjike që më bënte ta ëndërroja me sy hapur. Më duket se askush nuk shkonte më me dëshirë në shkollë sesa unë. Asnjëherë nuk mungoja, madje as atëherë kur isha e sëmurë, e jo si shumë të tjerë të cilët për një ftohje të vogël, pak kollitje ose dhimbje koke, mungonin. Ndoshta shkoja aq me dëshirë, ngase qysh si pesëvjeçare kisha mësuar shkrim-leximin duke ia vjedhur abetaren vëllait dhe duke u përqendruar kur nëna dhe anëtarët e tjerë të familjes ia mësonin atij shkronjat. E tërë familja, veçmas kur bëhej fjalë për djalin, angazhoheshin që ta mësonin...

Kur i shtronin pyetje vëllait, unë ngutesha dhe përgjigjesha

para tij, apo mundohesha t'i tregoja se si duhej të përgjigjej. Nga krenaria, më xixëllonin sytë, më skuqeshin faqet dhe shkrihesha së qeshuri. Por, për fat të keq, ato çaste nuk zgjasnin shumë. Askush nuk gëzohej apo krenohej për mua, madje shumë herë më duhej t'i dëgjoja fjalët si: hajt moj, vega jote po e mëson djalin, boll se të vjen vakti edhe ty, largohu e mos pengo. Fjalën vegë nuk e kuptoja në atë moshë, ndonëse e dija se nuk ishte diçka e mirë, gjegjësisht e ndershme. Kur i mbusha gjashtë vjet, doja të shkoja në shkollë me disa vajza të hallave dhe të fqinjëve që ishin një vit para meje. Kam qarë me ditë të tëra duke e lutur nënën që edhe unë ta filloja shkollën. Babait nuk mund t'i lutesha sepse nuk ishte në shtëpi. Ai punonte larg vendlindjes dhe unë vetëm e dija se është në mërgim, pa e kuptuar se çka ishte mërgimi. Por, edhe sikur të ishte në shtëpi, nuk besoj se do të kisha përkrahje nga ai. Ai, me siguri do të thoshte se nëna ka të drejtë, mjafton t'ia fillosh vitin e ardhshëm se nuk ka kush ta përkundë beben e vogël e cila pritët të lindë pas dy-tre muajsh. Nuk pushova së qari me ditë të tëra, duke vazhduar ta lusja nënën, por kot. I premtoja se nëse më lejonte të shkoja në shkollë, menjëherë, sapo të kthehem nga mësimi, do të kujdesem për beben dhe ta përkund atë. Por, çdo gjë që thosha, ishte e kotë, sepse nuk mund ta zbusja zemrën si guri të nënës. Ishte një lloj sikur t'i lutesha një muri. Sa më shumë që nuk kisha përkrahje, aq më shumë e doja shkollën. Edhe pse nuk gëzoja përkrahje nga askush, isha nxënëse e shkëlqyer dhe me sjellje shembullore. Shkëlqimi donte të bëhej mjek, sikurse babai i tij. Atij ia blinin gjërat ku ishin më të shtrenjta dhe më të bukura. Derisa shumë nxënës të tjerë shkonin në shkollë me të njëjtën çantë për disa vite, Shkëlqimit çdo gjysmëvjetor ia blinin nga një çantë të re dhe atë, jo në librarinë e qytetit, por në qytete të ndryshme si Zagreb, Lubjanë, Sarajevë, Beograd etj., ku babai i tij shkonte nëpër seminare të ndryshme. Edhe unë vishja gjithnjë rroba të bukura dhe të reja. Më kujtohet edhe sot se kur isha në klasën e parë, kisha një palë këpucë me ngjyrë të kuqe. Aq shumë më pëlqenin sa kur i provova në shitore, edhe pse ma vrisnin

gishtin e madh të këmbës, dëshiroja me çdo kush t'i blija. Nuk i tregova nënës se më binin pak të vogla, ngase shitësja na tha se ishin këpucët e fundit. Nëna ma plotësoi këtë dëshirë, ngase tani shkoja në shkollë dhe të gjithë e dinin se vajza e kujt isha! Ah si jemi ne shqiptarët, bukën tonë e hamë, kurse dertin e huaj e bartim...

Isha krenare ngase pikërisht në atë kohë mësonim vjershën e burbuqes, të cilën e mbaj mend edhe sot:

*Sa ëmbël qesh
E vogla Buqe
I ka blerë baca
Sandale të kuqe*

*Ia urojnë shoqet
Dhe shokët e vet
Sa të bukura Buqe
I bajsh me shëndet!*

Kur dilja për ta recituar vjershën, të gjithë me përcillnin me buzëqeshje dhe sytë i mbanin te këpucët e mia të kuqe. Ndihesha shumë mirë, veçmas kur më shikonte Shkëlqimi. Mësuesin e respektoja shumë. Ai ndonëse ishte nga fshati, kishte një karizëm dhe ishte një nga mësuesit më të mirë në shkollën fillore “Vëllazërim-Bashkimi”. Në klasë ishim 31 nxënës. Ditën që na tha të renditeshim të gjithë te tabela, e mbaj mend sikur sot. Të gjithë e vështronim me sy të hapur pasi që kurrë nuk na kishte urdhëruar një gjë të tillë!

– Do t’ua ndërroj vendet. Tani e tutje do të uleni një djalë e një vajzë në banka. Jam i detyruar ta bëj këtë sepse po bëni shumë zhurmë gjatë mësimit dhe dua që nxënësit më të mirë t’u ndihmojnë atyre më të dobëtëve në mësimë...

Të gjithë ngelëm të shtangur. Asnjëri nuk fliste. Disa e kishin ulur kokën, të tjerët nuk kuptohej nëse i kishin hapur më shumë veshët apo sytë. Nadiren dhe Bylbylin i urdhëroi të ulen në bankën e

parë kah dritarja. Pranverën dhe Nysretin në bankën e parë kah dera, ndërsa, mua dhe Përparimin na urdhëroi të ulemi në bankën e parë në mes. Në mes ishte edhe tavolina e mësuesit. Përparimi ishte djali i mësuesit. Edhe vajzat tjera i uli me djem, ndërsa Shkëlqimin e uli me një djalë tjetër dhe për fat vetëm një bankë prapa meje. Ishim më pak vajza sesa djem në klasë dhe atëherë na vinte turp që të bisedonim me djem. Unë e shikoja mrrolur mësuesin që më uli me djalin e tij e jo me Shkëlqimin. Pothuajse asnjëri nuk ishte i kënaqur me ndërrimin e vendit, përveç mësuesit i cili ia arriti qëllimit që ta ndaloj zhurmën, ngase djemtë dhe vajzat nuk flisnin në mes vete dhe në klasë ishte bërë një qetësi varri. Qysh prej asaj dite fillova ta urreja Përparimin, edhe pse nuk më kishte bërë asgjë. Ta them të drejtën edhe mësuesin disa ditë nuk mund ta shikoja në sy.

Koha kalonte shumë shpejt. Dashuria për shkollën dhe Shkëlqimin rritej gjithnjë e më shumë. Kurrë nuk mund ta paramendoja veten pa këto dy dashuri. Nuk më kujtohet se cili e kishim bërë hapin e parë dhe i kishim shkruar letër dashurie njëri-tjetrit? Por vetëm e di se letrat nuk kishin të ndalur. Ato i këmbenim duke i vënë me kujdes në ndonjë libër, çantë apo xhep të tjetrit. Po të na hetonin, jo vetëm që do të na përqeshnin të gjithë, por ishte rrezik që ta kuptonin familja, e sidomos babai im, nga i cili kisha shumë frikë. Më kujtohet mirë njëherë kur ishte ai në pushim në shtëpi. Më pyeti kë e kam mësues, m'i kontrolloi librat, fletoret dhe bllokun e vizatimit si dhe librezën e notave. Më pyeti se me vajzën e kujt isha e ulur në bankë. Nisi të ulërijë kur unë, pa të keq, i thashë se mësuesi më kishte ulur në një bankë me djalin e tij.

– Dëgjomë mirë çfarë po të them!

– Kur të shkosh nesër në shkollë, i bën të fala mësuesit nga unë dhe i thua që e kam të ndaluar nga babai të ulem me djem.

Rrugës për në shkollë mendohesha se si t'ia përcillja këtë “selam” mësuesit. Isha tretur aq thellë në mendime sa për pak nuk më shtypi një makinë. U tremba nga buria e automobilit dhe zëri i një plaku i cili më tha:

– Ku i ke sytë moj vajzë, a mos të janë verbuar?

Gati e mora në qafë njeriun pa faj. E trembur nga kjo situatë, vetëm i zgurdullova sytë pa mundur ta nxirrja asnjë fjalë nga goja. Plaku kishte të drejtë. Ula kokën dhe përshpejtova hapin. Zilja kishte rënë dhe të gjithë nxënësit i kishin zënë vendet e tyre nëpër banka, duke e pritur ardhjen e mësuesit. Unë bëra sikur më dhembte barku dhe u thashë shoqeve që më duhet të shkoja deri në tualet para se të fillonte mësimi. Vërtet kisha dhimbje barku por jo nga ftohja ose sëmundja. Barku më dhembte nga inati dhe nga turpi. Që nga dera e klasës i dëgjoja hapat e mësuesit tim që vinte nëpër korridorin e gjatë të shkollës. Ai ecte me një elegancë që e dallonte nga mësuesit e tjerë. Si gjithnjë ditarin e mbante nën sjetull. U nguta ta takoja mësuesin sa më larg klasës, sepse nuk dëshiroja ta dëgjonte kush bisedën tonë. I thashë mirëdita me një zë që më dridhej.

– Mirëdita Trëndafile, – ma ktheu mësuesi ëmbëlsisht.

– Desha të bisedoj diçka me ju, – i thashë dhe nisa të flisja pa e marrë miratimin nga ai.

– Babai im ju ka bërë të fala dhe më ka thënë që të kërkoj nga ju që të mos më ulni me djem.

– Paska ardhur babai yt në shtëpi?

– Po mësues, ka ardhur para tri ditësh.

Hymë në klasë pa e folur asnjë fjalë. Të gjithë nxënësit i kishin drejtuar sytë nga unë dhe sikur më pyetnin hë Trëndafile, çka ka ndodhur, çka ke biseduar me mësuesin?... Ende pa u ulur nëpër vende, mësuesi më urdhëroi që ta merrja çantën dhe të ulesha në një bankë me Samiren. Sapo u ktheva në shtëpi, i tregova babait dhe nga shprehja e fytyrës së tij e hetova qartë se iu bë qejfi. Që nga ajo ditë e kuptova se më duhet të kem kujdes se me kë po flas dhe me kë po rri. Por në të vërtetë nuk kuptova asgjë. Një ditë Shkëlqimi ma dha një libër dhe e mora pa e pyetur fare se për çfarë ma dha, ngase nuk ia kisha kërkuar.

– Hape me kujdes Trëndafile, mos të të shoh ndonjë shoqe sepse... Shpjegimin e Shkëlqimit e ndërpreu cingërima e ziles.

Mësuesi hyri në klasë. Gjatë asaj ore nuk mund të përqendroheshia aspak në mësim. Mendtë i mbaja te libri që ma dha Shkëlqimi dhe zemra më rrihte aq fort sa më bëhej se të rrahurat e saj po i dëgjonte edhe Samirja. Për fat të mirë gjatë asaj ore mësuesi nuk më bëri asnjë pyetje dhe nuk e hetoi askush shqetësimin tim. Kur ra zilja, të gjithë dolën jashtë, përveç meje. Pranvera dhe Samirja më lutën që të dilja me to në oborr, por unë refuzova duke u arsyetuar se kisha dhimbje koke. Sapo dolën ato, e nxora librin nga çanta dhe e hapa me kujdes. Në mes të librit e gjeta një letër, të cilën, duke m'u dridhur dora, e futa në xhep me shumë shpejtësi sikur të kisha vjedhur diçka. Librin e Shkëlqimit e ktheva në bankën e tij përpara se të ktheheshin nxënësit në klasë. Zemra vazhdonte të më rrihte me ritëm të përshpejtuar, nuk e di as vetë si isha bërë kur dëgjova zërin e njërës nga shoqet e klasës, duke më thënë pse Trëndafilë nuk po i merr leje mësuesit për të shkuar në shtëpi? Shihesh se të janë skuqur faqet, me siguri ke temperaturë. Oh Zot, nuk e dija çfarë po ndodhte me mua. Mundohesha ta qetësoja veten edhe pse nuk e kisha lehtë, ngase zemra më rrihte aq shpejt dhe nuk mund të ngopesha me frymë, si ndonjë gjyshe që lëngon nga astma.

– Nëse don, e pyes unë mësuesin për ty...

– Jo, jo, – iu përgjigja Pranverës, duke ia ndërprerë fjalën.

– Nuk jam aq e sëmurë, më duhet të jem në mësim sepse nesër na pyet mësuesi me nota. Ishte fundi i vitit shkollor dhe ato ditë mbylleshin notat...

Gjatë gjithë rrugës për në shtëpi mendjen e kisha se ku të fshihesha e ta lexoja letrën. Gati në secilën dhomë ishte dikush. Në njërën falej gjyshi, në tjetrën ishin disa mysafire të gjyshes, në një tjetër ishin mbledhur pothuajse të gjithë fëmijët e lagjes me Adrianin, ndërsa në dhomën e ditës ku ishte edhe kuzhina, nëna përgatiste drekën dhe sapo më pa që arrita, ende pa i thënë mirëdita, ma gjeti një punë!

– O Trëndafilë, shumë mirë që erdhe. Merri grij qepët, pastaj shtroje tavolinën, përgatite çajin, dhe laji këto dy-tri enë që të mos

thahen dhe mblidhen më shumë...

Dy-tri enë!? Ku i ka sytë kjo nëna ime? Aty nuk ishin dy-tri enë, por ishin edhe enët e mëngjesit që më prisnin t'i laja unë. Nuk më lanë rehat, Trëndafile bëje këtë, bëje atë, shko aty, eja këtu... sikur të isha unë e vetmja në atë shtëpi. Pasi që më bombardoi më gjithë këto detyra të cilat më merrnin shumë kohë për t'i kryer, e unë mendjen e kisha te letra, i thashë;

– Nënë më duhet fillimisht të shkoj në tualet se po më dhemb barku e pastaj kthehem e i laj enët.

– Hajt, hajt shko thyeje qafen, se kurrë nuk ta pashë hairin...

E mbështetur për mur, e lexova letrën. Jo njëherë, por disa herë. Vetëm këtu isha më e qetë dhe më e sigurt sepse mund ta mbyllja derën nga prapa dhe nuk me bërtiste askush. Sa do të dëshiroja të mbyllesha e vetme në një dhomë, t'ia lëshoja zërin radios dhe ta lexoja letrën edhe disa herë. Thirrja e Mirjetës, Trëndafile ku je, më zmbropsi nga bota e ëndrrave ku isha tretur. E palosa letrën me shpejtësi dhe e futa prapë në xhep. Mirjeta më priste jashtë dhe më përqafoi duke më shtrënguar me ato duar të vogla dhe të bukura. Dy ditë e ruajta atë letër në çantë dhe e lexoja sa herë që mbetsha vetëm. Nuk kishte fjalë që nuk më pëlqente, por strofa që më pëlqente në veçanti ishte kjo:

*Nëse është nevoja
Unë për ty jap jetën
Sikurse Romeo
Që e dha për Zhylietën*

Edhe unë ia shkrova Shkëlqimit një letër dhe në të shkrova vargjet:

*Zogu e don malin,
Peshku e don detin
Të dua Shkëlqim
Më shumë se vetëvetin.*

Kështu filluan letrat e dashurisë sonë. Çdo javë këmbenim letra dhe e përjetonim dashurinë tonë pa folur shumë në mes vete dhe pa u prekur fare. Në atë moshë mjaftonin letrat se ende nuk e kishim moshën për dashuri të mirëfilltë. E ndjeja që bëja diçka të ndaluar dhe pa ma tërhequr vëmendjen dikush. Në të vërtetë një kërcënim më vinte nga babai i cili çdo vit, kur vinte në pushim nga kurbeti, ma tërhiqte vërejtjen me fjalët:

– Trëndafile ti je një vajzë e mençur, po mëson, në shkollë po të lavdërojnë, por ki kujdes mos ta dëgjoj ndonjë fjalë të keqe e të halitësh rrugëve sikur vajzat e hallkut, se për besë ta këpus kokën si zogut. Dhe kur të flas me ty dua të më shikosh në sy, a më kuptove?

Letrat të cilat m’i shkruante Shkëlqimi, i ruaja derisa e hetoja se ishte rrezik të m’i gjente dikush. Sapo e hetoja se kanosej rreziku, atëherë i fusja në shporet, sepse vetëm të djegurata ato nuk përbenin rrezik. Sa më shumë që kalonte koha, aq më shumë shtohej dashuria jonë, por njëherësh edhe frika nga familja, e sidomos nga babai im. Si të mos frikohesha kur ndodheshin raste të ndryshme që më linin shumë net pa gjumë. Si dymbëdhjetëvjeçare i kuptoja shumë gjëra, dija ta dalloja situatën kur nuk ishte e mirë. E kishte lëshuar një burrë gruan, vajza filanit kalonte me djalin e filanit, e reja e filanes është e bukur, e shëmtuar, punëtore apo dembele. Një gjë nuk e kisha të qartë, pse aq shumë u interesonin punët e hallkut dhe e kalonin gjithë atë kohë duke u marrë me fjalë të kota! Siç thotë një fjalë popullore, “bukën tonë e hamë, kurse dertin e huaj e mbajmë”. Sa më shumë zhvilloheshin biseda të tilla, aq më tepër më bërtiste nëna faj e pa faj. Shumë herë mbyllesha në ndonjë dhomë, shtiresha sikur po flija dhe qaja derisa më shtereshin lotët. I lutesha Zotit të madhërishtëm të ma merrte shpirtin e mos të më linte të vuaja për gjërat të cilat nuk i kuptoja dhe nuk më përkisnin mua. Sa do të doja ta kisha dikë me të cilin do t’i qaja hallet e mia. Por, si shumë herë të tjera në jetë edhe kjo dëshirë më mbeti pa u plotësuar. Sikur të ishte e mundur të plotësoheshin dëshirat si në përralla, do

të doja të shndërrohesha në djalë, sepse si djalë do të silleshin të gjithë ndryshe ndaj meje, e veçmas babai. Nuk do të më bërtisnin e mallkonin faj e pa faj dhe do të m'i plotësonin dëshirat. Me siguri do të krenoheshin për sjelljet e mia, për notat e mia. Nuk do të kisha frikë të tregoja se dashuroj dikë. Do të kisha shkruar lirshëm dhe në qetësi letra dashurie. Ndërsa, kështu si vajzë që jam, ende nuk e përjetova që të krenohet dikush për mua. Që të jem reale, nëna krenohej që ia bëja punët e shtëpisë dhe kujdesesha për fëmijët. Ndoshta krenohej edhe gjyshi që ia bëja kafën sipas qejfit të tij dhe kërkonte që vetëm unë t'i bëja hyzmet. Krenohej edhe gjyshja se unë ia fërkoja shpinën më së miri kur ajo lahej dhe thoshte, dora e Trëndafilit të kënaqë. Krenohej edhe motra dhe thoshte dua të fle me Trëndafilin se ajo kurrë nuk ma ngre jorganin... Po unë, me kë dhe me çka të krenohem? Asnjëherë nuk pushova duke ëndërruar se një ditë do të bëhemi një çift shembullor unë dhe Shkëlqimi. Së pari do ta kryejmë shkollën fillore, pastaj do të regjistrohemi bashkë në gjimnaz dhe do t'i vazhdojmë studimet. Shkëlqimi do të bëhet mjek, ndërsa unë avokate. Në këtë mënyrë mund t'u ndihmoj atyre që u shkelen të drejtat. T'u ndihmoj atyre të cilat nuk kanë pasur mundësi të shkollohen, atyre që janë të varfër dhe kanë nevojë për ndihmë, por nuk kanë të holla për të paguar. Ëndërroj që gjatë studimeve të fejojemi, të mund të takohemi lirshëm dhe një ditë të bëhem nusja më e lumtur në botë. Nuk do të bëhem vetëm avokate, por edhe grua dhe nënë e mirë për familjen time. Do ta krijojmë një familje të vogël...

Është shumë mirë që nuk e dimë se çka na pret në këtë jetë. Ajo stinë e pranverës ishte ndryshe, jo si të tjerat, thjeshtë ajo pranverë ishte e jashtëzakonshme! Shkuam një ditë të gjithë te fotografi i cili nuk gjendej larg shtëpisë sonë. Mirjeta dhe Adriani, për fat të mirë, ishin ende të vegjël dhe nuk e kuptonin se çka po ndodhte. Nuk e kuptonim as unë e Teuta pse ishim të gjithë aty. Fotografi na fotografoi të gjithëve me radhë dhe mbasi dolëm jashtë, e pyeta nënën pse ishin këto fotografi dhe pse nuk u fotografuam njëherë të

gjithë së bashku? Oh më mirë mos të isha gjallë, – u përgjigj nëna. Një përgjigje e paqartë por me domethënie. Në fytyrën e saj vërehej mllefi, mërzia, dëshpërimi, pakënaqësia, aq sa dukej sikur gjendej para një pushkatimi. Edhe pse kisha dëshirë ta vazhdoja bisedën, e mbylla gojën deri në shtëpi, apo më mirë të them tërë ditën, sepse isha e mësuar në situata të tilla dhe më duhej të heshtja.

Erdhi babai në pushimet e verës. Këtë herë u përzien gëzimi me frikën, si të ishin binjakë. Mbas tri javësh ishin mbledhur të gjitha hallat dhe fqinjët. Disa prej tyre kishin ardhur për darkë, ndërsa të tjerët kishin ardhur pasdarke për të pirë çaj e kafe. Por këtë herë kishin ardhur edhe gratë e fqinjëve, të cilat nuk vinin herët tjera për ta vizituar dhe përcjellë babain.

Mbasi shkuan mysafirët dhe në shtëpi mbetëm vetëm me të afërmit, rastësisht e ndjeva hallën e madhe duke i thënë nënës sime: inshallah nuk mërziten fëmijët pa ty. Sytë si vetëtima m'u drejtuan nga nëna, sytë e të cilës ishin të mbushur me lot. Fytyra e saj e zbehtë si limoni sinjalizonte pakënaqësinë që ajo e ndjente si nënë. Si një nënë që ndahej nga fëmijët e saj. Deshi të thoshte diçka, por i ngeli vetëm goja e hapur. Edhe pse kisha frikë nga babai, në këtë rast nuk munda ta ndaloja veten. Emocionet e mia ishin më të forta se kurrë më parë. Lotët nuk më ndaleshin dhe faculeta me të cilën i fshija ato, ishte bërë qull. Zemra më rrihte aq shumë sikur donte të dilte nga trupi im i vogël që sapo kishte nisur të zhvillohej.

– Ju po na lini si jetimë.

Zëri më dridhej, frymëmarrja më vështirësohej. Deri tani isha pa babë, tani po mbes edhe pa nënë, në duar të huaja. Pse, pse na keni lindur dhe po na lini vetëm në shtëpi...? Ende pa e përfunduar fjalinë, ndërhyri babai:

– Nuk po ju lëmë vetëm. E keni gjyshen, gjyshin, hallat, dhe ju duhet të shkoni në shkollë.

Vetëm e shikova me urrejtje dhe nuk e di nëse dëshiroja në atë çast të ishte ai i vdekur apo unë? Të ishte ai i vdekur, do ta kisha vetëm një dëshirë, ta kisha një baba që do të më donte dhe më

mbronte, të më falte ngrohtësinë e prindit. Të ulem në prehrin e tij dhe të kënaqem derisa të m'ï ledhatojë flokët. Asnjëherë nuk pata fat ta shuaj urinë dhe mallin që ma zymton ditën dhe ma shkatërroi jetën.

Ishte ditë e shtunë. Edhe pse dielli rrezatonte, nuk ndjeja kurrfarë ngrohtësie. Zemra më ishte ngrirë. E ulur në shkallë shikoja babain që i ngarkonte valixhet në makinë. Ishte veshur mirë sikur të shkonte në ndonjë dasmë. Në shtëpi dëgjoheshin shumë zëra por vetëm njëri depërtonte si shigjetë në veshin tim: Shko ti mami se unë dua të rri me Trëndafilin në shtëpi. Oh Zot i madhërishtëm. Ende nuk më ishin terur sytë që nga mbrëmë, lotët vazhdonin të më rridhnin rrëke.

– Trëndafile, më fshih diku, derisa të shkojnë këta, diku ku nuk mund të më gjejë askush. Pse po rri ulur në shkallë, zgjohu ndërmerr diçka. Unë dua të rri me ty...

Dy duart e saj të vogla më shtrëngonin fort rreth qafës ndërsa kokën e kishte mbështetur në fytyrën time. U bashkuan lotët e saj dhe të mitë sikur bashkohen dy përroska dhe formojnë një lumë. Nuk dija se si t'ÿ përgjigjesha lutjeve të saj. Vetëm e shtrëngova dhe i pëshpërita në vesh që të mos qante se pastaj do të na dhembte koka të dyjave. Asnjëherë nuk e kisha përjetuar dhimbjen e shpirtit, vetëm e dija që fjala shpirt ka një domethënie të madhe dhe shprehej në raste të rralla. Atë ditë i lutesha Zotit që të sëmuresha, të alivanosesha apo të ndodhte diçka që mund t'ï ndalte prindërit e mi që të mos shkonin, të mos më ndanin nga motra ime e vogël të cilën e doja me shpirt. Pse nuk ma mori Zoti shpirtin para disa vitesh kur isha e sëmurë?!

Më kujtohet se nëna dhe gjyshi më patën dërguar te mjeku i cili më kishte përshkruar barna dhe injeksione të cilat m'ï jepte një motër medicinale në shtëpi. Isha shumë e ligë dhe e këputur sa që nuk mund të ecja deri në ambulancë. Një mëngjes herët kur gjendja më ishte keqësuar tej mase, erdhën më morën me taksì në shtëpi dhe më dërguan në ambulancë. Kur hymë aty, të gjithë ma lëshuan radhën kur e panë se në çfarë gjendje isha. Nëna hyri në dhomën e

mjekut. Mjeku ishte një internist i njohur serb, i cili punonte vetëm nga dy orë në ditë.

– Ky është fëmijë i vogël, pse nuk e keni sjellë më herët zonzë, tani është ora tetë kurse për fëmijët punojmë nga ora shtatë, ndërsa nga ora tetë deri në nëntë për të rriturit, – tha mjeku në gjuhën e tij. Nëna vetëm i rrudhi krahët, pa e folur asnjë fjalë.

– Merreni vajzën dhe ejani brenda, – tha mjeku, kur e pa se në çfarë gjendje isha katandisur. Një burrë i fuqishëm më kapi ngrykë dhe më futi në dhomën e mjekut, ashtu gjysmë të vdekur. Më preku më dorë në ballë dhe më pyeti pse nuk ec vetë. Unë nuk iu përgjigja fare?

– Pse nuk e keni sjellë vajzën më herët zonzë, a nuk po e shihni se është në rrezik jete?

– Po zotëri, e kemi pasur te mjeku i fëmijëve dhe ai ia ka përshkruar këto lloj barnash dhe injeksionesh, të cilat ia kemi dhënë dy herë në ditë, por, si duket, nuk i kanë ndihmuar asgjë.

– A ka vajza babë?

– Po zotëri. Por burrin nuk e kam në shtëpi, ai punon në Zvicër. Ky është vjehri im, nëse duhet diçka.

– Vajzën duhet me urgjencë ta dërgoni në spital të Gjakovës. Keni pasur fat që vajza është ende e gjallë, por ekziston rreziku që të mbetet e palëvizshme dhe pa vetëdije, sepse ka kallje të trurit. Derisa unë ta përgatis udhëzimin dhe t'i bëj letrat gati, siguroni disa gjëra më të nevojshme për vajzën, – ishin fjalët e mjekut.

Më kujtohet vetëm se më ishin mbledhur shumë njerëz te koka dhe dëgjoheshin zëra të shqetësuar, dëgjohej alarmi i autoambulancës dhe zëri i nënës që fliste diçka pa lidhje, vetëm që të më mbante të zgjuar. Shumë rrallë më kishte rastisur të dëgjoja fjalë kaq të ëmbla nga ajo, të cilat më shumë më vënin në gjumë sesa më mbanin zgjuar...

E tash po më lë vetë në shtëpi. Edhe pse aq shumë qaja, nuk ndodhte asgjë. As unë nuk sëmuresha e as prindërit nuk bindeshin që të mos shkonin. Të gjithë ishin të mbledhur afër makinës. Së

pari filluan të përshëndeteshin me nënën, pastaj me vëllanë dhe në fund me babain. Më Mirjetën nuk u përshëndet askush. Na ndanë edhe pse e kishim shtrënguar njëra-tjetrën aq fortë. Kur u largua makina dhe u mbyll dera e oborrit, kisha një ndjenjë që nuk mund ta përshkruaja. U ula në shkallë të shtëpisë dhe futa kokën në mes të dy gjunjëve. Lotët vazhdonin të më shkonin rrëke. Kisha mbetur si një zog i lënduar që priste t'i ndihmonte dikush.

– Eja hyr me ne brenda në shtëpi, a nuk po të vjen gjynah prej Teutës dhe Adrianit që janë më të vegjël se ti? Mos bëj kob se i ke prindërit në rrugë të gjatë e u ndodh diçka. Zëra të ndryshëm ishin drejtuar nga unë dhe më fajësonin pse qaja.

– Lërmëni të qaj, dua të jem vetëm.

Kjo fjalë më doli si shigjetë nga goja. Për një çast mendova se më erdhi gjynah për Teutën dhe Adrianin, por s'mund t'i ndalja lotët. Pse nuk u erdhi gjynah dy prindërve të na lini vetë në shtëpi, t'i braktisin këta shpirtra të vegjël, t'ua marrin lumturinë dhe t'ua presin gëzimin. Të mos kenë me kë ta ndajnë as gëzimin e as hidhërimin, të mos kenë kujt t'i drejtohen kur të jenë të etur e të uritur, të mos kenë kujt t'ia shprehin dëshirën e as mallin. Atyre nuk u vinte keq për fëmijët e vet, kurse mua si dymbëdhjetëvjeçare duhej të më vinte keq! Çdo i rritur ka qenë një herë fëmijë. Fëmijët do ta kishin më lehtë sikur të rriturit do t'i kuptonin ata se çfarë dëshironin nga jeta.

Prindërit na telefononin një herë në javë. Arsyetoheshin se nuk po na thërrasin më shpesh ngase u bëhej shtrenjtë dhe gjoja nuk duhet t'i bënë telashe xhaxhait në shtëpinë e të cilit ishte telefoni. Në fakt edhe babai im e kishte bërë kërkesën për telefon, madje edhe i kishte paguar paratë para shumë vitesh, por nuk na e kishin vendosur telefonin, pasi që babai nuk kishte të njohur. Ata pak njerëz që i njilhte – i qitnin kushte, kërkonin që t'u sillte diçka nga Zvicra, si kafe, ndonjë orë dore të shtrenjtë apo t'ua gjente ndonjë punë.

II

Letër nënës

Mirëdita e dashura nënë, ka kohë që nuk të kam shkruar letër, por ti e di se ma keni ndaluar vetë qysh prej asaj dite që je mërzitur shumë dhe babai të ka dërguar në spital. Ndoshta ti nuk e ke ditur, por mua më kujtohet shumë mirë kur babai më ka thënë në telefon që të mos shkruaj më letra sepse kur po i lexon ato mami po mërzitet shumë dhe pastaj po i dhemb koka. Ne ju marrim në telefon çdo fundjavë...

Nuk më mori gjumi atë natë asnjë minutë duke u menduar. Gjithkrah më shkonte mendja. Isha shumë e mërzitur që për shkakun tim sëmurej nëna. E mërzitur isha edhe pse nuk guxoja më të shkruaja. Ndonëse bisedonim me telefon, nuk ishte gjë e njëjtë, sepse nëpërmjet letrave mund të shprehesh plotësisht. Do të më vinte shumë keq nëse kam vepruar gabimisht. Qëllimisht nuk e lëndoj askënd, e aq më pak anëtarët e familjes dhe të gjithë ata që i dua.

Më fal nëna ime e dashur, – desha ta vazhdoja fjalinë, por lotët ma turbulluan shikimin dhe e ndërpreva shkrimin. Mendimin e vazhdova ta shprehja me anë të lotëve derisa nisi të më dhembte koka. Unë e Shkëlqimi kurrë nuk do ta lejojmë që të na ndodhë një gjë e tillë. Kurrë nuk do t'i lëmë kështu vetëm fëmijët tanë. Nuk do t'ua ndalojmë atyre që të shprehen kur dhe si të duan. Nuk do t'ua ndalojmë atyre që të shkojnë në pushime me shoqërinë. Nuk do t'ua ndalojmë atyre të vishen siç u pëlqen. Sidomos vajzat do t'i përkrahim në çdo aspekt. Fëmijët tanë do t'i kenë të gjitha të drejtat e nevojshme për ta përjetuar një fëmijëri të lumtur. Kurrë nuk do t'i rrahim apo ofendojmë që t'u shkaktojmë lëndime shpirtërore. Nuk do të lejojmë që t'ua prishë dikush atyre gëzimin engjëllor. Çdo fëmijë është një lloj engjëlli. A nuk është mëkat t'ua turbullojë kush

jetën e tyre që njëherësh është edhe jeta jonë. Fëmijët janë dhurata e Zotit të madhërishtëm që na i ka falë si dhuratë të dashurisë... Nuk ka një botë më të sigurtë dhe më besnike se bota e fëmijëve. Kjo është një botë plot buzëqeshje, ku gënjeshtria dhe tradhtia nuk kanë vend...

Sot është dita e Bajramit. Unë, Ardiani dhe Teuta e presim Bajramin e parë pa nënën. Në mbrëmje i kam përgatitur rrobat e reja të cilat do t'i veshim nesër në mëngjes, pasi të jemi larë. Nuk janë krejtësisht të reja sepse i kemi veshur edhe një herë kur halla e madhe i ka fejuar dy djemtë. Ishte një festë e madhe sa një dasmë. Defi dhe muzika ia lëshonin rendin njëra-tjetrës si Bajrami i Madh të Voglit, ndërsa pothuajse çdonjëri ishte futur thellë në botën e këngës dhe valleve. Edhe unë isha bërë pjesë e kësaj bote. Por rrobat e reja i kemi veshur vonë pasdite që të mos i përlyenim. Gjyshërit nuk do të bërtisnin për këtë, por nuk do të na blinin as rroba të reja. I pastrova të nesërmen menjëherë dhe atë me dorë, sepse frikësohesha ta përdorë rrobarësen, sepse nëna nuk më kishte treguar se si përdoret. Kur më pa gjyshja duke i pastruar ato rroba me dorë, m'i dha edhe dimitë e saj për t'ia larë. I hekurosa, i palosa mirë dhe i futa në dollap, ku do të rrinim deri për Bajram. Derisa gjyshi kishte shkuar për ta falur namazin e Bajramit, ne u lamë njëri pas tjetrit, ndërsa unë dhe Teuta i ndihmuam gjyshes për ta përgatitur sillen që do ta hanim sapo të kthehej gjyshi nga xhamia. Gjyshja kishte përgatitur ushqim të begatshëm “nga çorba deri në sytliash”. Mëngjesi kaloi shpejt. Kur gjyshi u kthye në shtëpi, ia uruam njëri-tjetrit festën e Bajramit dhe pastaj u shtrua sofa dhe para se të nisnim të hanim të gjithë, me zë të ulët bëmë bismil-lah. Ushqimi kishte shije shumë të mirë por në sofër kishin ngelur disa vende të zbrazëta. Heshtjen që mbretëronte, e thyente gjyshja me pyetjet se a na pëlqenin gjellët që na ka përgatitur ajo dhe ku do të shkonim së pari për të bërë Bajram. Prisnim që të na thërrisnin prindërit nga Zvicra pas sillës së Bajramit. Të tre së bashku shkuam fillimisht te halla e madhe e pastaj edhe te të tjerat. Ishin gjithsejtë gjashtë apo shtatë shtëpi ku duhej të

shkonim për Bajram, kryesisht te hallat dhe fqinjat, ndërsa dajallarët dhe tezet ishin larg nëpër fshatra. Disi nuk më kalonte koha, nuk më shkohej askund por as nuk më rrihej në shtëpi. Pasditen e kalova me mendimin se Bajramin tjetër do të jenë këtu edhe prindërit ose do të na marrin edhe ne në Zvicër. Zvicrën e paramendoja si një vend të bukur, plot gjelbërim dhe të pastër. Ëndërroja syhapur shkollën ku do të mësoja, një shkollë e madhe dhe e bukur, me fushë dhe sallë të sportit, me mensë, ku në kohë të pushimeve mund të hanim të gjithë çfarë të donim e jo si këtu te ne në Kosovë, ku ata që kanë të holla blejnë byrek, qofte apo suxhuk, ndërsa ata që nuk kanë të holla, pushimin në mes të dy orëve e kalojnë në klasë apo në ndonjë skaj të oborrit, duke pritur derisa të bie zili e të vazhdojnë mësimin me barkun bosh.

Edhe dy javë do të më vijë prindërit në pushim, ndonëse ende nuk është koha për pushime verore. Po gëzohem shumë për Mirjetën, e sa për të tjerët nuk kam ndonjë ndjenjë prej se ma kanë ndaluar t'u shkruaj. Sa i përket pushimeve verore, nuk po gëzohem shumë, sepse po e kryejmë klasën e tetë dhe pas kësaj do të na ndahen rrugët e jetës. Disa prej nesh do ta vazhdojnë shkollimin e mesëm, ndërsa disa të tjerë do të detyrohen të mbyllën në shtëpi në moshën më të mirë. Nuk e di se çfarë do të ndodhë me mua. Ndoshta do të na marrin edhe ne në Zvicër, e nëse jo, do të shkoj në gjimnaz me Shkëlqimin. Unë do të dëshiroja më tepër që t'i kisha familjen këtu, ta vazhdoja shkollimin dhe të isha afër Shkëlqimit. Edhe dy javë do ta di saktësisht se çfarë drejtimi do të marrë jeta ime. Po përpiqem të mbes optimiste, ndonëse deri më tani nuk kam pasur fat, sidomos për gjërat e rëndësishme. Në kokën time i kam hartuar të gjitha planet. Sapo ta përfundoj shkollimin e mesëm, do të fejojhem dhe martohem me dashurinë e jetës sime, me Shkëlqimin. Çdo ditë që po kalon, dashuria ndaj tij po më rritet edhe më shumë. Në janar të këtij viti ia shkrova një letër dhe i propozova që të shkojë në shkollë gjysmë ore para të tjerëve. Në vend të orës shtatë, të takohemi në gjashtë e gjysmë, që të mund të rrimë së bashku pa asnjë pengesë.

Ndoshta edhe do të puthemi për herë të parë! Disa ditë para kësaj, Shkëlqimi ma kishte shkruar një letër dashurie dhe disa vargje të cilat më bënë aq shumë përshtypje sa që nuk do t'i harroj edhe kur të bëhem gjyshe. Edhe tani kur po i kujtoj, po më rrëqethet çdo pjesë e lëkurës sime. Kjo ishte dëshira e Shkëlqimit e shprehur në vargje:

*Kam një dëshirë
Dhe është shumë e thjeshtë
Me të puth njëherë
Tjetër s'kisha deshtë*

Natën para se të takohemi nuk më merrte gjumi. Mendjen e kisha te takimi ynë i nesërm, kur për herë të parë kisha vendosur ta puthja Shkëlqimin. Buzët e tij të njoma do të puthiten me të miat. Do t'i them hapur 'të dua', do t'i tregoj këtë herë se sa e dashuroja me të vërtetë. M'u duk një natë e pafund dhe mezi prisja të agonte mëngjesi. U zgjova pa bërë shumë zhurmë, i lava sytë dhe dhëmbët dhe i veshja rrobat që i kisha bërë gati në mbrëmje. Kur u nisa të dal vjedhurazi, dëgjova zërin e Teutës:

– Trëndafile është ende herët për shkollë, – ora është gjashtë, e jo shtatë.

– Teutë, mos fol me zë të lartë sepse i zgjon të tjerët. Sot më duhet të shkoj më herët në shkollë sepse nuk kam ditur t'i kryej disa detyra dhe ndoshta e gjej dikë në klasë që më ndihmon.

Dola jashtë, e mbylla derën pa zhurmë. Ishte dimër, binte borë dhe bënte shumë ftohtë. Shkollën nuk e kisha larg. Frikësohesha kur kaloja pranë hotelit sepse aty mblidheshin të gjithë qentë e qytetit për të gjendur ushqim. E hapa derën e klasës ngadalë, drita ende nuk ishte e ndezur, ndërsa stufa bubullonte nga zjarri. Hyra brenda, çantën e çova te vendi im, mora një karrige dhe u ula pranë stufës dhe kur po planifikoja ta merrja një karrige tjetër, u hap dera dhe hyri Shkëlqimi në klasë.

– Mirëmëngjesi Trëndafile.

– Mirëmëngjesi Shkëlqim.

Oh Zot, zemra më rrihte me aq fuqi sa më behej se do të më dilte nga vendi. Shkëlqimi e çoi çantën në vend të vet, e mori një karrige dhe erdhi e u ul pranë meje te stufa. E shihnim njëri-tjetrin në sy me plotë dashuri. Nisëm të bisedonim për detyrat dhe shkollën, e dikur kaluam në temën e dashurisë.

– Shkëlqim, më pëlqeu shumë letra që ma kishe shkruar. Nuk kam mundur të fle disa net, – dhe pa e përfunduar fjalën, trupin ma përshkoi një drithërimë dhe m’u duk se po digjesha si zjarr.

– Edhe ti ma ke shkruar një letër shumë të mirë. Më së shumti më ka pëlqyer strofa e tretë:

Emrin tënd Shkëlqim

Me shkronja të arta e kam shkruar

Derisa të jem gjallë

S’kam për ta harruar

– Edhe nëse shkon në Zvicër, nuk do të më harrosh?

– Jo Shkëlqim, nuk do të të harroj asnjëherë, pavarësisht se ku do të jem. Disi do ta gjejmë një rrugëdalje që të komunikojmë me njëri-tjetrin, por të lutem letrat që unë t’i shkruaj, digji në zjarr apo bëji copë e grimë, që të mos mund t’i lexojë askush. Kam frikë se mos i gjen dikush, e kupton babai im, pastaj më del problem i madh.

Ai e afroi dorën te gjuri im dhe më tha; familja ime e di për këtë punë. Nëna ime m’i ka gjetur disa letra, por mos ke frikë se nuk i tregon askujt. Më besoj, ajo më ka premtuar.

Edhe pse kisha frikë, edhe pse e kisha të ndaluar, edhe pse ndoshta gaboja, kisha dëshirë që të puthesha me Shkëlqimin. Disi prisja që të bashkohen buzët tona, prisja që t’ia ndieja aromën e ngrohtë të frymës së tij në buzët e mia. Nuk kam puthur asnjëherë më parë në një mënyrë të tillë por e di se do ta puth me shumë ndjenja. Do të jenë puthje të paharruara... Derisa unë prisja me padurim që

Shkëlqimi ta bënte hapin e parë, të më puthte siç e kishte shprehur dëshirën, u hap dera e klasës dhe hyri Ardi, pas tij edhe Nysreti dhe kështu brenda pak minutash u mbush klasa plot, e unë e Shkëlqimi nuk arritëm të puthemi. Nuk e shfrytëzuam këtë shans që e patëm. Ai kishte shprehur dëshirë të më puthte, por nuk e kuptoj pse priti aq gjatë e nuk e bëri atë. Nuk guxoi apo nuk deshi? Ndoshta kam faj edhe vetë që nuk e bëra hapin e parë, ndoshta edhe ai ka pritur që unë ta puthja, të bëhesha më e guximshme?!

III

Isha pesëmbëdhjetëvjeçare dhe nuk doja asgjë më shumë se shkollën dhe Shkëlqimin. Nuk më interesonte tjetër djalë përveç tij. Sa për Halimin nuk e dija se ekzistonte. Mjaftonte që Shkëlqimi ma kishte vërë syrin mua, më kishte përcjellë me ditë, javë dhe muaj të tërë. Më kishte vënë re kur isha duke u kthyer nga shkolla për në shtëpi. Ai kishte qenë me një fqinjë të hallës sime duke shëtitur në rrugën që të çon drejt parkut, afër të cilit ishte shtëpia ime. Unë vetëm i kisha përshëndetur, kuptohet për hir të fqinjit të hallës dhe kisha vazhduar rrugën time. Asnjëherë nuk ndalesha rrugës me dikë që nuk e njihja. Nga babai e kisha të lejuar të takohesha vetëm me ndonjë shoqe. Unë, Halimin nuk e mbaja mend, por ai mua për fat të keq, po. E kishte pyetur Bekimin për mua, e kishte pyetur prej nga më njihje, bija e kujt isha dhe në cilën shkollë shkoja? Që nga ajo ditë jeta ime mori kahe tjetër...

Tani e kam kuptuar pse po vijnë prindërit në pushim. Ata i ka informuar dikush që do të vijnë për ta kërkuar dorën time. Nga njëra anë po më vjen mirë që ende pa i mbushur të pesëmbëdhjetat po më lavdërojnë në shumë vende, gjë që me siguri nga kjo krenohen prindërit e mi, por nga ana tjetër unë nuk dua të fejojhem e as të martohem, të paktën jo pa e përfunduar shkollimin.

Ishte e shtuna e parë e muajit dhe mbanim mësim. Prindërit kanë arritur para orës gjashtë të mëngjesit. U përshëndetëm të gjithë me radhë. Ndonëse ishte herët, ne të gjithë i prisnim të zgjuar. Pas një ore unë e Teuta shkuam në shkollë. Ishte pranverë, dielli ngrohte dhe cicëronin zogjtë. Rrugët ishin të mbushura me njerëz, ngase të shtunave ishte ditë tregu në qytetin tonë. Më dukej një ditë krejt ndryshe. Mbase jam e gëzuar që më kanë ardhur prindërit dhe do të çmallej me Mirjetën e cila ishte rritur bukur shumë. I kishim vetëm katër orë mësim. Në orën e tretë kishim me kujdestarin e klasës, lëndën e historisë, ndërsa në të katërtën edukatë fizike. Vendosa ta

pyes kujdestarin se a do të më lejojë të shkoj një orë më herët në shtëpi.

– O sa mirë që të paskan ardhur prindërit, po gëzohem për ty. Shko lirisht se unë i them profesor Hamzait që të të arsyetojë. Mos harro bëji të fala babait tënd nga unë.

E falënderova kujdestarin dhe derisa të tjerët përgatiteshin për orën e fizikulturës duke mbathur pajisje sportive, unë mora çantën dhe u kujdesa që të mos harroja asgjë.

Çokollatën që ma kishte sjellë nëna, e ndava në disa pjesë dhe ua dhashë shoqeve e shokëve të klasës, ndërsa Shkëlqimit ia dhashë një pjesë më të madhe. U përshëndeta me të gjithë. Shoqet i përqafoja ndërsa shokëve ua zgjatja dorën. Më bëhej sikur nuk do t'i shihja më kurrë edhe pse të hënën më duhej të vija prapë në shkollë. Nuk di si ta përshkruaj me fjalë një ndjenjë të tillë.

Javën e kaluar kisha ëndërruar një ndarje të ngjashme... Sapo hyra në derë të oborrit, e takova Mirjetën duke luajtur me disa lojëra të reja që i kishte sjellë nga Zvicra. Lëshova çantën në shkallë dhe iu bashkëngjita asaj në lojë. Doja të kaloja sa më shumë kohë me të, ta dëgjoja duke folur e qeshur, doja të çmallesha sepse kishte kaluar mjaft kohë që nga dita që na ndanë. Nga dritarja e hapur e katit të dytë dëgjohej zëri i lartë dhe të qeshurat e hallës dhe gruas së xhaxhait. Secilën herë që babai vinte në pushim, shtëpia mbushej plotë me mysafirë, ato vinin ende pa na lejuar që të çmalleshim ne me prindërit...

– Po don të bëhesh nuse, nuk duhet të luash më me fëmijë. Duhet të ulësh e ta përgatitësh çejzin, tash e tutje nuk ka më detyra të shkollës, tani duhet t'ua shtiesh krahun punëve të shtëpisë. Duhet të mësosh të gatuash bukë e jo të mësosh për provime. Nuk ka më ekskursione, nuk ka takim me shoqe, do të behësh nuse dhe duhet të zgjohesh herët...

– Këqyre ti punën tënde dhe familjen tënde, se s'është kah të pyet askush, – ia ktheva me pezëm gruas së xhaxhait, sepse më

dukej se nuk do të ndalej ndryshe kjo shtrigë.

E kam grua të xhaxhait dhe në vend se ta kem si një nënë të dytë, kjo çdo herë ma helmon zemrën, dhe prej se e mbaj mend nuk ka ndryshuar. Në fillim kur pati shkuar nëna me Florentin në Zvicër, kjo shtrigë e pashpirt, sa herë që më takonte dikund, vetëm më thoshte: ju ka lënë nëna juve si jetimë, ata vetë po jetojnë në Zvicër vetëm me një vajzë dhe një djalë, hanë e pinë çka t'u dojë shpirti, blejnë rroba ku janë më të mirat dhe më të shtrenjtat, në vend të ujit pinë lëngje të ndryshme..., ndërsa juve ua bëjnë qejfin vetëm me fjalë, ju sjellin cukla që kanë mbetur tepricë apo rroba të bartura që atje më nuk i përdor askush!

Kjo vërtet i ngjan një shtrige dhe diçka që unë nuk e kuptoj. Ditë më parë kam ëndërruar se kisha gjetur një shumë të madhe të parave metalike dhe kisha marrë aq shumë nga to sa që xhepat e pantallonave nuk m'i nxinin. Kur ia tregova ëndrrën gjyshes, ajo më tha se paratë janë fjalë oj Trëndafille, dhe atë, jo fjalë të mira. Ndoshta për ty gjyshe se ti iu beson këtyre gjërave, por për mua janë pallavra që nuk ua vë veshin fare.

Inshallah!, – ma ktheu gjyshja.

Disi fillova të shqetësohesha kur më ranë ndërmend këto fjalë. Jo që ndihesha fajtores, por se e dija se si do të reagonte babai. Babai im në pamje të parë dukej modern dhe demokrat dhe ta merrte mendja se ky njeri është i kuptueshëm. Por kjo ishte vetëm një pamje e jashtme e tij siç nuk është ar çdo gjë që shkëlqen! E merrja veten me të mirë duke menduar se po e teproja me këto mendime. Unë jam ende e re dhe ndoshta nuk di t'i dalloj mirë njerëzit, ndoshta nuk po i kuptoj ata, ndoshta nuk e di se çfarë qëllimi fshihet pas këtyre fjalëve. Ndoshta nuk di ta ndaj të vërtetën nga e pavërteta, të drejtën nga e padrejta, sinqeritetin nga josinqeriteti...

Kjo ditë e shtunë e ndryshoi tërësisht jetën time. Duke u përpjekur ta harroja çfarë më tha ajo shtrigë, mundohesha që t'ia bëja qejfin Mirjetës e cila kërkonte që ta luhatja në hulaqe, të cilën na e kishte ndërtuar gjyshi para disa ditësh. U hap dera e oborrit dhe hyri

brenda babai. Ishte i mrrolor dhe fytyra i ngjante qiellit të errët para vetëtimave dhe murmurimave. Këtij njeriu nuk i dihej. Ai, shumicën e kohës ishte kështu dhe shumë rrallë e shihje në humor. Kaloi pranë meje dhe Mirjetës pa e folur asnjë fjalë. Na shikoi mrrolshëm sikur të mos ishim fëmijë të tij. U ngjit shkallëve përpjetë dhe vetëm pak çaste pasi hyri brenda, nëna doli e më thirri nga ballkoni.

– Trëndafile, eja lart se po të thërret babai.

Trupi m'u lig dhe këmbët filluan të më dridheshin. I thashë Mirjetës të luhatet vetëm dhe i premtova se do të kthehem menjëherë, sapo ta shoh se për çfarë më kërkonte babai. E putha në të dy faqet dhe shkova.

– Eja ulu këtu tek unë Trëndafile, – më urdhëroi babai.

Pa e folur asnjë fjalë shkova dhe u ula afër tij. Në njërën anë ishin të ulura halla e madhe dhe nëna. Kur më tha të ulem, u gëzova sepse edhe ashtu më dridheshin këmbët. Babai nxori nga xhepi një kartë postare me simbole të Kroacisë, e ktheu në anën e kundërt ku lexohej qartë se ishte adresuar në shkollën time.

– Lexoje mirë Trëndafile se çka po shkruan këtu: “Trëndafile, nuk po mund të të harroj edhe pse jam larg teje. Mendja më rri vetëm te ti, shpresoj se do të të shoh sa më shpejt. Të përhëndes nga Kroacia – Halimi”.

– Kush është ky djalë, kush është ky Halim?

– Babi, unë vetëm e di se djali i atyre miqve që ishin dje për ta kërkuar dorën time quhej Halim, asgjë më tepër nuk di.

– Si nuk di më shumë, si mund të të dërgojë kartolinë dikush që nuk e njeh?

– Për besë babi unë vetëm e njoh si figurë sepse më ka përcjellë disa herë kur lëshohesha nga shkolla, as nuk e di kush është, as ku e ka shtëpinë. Asnjëherë nuk kam folur me të e as nuk e kam takuar. Për besën e Zotit të madh se nuk po të gënjej.

– A e di që ta këpus kokën si të pulës me ndie diçka?

– Po babi..., fjala më mbeti në fyt, lotët dhe gjaku u përzien, faqja e djathtë më digjej si zjarr nga shpulla e babait. Nëna nuk

foli asgjë vetëm i shkonin lotët nëpër faqe. E solli një faculetë dhe derisa unë mundohesha ta fshija fytyrën dhe ta ndalja gjakderdhjen nga hunda, babai më kërcënohej dhe më shumë. Prisja të më godiste prapë, por për fat brofi dhe doli nga dhoma, e mbas tij edhe halla e cila nuk foli asgjë. Unë hyra në banjë, lava fytyrën, ndërsa gjaku vazhdonte të më rridhte nga hunda. Nëna ma dha edhe një faculetë tjetër, më tha të shtrihem dhe më mbuloi me batanije.

– Eh moj Trëndafile, inshallah nuk e ke fatin sikur timin. Kur isha vajzë më rrihte babai, ndërsa kur u martova burri. Dajaku kurrë nuk m’u ndal.

I mbylla sytë dhe shpresoja se kjo ishte vetëm një ëndërr e keqe. Pas ca kohe m’u ndal gjakderdhja, por kisha dhimbje të madhe koke dhe më behej se koka po më ndahej në dy pjesë. E mbylla dritaren që të mos më pengonin zërat që depërtonin nga oborri në dhomë. U mbulova prapë me batanije dhe, ndonëse ishte vapë, unë kisha ethe. Dëshiroja të më merrte gjumi përgjithmonë apo të paktën babai të kthehej menjëherë në Zvicër. Për herë të parë dëshiroja që babai të vdiste apo të zhdukej në ndonjë formë! Jo që nuk e doja, jo që nuk më dhimbsej, por sikur të mos kisha baba do të kisha vetëm një dhimbje dhe mërzi, atë që nuk do ta kisha babin, ndërsa kështu kam mijëra dhimbje dhe mërzi të cilat nuk më ndalen prej se kam lindur. Gjithkrah më shkonte mendja, por nuk gjëja asnjë zgjidhje për këtë problem. Vetëm një gjë e kisha të qartë, po të isha djalë nuk do të më ndodhnin gjëra të tilla. Për herë të parë i kuptoja ato vajza që iknin nga shtëpia dhe grabiteshin, siç themi ne. Këtë me siguri nuk e bënin pse nuk ishin të ndershme apo nuk kishin respekt ndaj prindërve. Në të vërtetë nuk e kupton askush gjendjen e tyre, ato janë të nënçmuara dhe nuk gëzojnë kurrfarë respekti. Nëse shpreh emocionet tua dhe plotëson një dëshirë e cila për të tjerët është e thjeshtë, por për ty ka një domethënie të madhe, sepse është pjesë e jetës dhe e drejtë për ëndrra, emocione, gëzime, hidhërimë por edhe gabime, për të tjerët është aq e parëndësishme sa vetë bota e tyre në të cilën jetojnë ata. Nuk ka njëri të gjallë në këtë botë që nuk bën gabime. Këtë e

di dhe e kam shumë të qartë. Disa gabime falen e disa jo. Siç e kam të qartë, gjithashtu, se disa gabime nuk bën t'i përsërisim. Gabimet ua falim atyre që i duam dhe t'i ndihmojmë të mos i përsërisin ato, sepse "i forti e ka borxh të prijë për së mbari"...

– Mos rri mbyllur në dhomë, por eja se dreka është gati, – dëgjova zërin e nënës.

– Nuk më hahet nënë.

– Çohu të thashë, eja e mos i ngij hasmit.

Këtë fjali e kuptova, por nuk e dija se kush janë hasmit. Kjo fjali kishte lidhje me kartolinën e Halimit. Merre me mend, tre muaj më herët ishte dërguar ajo kartolinë dhe kishte rënë në duart e dikujt që mezi kishte pritur t'ia jepte babait. E pse e bën dikush një gjë të tillë?! Pse unë që tre muaj nuk dija asgjë për këtë kartolinë, ndërsa ajo i kishte rënë në dorë babait ende pa i bërë tri orë që kishte ardhur nga Zvicra? Pse? Sipas mendimit tim, hasmi gjendej në rrethin familjar. E paskam pasur plotësisht gabim kur mendoja se hasmi mund të jetë vetëm në mesin e të huajve. E tretur në të tilla mendime më kishte kaluar koha pa vënë asnjë pik gjumë në sy. Dhimbja e kokës nuk më kishte pushuar fare. Përveç nënës, askush tjetër nuk interesohet për mua. Dikur vonë pasdite derisa isha duke i renditur enët që i kisha larë, drejt meje erdhi babai. Këtë herë nuk kisha frikë se do të më godiste prapë. Zemra më ishte bërë si një copë akull dhe nuk kisha kurrfarë ndjenjash ndaj tij. Bëra sikur nuk po e shihja.

– A je menduar mirë? Mos më thuaj nesër se ai është më i vjetër se unë, dhe dije se ata nuk janë dervish si ne!

– Bëj çka të duash, – i thashë pa u menduar fare.

Nuk kisha pse të flisja kur edhe ajo punë ishte vendosur, sepse në dhomën e prindërve rastësisht m'i kishte zënë syri gjërat që ishin përgatitur për ceremoninë e fejesës...

Të dielën në mesditë babai e kishte dhënë fjalën. I dëgjoja duke biseduar dhe duke ua bërë prindërve për hair, por mua nuk më

thoshte askush asgjë. Hynin dhe dilnin mysafirë pa ndërprerë. Për çudi ishte njoftuar për këtë fejesë i gjithë farefisi dhe kishin ardhur sikur ta kishin pritur të gjithë për hasret! Edhe pse shumë gjëra nuk i kuptoja, unë kisha një dert të madh. A do të vazhdoja shkollën. Ishte koha kur duhej t'i përgatitja librat dhe t'i kryeja detyrat e shtëpisë për të hënë, por babai ma bëri të qartë se për mua më shkolla nuk ekziston. Doja edhe njëherë ta pyesja por nuk guxoja. Do të dëgjojë menjëherë edhe në shkollë për fejesën time të papritur. O Zot i madh, si do të ndihet Shkëlqimi i ngratë kur ta dëgjojë këtë lajm nga dikush tjetër e jo nga unë? Do ta përqeshnin familja e tij dhe me siguri do të më urrejë për tërë jetën. Do të më urrejë pse nuk i kam treguar, do të mendojë se jam gënjeshtarë dhe tradhtarë për fjalët dhe premtimet e dashurisë që ia kam dhënë nëpërmjet letrave. Më duhet ta gjej ndonjë formë që ta thërras në telefon dhe t'ia shpjegoj të gjitha. T'i them të kam dashur gjithmonë dhe do të të dua. T'i tregoj se nuk e kam gënjyer asnjëherë dhe çdo fjalë që ia kam shkruar, ishte fjalë zemre dhe atë më kryesoren, se kurrë nuk e kam dashuruar askënd përveç tij. Ashtu si në ëndërr më kalonte koha. Buzëqeshja e kishte humbur rrugën për tek unë, ndërsa lotët vinin çdo natë sapo fikej drita. Gjithë ditën merresha me punët e shtëpisë. Prisja dhe përcillja mysafirë, bëja kafë dhe çaj, laja enët, hekurosja rrobat, me një fjalë isha shndërruar në amvisë. Më shkumbohej zemra sa herë i shihja librat e mi, detyrat e fundit që i kisha bërë dhe nuk m'i kontrolloi më askush.

Kaluan kështu dy javë dhe erdhi dita kur prindërit e mi u bënë gati për t'u kthyer në Zvicër. Ata nuk më kishin treguar se po shkonin, por i zbulova që po bëheshin gati. Shpresoja se këtë herë babai do të shkonte vetëm, ndërsa nëna me Mirjetën do të rrinin në shtëpi. Por kur e pashë nënën duke qarë, e kuptova se edhe ajo do të shkonte. Për shkuarjen e babait dhe Florentit gëzohesha sepse nuk dëshiroja t'i shihja, ndërsa për nënën dhe Mirjetën më vinte keq. U përshëndeta me Florentin ashtu me gjysmë zemër, ndërsa kur m'u afruan nëna me Mirjetën që e mbante në krah, e kuptova se për disa

njerëz kisha ndjenja shumë më tepër sesa që mendoja.

– Hajde tash mjaft më, se nuk po ndahemi përgjithmonë. Eja me mua Trëndafile se dua të të tregoj diçka, – më ngrehu babai për dore dhe më skajoi në një pjesë të oborrit. Dëgjo mirë se çka po të them. Pres nga ti që t’i dëgjosh këshillat e të tjerëve. Ki kujdes se si po sillesh, se tash më nuk je e vogël, e mos ma merr fytyrën se për Zotin ta këpus kokën sikur të zogut. A më kuptove? Nuk dua që të dalësh jashtë shtëpisë, s’ka dajë, s’ka halla, s’ka shoqe. Vendi yt momentalisht është vetëm shtëpia. Më në fund më përqafoi duke e përsëritur edhe një herë fjalën, a u kuptuam? U kthyen te vetura ku nëna me Mirjetën dhe Florentin prisnin brenda. Me të dalë të veturës nga oborri, dera u mbyll. Të gjithë hynë brenda në shtëpi, ndërsa unë u ula prapë në shkallë dhe filluan të më rridhnin lotët pa kontroll, madje këtë herë as që dëshiroja t’i ndalja. Doja të shfryhesha se më dukej se do të plasja. Isha aq e lodhur dhe e mërzitur sa më bëhej se kurrë nuk kam qenë e lumtur. Nuk isha në gjendje ta perceptoja se çfarë kishte ndodhur dy javët e fundit. Më dukej vetja sikur një zog në kafaz, thellë e pikëlluar dhe e vetmuar. Vetmia në këto ditë më ishte bërë shoqja ime më e ngushtë dhe më përcillte në çdo hap. Urrejtja, pikëllimi, vetmia, zemërimi dhe mosbesimi ishin bërë pjesë e pandarë e zemrës sime dhe më bëhet se nuk kanë ndërmend të largohen nga aty, apo t’ia lëshojnë vendin shpresës, kënaqësisë, lumturisë, e sa për dashuri të mos flas... Shumë njerëz kanë ndërhyrë në jetën time dhe po ndërhyjnë edhe më tej.

IV

Halimi më thërriste shpesh në telefon, më thoshte se më do shumë, më premtonte se do të m'i plotësojë të gjitha dëshirat. Thoshte se dëshiron të më bëjë të lumtur sepse tashmë jam e fejuara e tij dhe nuk ka të drejtë të më bërtasë e as rrahë askush. Shprehte keqardhje për ato tortura që më janë bërë deri më tani. Ai duket se ishte shumë i dashuruar në mua. Shumë herë habitesha se si ai dinte gjithçka që ka ndodhur në shtëpinë time! Ku e dinte ai për kërcënimet dhe rrahjet që m'i ka bërë babai?! Shumë herë kam dashur ta thërras Shkëlqimin, por nuk kam mundur edhe pse kanë kaluar disa muaj, edhe pse shumë e shumë herë kam menduar për të. Në fillim kur doja ta thërrisja, isha vetëm pak minuta e vetme, ndërsa natën nuk kisha mundësi, ngase babai e kishte vendosur qëllimisht telefonin në dhomën e gjyshërve. Sa më shumë që kalonte koha, aq më shumë frikohesha ta thërrisja Shkëlqimin. Pasiguria më shtohet çdo herë e më shumë, sepse nuk e dija se si do të reagoje, në të vërtetë nuk isha e sigurt nëse do të fliste me mua. Edhe në ato pak raste që mund ta thërrisja, në mua dominonte frika se do të dëshpërohem kur ta kuptoj se Shkëlqimi, i cili njëherë më ka dashuruar dhe e kam dashuruar, tani më urren dhe nuk dëshiron të dijë se kush jam. Kisha dëshirë shumë të madhe që t'ia dëgjoja zërin dhe t'i thosha se sa më vinte keq për gjithçka. Nganjëherë po mendoj se po e teproj kur po më shkon mendja në dashurinë time të parë, por nuk jam as e para e as e fundit që nuk bashkohem me atë që e kam dashuruar së pari. Tash jam e fejuar për dikë tjetër dhe sa më herët ta respektoj këtë zgjedhje të prindërve, aq më lehtë do ta kem në të ardhmen, edhe ashtu më nuk mund të ndryshoj asgjë. Halimi më çonte rregullisht dhurata, unaza, orë dore, këpucë, madje edhe ëmbëlsira. Më dërgonte çokollata ku janë më të mira dhe më të shtrenjta, madje jo vetëm mua, por edhe Teutës dhe Adrianit. Me siguri më dashuron shumë, dhe ndoshta unë nuk po e kuptoj. Është pak i shkurtër me trup, por shumë i bukur në fytyrë. Ndoshta në të vërtetë m'i ka dërguar të

gjitha ato përshëndetje sepse është i dashuruar e nuk e ka pasur për qellim të më nxjerrë probleme. Ndoshta nuk është njeri i keq se ai gjyshin dhe gjyshen i ka haxhilerë të cilët kanë qenë nga dy-tri herë në Qabe. Ndërsa, babai i tij i fal pesë kohët e namazit, e sa i përket nënës, nuk kam disi respekt, sepse ajo edhe pse mban shaminë në kokë, është tregtare e fortë dhe nuk lë vend pa e futur hundën...

Një ditë më thirri Halimi në telefon të xhaxhait dhe u çudita si e dinte se jam aty. Halla ma zgjati dëgjuesen e telefonit duke më thënë, merre e fol me të se e paska marrë malli shumë për ty dhe paske lindur me fat, apo siç thoshte ajo, në natë të madhe. Nuk mund ta kuptoja se çfarë donte të thoshte me këto fjalë.

– Fol tash e mos u bëj sikur nuk e turbullon asnjë ujë. Tashmë i takon atij!

Kështu edhe filluan telefonatat të cilat nuk u ndalën kurrë. Prej kësaj dite mund të them se ka filluar një lloj terrori ndaj meje. Në mbrëmje, sapo binte terri, ndonëse dera e oborrit ishte e mbyllur me çelës dhe muret ishin të larta, Halimi gjithmonë gjendej në oborrin tonë! Gjithçka kishte ndryshuar në jetën time, asgjë më nuk ishte si dikur. Një mbrëmje, gjyshi më dërgoi ta kontrolloj derën e oborrit a ishte e mbyllur ose siç bënim shumë herë kur nuk ishim të sigurt, sepse gjyshi kishte frikë se mos natën po na hyn ndonjë hajn, ngase të gjithë e dinin që kemi të holla dhe se vetëm pleq e fëmijë gjendeshin në këtë shtëpi. E ndeza dritën dhe shkova. Dera ishte e mbyllur me çelës dhe kur po bëhesha gati të kthehesha, e dëgjova një zë të ulët:

– Trëndafile, Trëndafile, mos u friko, unë jam Halimi.

U trullosa në çast, rrotullohesha nga të katër anët por nuk shihja askënd. Më kaploi një frikë e tmerrshme. Jo që kisha frikë nga Halimi por nga të tjerët. Frikohesha se mund të dilte dikush rastësisht jashtë e të na hetonte. Një shkëndijë e cigares më orientoi andej nga vinte zëri. Iu afrova, kundër dëshirës sime, ndonëse shikimin e kisha të drejtuar kah shtëpia.

– Nuk po mund të rri pa të parë. Nuk mund ta përshkruaj sa i lumtur jam që tash më takon mua. Kam zgjedhur vajzën më të bukur

në tërë qytetin.

M'i ledhatoi flokët, gjë që më bëri të më kaplojë një ndjenjë e papërshkruar.

– Të lutem Halim largohu, më duhet të shkoj brenda. Unë e kam të ndaluar të takohem me ty.

– Mos u brengos aq shumë sepse ata nuk i kanë mendtë te ne!

Unë fillova të ecja në drejtim të shtëpisë, ndërsa Halimi më thoshte se nesër do të vinte prapë.

– Do të sinjalizoj në ndonjë mënyrë dhe të pres që të vish tek unë.

– Të lutem mos, se babai do të më mbys nëse e kupton këtë gjë, – ia thashë këto fjalë dhe shpejtova hapat...

– Çka ke moj vajzë që je bërë kështu, që edhe me të pre në fyt nuk e qet asnjë pikë gjak?!

– Gjyshe nuk po të kuptoj se çfarë po dëshiron të thuash me këto rrotullat e tua.

– Desha të të them se ndoshta herën tjetër është mirë që të vijë edhe Teuta me ty, sepse duket se je frikësuar...

Që nga ajo ditë fillova t'i urreja mbrëmjet. Nuk kisha kujt t'ia tregoja hallin tim. Ishin të kota lutjet e mia drejtuar Halimit që të mos vinte më. Ai, për çdo mbrëmje futej në oborr, edhe pse derën e mbyllja më herët se zakonisht. Nuk mund ta kuptoja se si hynte brenda, duke u ngjitur sipër murit, me siguri, sepse ndryshe ishte e pamundur. Shumë herë nuk dilja fare mbrëmjeve nga dhoma, madje as atëherë kur kisha nevojë të shkoja në tualet. Por, prapëseprapë nuk kalonte mbrëmje që Halimi të mos gjendej diku afër. Një mbrëmje dola në korridor për t'ia mbushur gjyshit një gotë të ftohtë me ujë nga kroi. Sapo ndeza dritën, dëgjova se dikush po trokiste në dritare. U frikësova aq shumë sa gati nuk u pshurra në pantallona. Mbusha gotën me ujë vetëm deri në gjysmë, ndala dritën dhe hyra brenda me një shpejtësi të rrufeshme. Halimi vinte çdo mbrëmje dhe më sinjalizonte në mënyra të ndryshme se gjendej në oborr. Dhuratat dhe ëmbëlsirat nuk ndaleshin. Halimin nuk e urreja më sikur në

ditën e fejesës. Nuk e di pse, mbase që isha e dëshpëruar me babain dhe disa të tjerë apo për arsye se ishin bërë disa muaj që gjendesha e vetmuar në shtëpi pa shkollën, pa mësimin, pa shokët dhe shoqet, pa të dashurin tim Shkëlqimin. Apo ndoshta ishte dëshira që të lirohem nga ky burg shtëpiak, pavarësisht se ku dhe me kë jam.

Gjatë një bisede telefonike Halimi më bindi një ditë që së bashku me hallën të dal në mbrëmje me të. Ai më tha se e kishte rregulluar punën, se halla dhe gjyshja nuk do t'i tregonin gjyshit se ku gjendem. Plani i hallës ishte që ne të flinim në katin e parë dhe unë të dilja pasi që Teutën dhe Adrianin t'i merrte gjumi. Isha me dy mendje. Njëra më thoshte të mos i besoja askujt dhe të mos dilja, ndërsa tjetra më thoshte të dilja pasi kisha përkrahje nga gjyshja dhe halla, e nga ana tjetër ishin bërë disa muaj që nuk kisha dalë fare nga shtëpia, dhe ndoshta nuk është gabim që ta njihja personin me të cilin një ditë do të martohem. Kisha frikë se nëse nuk do të dilja, Halimi do të hidhërohej edhe më shumë në mua, sepse halla i ka premtuar se do të më ndihmonte dhe se askush nuk do ta kuptonte për këtë çështje. Nuk më zinte vendi vend. Tërë ditën nuk ia ndaja sytë orës. Nuk më hahej as bukë dhe çdo gjysmë ore më duhej të shkoja në tualet. Pasi perëndoi dielli dhe terri ia mori pushtetin dritës, gjyshi shkoi për të fjetur në dhomën e tij. Ai gjithmonë shkonte herët në shtrat. Teuta dhe Adriani ishin lodhur duke luajtur tërë ditën me fëmijët e lagjes, mezi pritën të shkonin në shtrat. Ndihej pak më e lehtësuar. Halla më tregoi se çka ishte më së miri për mua të vishja në takimin e parë me Halimin. Ishin rrobat që m'i kishte bërë dhuratë për herë të parë Halimi me nënën e tij. Nuk ishin të këqija, por as të mira. Ishin me një stil krejt ndryshe nga ai që kisha unë. Këpucë me taka të larta, një fund dhe një këmishë të cilat kur i veshja dhe e pashë veten në pasqyrë, më kaploi një trishtim ngase dukesha krejt ndryshe. Ato rroba më bënin shumë më të vjetër sesa që isha. Isha e mësuar të ecja me këpucë të rrafshëta apo me patika, të veshja triko të thjeshta, tuta sportive apo pantallona, me të cilat ndihej shumë mirë, e jo fustan, bluzë, këpucë me taka e madje edhe çorape të holla. Kjo

veshje nuk më pëlqente fare, por halla gjithë kohën më thoshte se sa e bukur dukesh dhe se tani e tutje më duhet të mësohem me këtë veshje ngase koha e pantallonave për mua kishte kaluar. Zbrita shkallëve të oborrit ngadalë me majë të gishtërinjve dhe sapo dola në rrugë, pashë se Halimi më priste me një veturë të cilën nuk e dija nëse ishte e tij apo e dikujt tjetër.

– Hyr brenda Trëndafille, shumë bukur po dukesh, shyqyr prej Zotit që po del me mua në shëtitje e jo me dikë tjetër. Ku ke dëshirë të shkojmë?

– Nuk kam ndonjë ide, – ia ktheva.

Ishte e vërtetë se nuk kisha ndonjë ide sepse kjo ishte një botë e panjohur për mua.

– Po shkojmë në Prizren, është qytet shumë i bukur. A ke qenë ndonjëherë? – më pyeti.

– Jo nuk kam qenë, u përgjigja.

Në të vërtetë kisha qenë disa herë por nuk doja të zgjasja bisedë me të.

– Mua më pëlqen shumë Trëndafille, – më tha Halimi, derisa ngiste makinën në drejtim të Prizrenit dhe kishte lëshuar një muzikë e cila disi filloi të më pëlqente. Kisha kohë që nuk kisha dalë nga shtëpia dhe këtë e përjetoja si një gjysmë liri, por prapësepapë më kaplonte një ndjenjë e keqe ngase kisha frikë se mos takohemi me dikë të njohur dhe kjo për mua paraqiste problem serioz. Prizreni vërtet dukej shumë i bukur gjatë natës. Të tillë nuk e kisha parë asnjëherë. Kishte shumë kafene, ëmbëltoje, dyqane të ndryshme, xhamia por më së shumti kishte argjendari. Halimi e dinte çdo rrugë e rrugicë të këtij qyteti. Fillimisht shkuam në një ëmbëltoje ku unë hëngra një sytliash Prizreni me tullumba që kishte një shije të posaçme dhe e hëngra me shumë endje. Prej aty shkuam në një kafiteri ku disa drita të zbehta shumëngjyrëshe krijonin një pamje romantike. Në secilën tavolinë gjendej nga një çift i ulur shumë afër njëri-tjetrit të cilët ledhatoheshin dhe putheshin kohë pas kohe. Kjo ishte një botë e re për mua të cilën nuk e kisha imagjinuar deri më tash...

Nuk e dija se çfarë kishte ndodhur me mua. Ndihesha shume e lodhur, kisha dhembje koke dhe të vjella, ndieja dhimbje në tërë trupin sikurse të më kishte rrahur dikush. Gjakderdhja nuk më ndalej dhe ishte një gjakderdhje ndryshe, jo si ajo e menstruacioneve. Këtë herë kisha më pak gjakderdhje, por një dhimbje krejtësisht tjetër. Më ftuan të ha bukë por unë nuk dëshiroja as të haja, as të pija. Doja të rrija vetëm në qetësinë time, atë ditë nuk dëshiroja ta shihja askënd me sy. Dhe për fat të mirë atë ditë më lanë rehat, por të nesërmen halla dhe gruaja e axhës filluan me pyetjet e tyre se ku ishim, çka kishim ngrënë, a më kishte dhuruar Halimi këtë herë diçka?...

– Trego Trëndafile a të ka puthur? Ku të ka prekur? Inshallah nuk t'i ka bërë të gjitha të zezat që ditën e parë. Nuk të besojmë nëse na thua se vetëm keni biseduar tërë natën pa bërë asgjë. Shikoje veten njëherë në pasqyrë, je bërë sikur të ishe zgjuar sot prej varri, ishin komentet e tyre që i dëgjoja si e përgjumur.

Nuk mund të flisja, vetëm thosha vetë me vete, lërmëni rehat moj shtriga, mos më trullosni edhe më shumë sesa isha e trullusur. Ato i dinin të gjitha mirë dhe dyshoj se me qëllim ma kanë mbushur mendjen që të takohesha me Halimin.

Mbas këtij takimi Halimi më nuk më thirri për disa ditë e as nuk u duk më. U gëzova dhe ndjeva një çfarë çlirimi. Por për fat të keq ky gëzim nuk zgjati shumë, ngase, siç thotë një fjalë popullore “ujku qimen e ndërron, por zanatin nuk e harron!”

Një mbrëmje kur isha në shtëpi vetëm me Teutën dhe Adrianin, Halimi përsëri qe futur në oborr dhe ishte fshehur nën dritare prej nga më dërgonte sinjale. I mashtrova disi Teutën dhe Adrianin duke u thënë se po shkoja ta kontrolloja edhe një herë derën e oborrit.

– Ku je moj Trëndafile, nuk të kam parë që disa ditë.

Ende pa ia kthyer përgjigjen, ma kapi kokën me dy duar dhe më puthi në gojë. Ndjeva një lloj gërdie dhe u përpoqa ta largoja kokën, sepse nuk ia duroja pështymën e tij. Derisa ma fuste gjuhën thellë në gojën time, njërën dorë ma vendosi në gjoks. E shtyra me sa forcë që kisha, jo vetëm se kisha frikë, por sepse më neveriste.

– Mos u paraqit kështu kinse nuk po më do. A nuk po të pëlqejnë puthjet e mia? Inshallah nuk ke ndonjë dashnor tjetër...

Derisa fliste mundohej që të më shtrinte në ndonjërin prej lisave që ishin të shtrirë për tokë, të cilët babai i kishte prerë kohë më parë për t'i bërë dërrasa. E luta që të më lëshonte, por këtij të pashpirti nuk i interesonin aspak lutjet e mia...

Qava përsëri tërë natën pa pushuar. Më dhembte shpina, kurrizi më ishte bërë krejt plagë nga zvarritja nëpër trungje. Nuk dua që të më ndodhin këto gjëra, por nuk di si t'i ndaloj. Jam e rrethuar nga një tufë djallesh dhe nuk po di si të largohem nga ta. Shumë gjëra nuk po i kuptoj, por as nuk po guxoj të flas. Më parë do të më mbysnin sesa të më besonin nëse ua tregoj të vërtetën. Nuk dua të më mbysin duke më rrahur, të më varin në litar apo të më helmojnë siç e ka helmuar daja i babait tim vajzën e vet! Nuk e di nëse është e vërtetë, por e kam dëgjuar nënën time njëherë kur është fjalosur me gjyshen dhe i ka thënë se vetëm katilët e bëjnë një gjë të tillë dhe e mbysin evlatin e vet!

V

Një ditë erdhën për të më vizituar dhe për të ma uruar fejesën Samirja dhe Pranvera. U gëzova shumë për vizitën e tyre, sepse prej asaj dite që babai ma ka ndaluar shkollimin, nuk e kam takuar më asnjërin nga shoqet. Bisedonim për gjithçka. Ato ishin të interesuara të dinin çdo gjë rreth fejesës sime dhe rreth Halimit. Samirja ishte shumë më tepër e interesuar dhe e informuar për gjithçka që kishin të bënin me dashurinë sesa unë e Pranvera! E lumja ti moj Trëndafile se çfarë fati paske pas me u bë nuse në atë shtëpi. Përveç që Halimi është i bukur, ata janë shumë të pasur dhe kanë me t'i plotësuar të gjitha dëshirat. Janë fetarë por edhe modernë, dhe me sa di unë Halimi e ka edhe një vëlla më të ri. Sapo të martohesh, do të vij të të vizitoj edhe atje, ndoshta do të mund të njoftohemi disi dhe të bëhemi kunata me njëra-tjetrën.

Pranvera nuk fliste shumë, por kur fliste i jepte vulë. Inshallah kam edhe unë fat që të më lypin për ndonjë djalë ku janë të pasur e jo në fshat.

– Pse jo në fshat, e pyeta unë? Një tezake e nënës sime është e martuar në fshat dhe e kam dëgjuar duke i treguar nënës se burrat e fshatit e bëjnë atë punë vetëm si duan ata vetë, e jo si duan gratë e tyre. –

– Po, po, ke të drejtë Pranverë, – ja priti Samirja.

I kisha shoqet e klasës, i njihja me vite, por kurrë nuk më ka shkuar mendja të interesohem për kësi lloj fëlliqësirash. Për çudi në atë çast ndihesha pak krenare për fatin tim kur i dëgjoja Samiren dhe Pranverën që ma kishin lakmi. Që të dyjat shprehnin qartë dëshirën e tyre që të kenë fatin sikur timin, e të fejohen në një familje të pasur. Më befasonin pa masë se sa shumë dinin ato dyjat për fejesën, martesën, e veçmas për marrëdhëniet seksuale...

– Gjyshi kishte shkuar diku në dasmë te disa miq të tij, ku edhe do të bunte. Halimi e dinte këtë punë dhe i kishte marrë Teutën e Adrianin të cilëve u kishte blerë ëmbëlsira dhe u kishte dhuruar të

holla. Pak më vonë e kuptova se kishte blerë për të gjithë nga diçka e jo vetëm për ata të dy, për gjyshen, për hallën dhe për atë shtrigën e xhaxhait. Me këto ai e kishte marrë lejen nga to që të më çonte në shtëpinë e tij, ngase atë ditë nuk i kishte prindërit në shtëpi, por vetëm motrën dhe një mbesë. Të gjithë kishin rënë dakord që unë të shkoja me të, edhe pse ishin të vetëdijshëm se babai do të më mbyste para syve të tyre po ta kuptonte një gjë të tillë. Nuk dija si të veproja. Halimi nuk largohej nga oborri. Të gjithë më thoshin shko, por mos rri deri vonë. Halimit kjo i pëlqeu dhe u premtoi që do të më kthente me kohë në shtëpi. Meqë ishte dritë, shkuam disa rrugicave që të mos na shihte dikush që më njihte. Kur arritëm te shpija e Halimit, aty ishin vetëm e motra e tij dhe mbesa. Na përshëndetën dhe u gëzuan shumë. Filluan të sillnin menjëherë kafe, ëmbëlsira, pemë të ndryshme dhe shumë gjëra të tjera sikur të ishim në ndonjë ditëlindje. E hetuan që nuk ndihesha e lirë dhe më vinte keq që bënin aq shumë për mua.

– Trëndafile, mos rri ashtu e ngurtë, ndihu sikur në shtëpinë tende. Nuk duam të të frikësojmë, por ne kurrë nuk jemi pa mysafirë. Kafeja dhe çaji këtu nuk ndalen asnjëherë. Kënaqu sa je si mysafire se kur të bëhesh nuse, nuk do të kesh më kohë, – më tha motra e Halimit me një buzëqeshje engjëllore dhe derisa bisedonim dhe shikonim një videokasetë, ende pa kaluar një orë që gjendesha aty, dikush i ra ziles. Të gjithë u shikuan mes vete, duke e pyetur pa fjalë njëri-tjetrin se kush mund të ishte. Motra e Halimit doli për të parë dhe kur u kthye brenda m'u drejtua mua: Trëndafile ec se është vëllai yt, por nuk po pranon kurrsesi të hyjë brenda. Dola jashtë dhe ende pa arritur ta flisja asnjë fjalë, Adriani m'u drejtua rrëmbyeshëm;

– Eja menjëherë në shtëpi, mjaft ke ndenjor këtu.

Kurrë nuk e kisha parë Adrianin kaq të shqetësuar. Ishte skuqur në fytyrë dhe i ishte vështirësuar frymëmarrja. U përpoqa ta qetësoj që të hynte brenda, sepse kisha frikë se po kalonte dikush atypari e po na shihte, por Adrianit më lehtë mund t'ia thyesh kokën sesa mendjen. Pas pak erdhi edhe Halimi te ne jashtë dhe iu drejtua

Adrianit.

– Eja hyr brenda ose shko në shtëpi se unë e kthej Trëndafilën vetë, ashtu siç e kam marrë.

– Nuk është ka flet kush me ty, ti je një mashtrues. Eja Trëndafilë se babai ka telefonuar dhe ka thënë se do të telefonojë prapë. Në qoftë se nuk vjen menjëherë do t’i tregoj se ke ardhur këtu.

Iu luta Halimit që të më kthente në shtëpi sa më parë, sa nuk ka ndodhur ndonjë problem më i madh. Adriani ashtu i shqetësuar, duke qarë u nis për në shtëpi. U gjeta ndërmjet dy zjarreve.

– Ndoshta babai vërtet ka telefonuar, ndoshta Adriani nuk e ka nga xhelozia por ka frikë se më ke marrë dhe nuk do të më kthesh më në shtëpi! Të lutem Halim bëhu i kuptueshëm dhe më kthe në shtëpi.

U nisem prapë atyre rrugicave të cilave kishim ardhur. Zemra më rrihte aq shumë sa më bëhej sikur donte të dilte nga kraharori. Kisha shumë temperaturë dhe më vështirësohej frymëmarrja...

– Unë nuk lejoj të të prek askush me dorë dhe as të të bërtas. Unë të kam marrë, ti më ke ardhur vetë.

– Halim, unë nuk dua fjalë dhe mos u shtyj me një fëmijë që nuk i kupton gjërat. Beso se Adriani nuk e ka me qellim. Do të hyj vetë brenda se ndoshta ka ardhur edhe gjyshi në shtëpi.

– Punë e madhe nëse është gjyshi yt aty. Ti je e fejuara ime dhe nuk lejoj që të të bëj kush keq ty, – më tha Halimi, derisa po hapja derën e oborrit. Hyra ngadalë brenda. Në oborr ishin gjyshja, halla, Teuta dhe Adriani që ishte ende duke dënesur. Gjyshi nuk dukej askund, ndërsa gjyshja m’u drejtua me një rafal të sharash.

– Ah moj Trëndafilë, të raftë mishi copë se vetëm telashe je duke na bërë. Nuk do të dalësh më kurrë nga shtëpia dhe do t’i tregoj babait tënd, edhe nëse të mbyl, se ke shkuar me atë laper. Ia tregoj qejfin unë atij nëse vjen edhe një herë këtu. Teuta shikonte vetëm ashtu pafajshëm dhe nuk fliste asgjë, ndërsa halla ndonëse nuk fliste, bënte lëvizje me kokë që linte të kuptohej se i bëhej qejfi.

– Adrian mos bërtit, qetësohu se nuk ka ndodhur asgjë. Ju të

gjithë vetë i keni premtuar Halimit se nuk keni asgjë kundër që të shkoj me të, e tash po bëni sikur nuk po dini asgjë. Pse po ma bëni këtë? As ti hallë mos u palos ashtu si një melaqe, sepse ti ke qenë iniciatore e gjithë kësaj për shkak të këpucëve që t'i ka premtuar Halimi. Po duket se edhe ëmbëlsirat ju kanë pëlqyer të gjithëve, por i paskëshit ngrëne shpejt, e tash ju ka rënë ndërmend të pyetni se ku isha unë.

Në atë moment as që më binte ndërmend për gjyshin, sepse isha aq e zemëruar sa që nuk mendoja se çka kishte ndodhur. Halimi i kishte dëgjuar të gjitha këto nga sokaku. Sapo e mbarova fjalën e fundit, u fut në oborr pa trokitur fare.

– Nuk mund të duroja pa hyrë brenda. Nëse i bërtitni Trëndafles vetëm edhe një herë, ju pretoj se e marr me vete dhe e çoj në shtëpi dhe nuk e kthej më.

Oh more Zot i madh, pse nuk ia mbylle gojën Halimit?

Tani vërtet u nxeh situata. Të gjithë filluan të flisnin përnjëherë dhe me zë të lartë. Adriani nisi të shante përsëri, ndërsa unë kisha mbetur e shtangur sikur të më kishte hipnotizuar dikush. Në fillim akuzonin njëri-tjetrin, e pas pak minutash m'u drejtuan mua të gjithë, përveç Teutës. Në atë çast ndërhyri Halimi e më kapi për dore.

– Eja Trëndafle me mua se këtu më nuk ke vend. Mjaft të kanë rrahur e bërtitur, nuk lejoj më të të ndodhin gjëra të tilla.

Dola nga shtëpia pa pasur kohë të mendohesha se çfarë do të ndodhte më vonë, por për një gjë isha e bindur, se kjo shtëpi më kurrë nuk do të ishte e imja. Nuk më pëlqente ky hap, por isha e sigurt se nuk i duroja më ofendimet, kërcënimet dhe torturat nga babai.

Kur arritëm në shtëpinë e Halimit, motra e tij dhe mbesa filluan të pyesnin me syhapur.

– Pse jeni kthyer? Ka ndodhur diçka e keqe?

Derisa unë nuk flisja, asgjë sepse as nuk dija si t'iu tregoja, Halimi ua shpjegoi të gjitha me radhë. Tërë mbrëmjen ndenjëm bashkë në dhomën e ditës, ku temë kryesore e bisedës ishte se si

do të gjenim zgjidhje për këtë çështje? Prindërit e Halimit njoftuan se për gjysmë ore do të arrinin në shtëpi. Pak para se të vinin ata, ne shkuam në një dhomë tjetër. Derisa unë prisja vetëm në dhomë, Halimi konsultohej me motrën dhe prindërit e tij. Vetëm dëgjoja zëra, por asnjë fjalë nuk mund ta kuptoja.

Kaloi një javë që unë rrija e mbyllur në atë dhomë. Dilja vetëm herët në mëngjes dhe vonë në mbrëmje, kur më duhej të shkoja në tualet. Bukën ma binin me një tabak të madh në dhomë. Shumë herë nuk më hahej. Ndonjëherë më bënin shoqëri në drekë Halimi dhe motra e tij. Halimi punonte në një shitore të këpucëve që e kishte të veten, ndërsa e motra e tij kujdesej fillimisht për punët e shtëpisë përpara se të fillonte punën e tregtisë së bashku me prindërit e saj të cilët merreshin me tregtimin e arit dhe argjendit. Gjithë ditën hapej e mbyllej dera dhe shtëpia ngjante në ndonjë stacion treni të ndonjë qyteti të madh evropian. Unë e ngrata isha e mbyllur sikurse në burg. Që një javë nuk kam parë diell me sy dhe nuk e di se çfarë do të ndodhte me mua. Më dukej sikur isha transferuar nga një burg në tjetrin. Mbas dhjetë ditësh apo dy javësh, Halimi më tha se të dy familjet kishin vendosur me anë të burrave që unë prapë të kthehesha atje dhe të bëhej sikur nuk ka ndodhur asgjë.

– Nuk do të të bërtasë askush dhe nuk guxon të të prekë askush, madje as me gisht të vogël të dorës, – më thanë.

Edhe pse më kishte marrë malli shumë për Teutën, nuk i gëzohesha aspak këtij kthimi.

– Trëndafile, edhe njëherë po të them se nuk guxon askush të të thotë asgjë.

Ditën e dasmës e kishin caktuar për dy javë. Halimi më tregoi se prindërit e tij donin të bënë dasmë të madhe, meqë ishte djali i parë dhe e kanë pritur me padurim këtë martesë.

– Do t’i blejmë të gjitha që të duhen, e sa për çejz, mos u mërzit aspak se neve nuk na duhen gjëra të tilla.

Në të vërtetë shumë herë më behej sikur isha ëndërr. Mbrëmjen kur më ktheu Halimi në shtëpi, sa më shumë që afroheshim, aq më

shumë më dridheshin këmbët. E lusja Zotin që të ma merrte shpirtin. Më së shumti kisha frikë nga babai, për të cilin nuk dija nëse kishte ardhur nga Zvicra. E dija që të gjithë do të më provokonin dhe do të më trajtonin si ndonjë lavire. Por kjo gjë nuk më shqetësonte aspak sepse e kisha të qartë që kjo do të ishte hera e fundit që gjendesha në shtëpinë time dhe nuk e dija se çfarë do të ndodhte më pas me mua. Gjatë kësaj periudhe, më dukej se gjendesha në një tjetër botë, në një botë ku më drejtonin të tjerët dhe nuk mund ta kuptoja se çfarë po ndodhte me mua. Vetja më dukej si ai topi kur e shutojnë të gjithë... Ndonjëherë më hynte një fuqi e madhe dhe thosha me vete se edhe nëse ka ardhur babai, punë e madhe. Le të më rrahë, le të më mbysë, le të më bëjë sakat për tërë jetën nëse dëshiron. Më mirë të më mbys njëherë sesa gjithë jetën. Kur arritëm te dera e oborrit, filluan sërish të më dridheshin këmbët dhe m'u thanë goja e fyti. U ndala të mbushem frymë por Halimi më ngrehu për dore dhe hymë bashkërisht në oborr. Gjyshja dhe halla shtrigane gjendeshin në oborr. Më shikonin sikur të isha zgjuar lugat dhe nuk flisnin asnjë fjalë. As unë nuk fola asgjë dhe ashtu pa fjalë u ngjita shkallëve përpjetë dhe hyra në dhomën e mysafirëve. As sot nuk e di se për çfarë arsye hyra pikërisht në atë dhomë. Mbase sepse më dukej vetja e huaj. Nuk doja që të më shihte askush, që të më flasin e të pyesin për asgjë. Teuta ma binte bukën në dhomë dhe bisedonte me mua, ndërsa të tjerët, siç duket, as nuk dëshironin të më shihnin. Ta them të drejtën, as unë nuk doja t'i shihja. Teuta më tregonte se çka dinte, por sa u përket prindërve, ajo nuk e dinte nëse do të vinin.

VI

Përgatitjet kishin filluar, dhe do të bëhej ashtu siç kishin vendosur të dyja palët me anë të burrave. Jam e sigurt se të dy palët shohin vetëm interesin e vet. Ata të Halimit duan të bëjnë dasmë të madhe sepse janë të pasur dhe e kanë Halimin djalë të parë. Ata nuk donin nuse të grabitur. Ndërsa familja ime donin ta bënin këtë martesë për t'ua mbyllur gojën atyre që mund të thoshin se vajza e tyre ua ka marrë fytyrën. Nuk e dija se si do t'i kaloja ditët deri te kanaxhexhi. Ndieja një zbrazëti të madhe në zemër por njëherësh edhe një ftohtësi. Kohën e mbetur deri në ditën e dasmës e kalova e mbyllur në dhomë. Dilja nga dhoma vetëm kur kisha nevoja fiziologjike. Nevojtoresh e kishim në oborr sikurse shumica e shtëpive shqiptare. Vetëm kur dilja në oborr mund të merrja ajër të pastër.

Teuta më tregoi se prindërit nuk do të vinin. Për çudi edhe pse nuk isha kundër zgjedhjes së tyre, u mërzi shumë dhe qava tërë natën. Në mbrëmje erdhën në dhomë halla dhe gruaja e xhaxhait që më ngjanin në dy shtriga.

– Nesër duhet të shkosh të floktarja se të ka ardhur dita. Të premtën në mbrëmje do ta ngjisim kënanë. Do ta bëjmë kanaxhexhin ashtu siç duhet, jo se e ke merituar t'i, por të mos na përqeshin hallku pasi që prindërit e tu nuk po mund të vijnë.

Të nesërmen shkova me Teutën te floktarja dhe e lamë të kthehemi në shtëpi vonë në mbrëmje, pasi të binte terri që të mos më shihte askush me flokë të rregulluara. Kur u kthyem në shtëpi, kishin ardhur disa vajza për ta festuar ditën e fundit të vajzërisë me mua. Kisha një ndjenjë gëzimi që nuk isha e vetmuar dhe që edhe unë ditën e fundit të vajzërisë do ta festoja me shoqe. Nuk e di se kush i kishte ftuar, e as nuk e di se kush e kishte organizuar këtë ceremoni? E kaluam shumë mirë këtë mbrëmje, duke folur e qeshur, duke veshur rroba e fustane të ndryshme. Na e kishin përgatitur një darkë të mirë. Këtë natë harrova për disa çaste mjerimin dhe vetminë që kisha përjetuar... Në mëngjes më thanë se duhet të

lahesha. Jo të lahesha ashtu sikur kur shkoja te daja, por të lahesha për të shkuar te burri. Nuk më treguan asgjë se çfarë duhet të bëja, sepse ata mendonin se isha bërë nuse disa herë dhe s'ka nevojë të më mësonte kush asgjë. Kisha dëgjuar dikur që kur të bëhesh nuse, duhet të rruhesh në çdo vend që ke qime, prej mustaqeve nëse ke, e deri ndërmjet këmbeve. Sikur të bëhesh nuse për Shkëlqimin, do t'i bëja me kënaqësi të gjitha këto, por në këtë rast vetëm u lava si zakonisht. Gruaja e xhaxhait m'ï nduki vetullat, dhe më veshi ashtu siç deshë ajo, nuk i përzihesha e as nuk protestoja fare. Kur e shikova veten në pasqyrë, pashë një person krejt tjetër nga unë që nuk më pëlqente. Në dhomën tjetër ishin të gjitha ato vajza që kishin bujtur atë natë dhe e kishin shpërndarë nëpër tërë dhomën atë pak çejz që e kisha përgatitur, të cilin pasdite do të vinin ta shihnin gratë e lagjes. Nuk ndihesha mirë, i lutesha Zotit të madhërishtëm që kjo ëndërr kaq e gjatë dhe e keqe të marrë fund sa më shpejt që të mund ta vazhdoja një jetë normale në botën time. Në atë botë që unë e njihja dhe e doja, e jo në këtë botë të huaj e të pandjenja. Nisën të vinin gratë të cilat nuk e dija se kush i kishte ftuar. Shumicën e tyre nuk i kisha parë kurrë në jetën time. Darkën e hëngrëm më herët se zakonisht. Edhe këtë radhë hëngra vetëm me vajzat në një dhomë. Gjithmonë kam dashur që ta bëja kështu një lloj feste me shumë vajza, me ushqim të këndshëm dhe me muzikë të mirë pa pasur frikën se do të na pengonte dikush. Të vishemi bukur të gjitha, të hamë, të pimë, të këndojmë e vallëzojmë. T'ï rrëfejmë njëra-tjetrës për dashurinë dhe planet e jetës, të mburremi me notat dhe diplomat...

Po afrohej edhe koha për ta ngjitur kënanë. Në disa kanaxhexhe ku kisha marrë pjesë më dhimbseshin ato vajza të ngrata se si ua lëndonin shpirtin me këngë dhe fjalë shpotitëse. I thosha vetes se kurrë nuk do të lejoja të më ndodhte mua një gjë e tillë. Por, mbase ende nuk po i kuptoj mirë gjërat, sepse gjithnjë kam menduar se do të martohem me Shkëlqimin. Ëndërroja ta bënim një dasmë të madhe me familje dhe shoqëri. Mendoja se nuk do të kisha arsye për të qarë, por përkundrazi të gëzohesha sepse po filloja jetën me

një djalë të cilin e kam dashur gjithmonë. Nga këto mendime më shkëputen fjalët e Teutës.

– Eja Trëndafile poshtë se janë tubuar të gjithë në dhomë. Të ka ardhur koha e kënasë.

Sapo arritëm para derës së dhomës, ma vendosën një shami të kuqe mbi kokë dhe m’i mbuluan sytë. Më ulën në mes të dhomës ndërsa rreth e përqark meje qëndronin gra e vajza. Bëja sikur po qaja, ashtu siç më porositën përpara se të hyja në dhomë, por pa lot dhe me një zë stimulus. Papritur m’i kapen duart dhe filluan të këndonin:

*Ngjitet këna pika-pika
Edhe sonte bajrak ndër çika
Ngjitet këna me pika të kuqe
Nesër mbrëma bajrak ndër nuse...*

Derisa më këndonin, m’i bënë duart me këna në formë të pikave që përshtateshin me vargjet e këngës. Këngët vazhduan edhe më tej. Sapo ndalej njëra – fillonte tjetra:

*Trëndafile mirë je kujtu
Se te burri nesër ke me shku
Ke lanë shkollë ke lanë shoqëri
Që të bahesh rrogtare te burri
Kjo Mirjeta fjalë të ka çu
Qysh po shkon nuse pa mu?
Trëndafile dil tek ara
Kush do t’i dalë nanes përpara
Ka ardhë koha me shtru sofrën
Teuta e Adriani pyesin ku e kemi motrën?
Trëndafile a s’po të vjen gjynah
Ti Teutën për një burrë me lanë...*

Oh Zot i dashur, loti lotin nuk ma priste. Fryma më ndalej dhe qaja me gjithë mend. Ndonëse më kritikonin se nuk po e qitja zërin mirë! A nuk i kanë sytë në ballë me pa këto të pashpirta se sa po vuaj? A nuk kanë këto rahmet që janë vërsulur kundër një vajze gjashtëmbëdhjetë vjeçare? Unë qaja, ato këndonin derisa u lodha me trup e me shpirt, sa që nuk më dilte më asnjë zë nga goja. Nga këto tortura të tmerrshme tradicionale më shpëtoi gjyshi i cili urdhëroi që menjëherë të përfundojë kjo ceremoni. M’i mbështollën duart dhe këmbët së pari me rube e pastaj me najlon dhe m’i shtrënguan mirë me llastik. Më çuan në një dhomë tjetër nën përcjelljen e disa vajzave të cilat kishin mbetur edhe këtë natë për të bujtur e mua. Për herë të parë e doja dhe e urreja njëkohësisht familjen time. Si të mos e doja, e kam familje ku kam lindur e jam rritur. Janë pjesë e jetës sime e nuk do t’i shoh ndoshta kurrë më. Ky mendim ma ndalte frymën dhe ma lëndonte zemrën. Nga ana tjetër, si të mos i urreja kur askush nuk më besonte, asnjë dëshirë nuk ma plotësuan... Kjo natë m’u duk si njëqind vjet, nuk fjeta asnjë minutë. Gjithkah më shkante mendja. Nuk e dija se çka po më priste, nuk isha e përgatitur dhe e informuar mjaft sa i përket martesës. Por jam mbështetur te Zoti i madh e inshallah ai nuk më lë në vetmi siç më kanë lënë të tjerët.

Në mëngjes hynë prapë ato dy shtriga në dhomë.

– Hajde Trëndafille zgjohu se mjaft ke fjetur dhe duhet të mësohesh të zgjohesh më herët.

U zgjova. Së pari m’i hoqën ato që m’i kishin vënë në duar dhe në këmbë dhe i kisha mbajtur tërë natën si pranga. Më thanë që të lahem me ujë të vaket dhe ta shohin a më kishte zënë këna mirë. U pastrova, u vешa për herë të fundit me rroba sportive. Më ulën dhe filluan të më bënin nuse. Më lyen dhe më ngjyen për qejf të tyre, duke bërë eksperimente. Herë pas here më shikonin dhe qesheshin edhe pse, sipas mendimit tim, nuk kishte asgjë për të qeshur. Më në fund më veshën me dimi e jelek, më veshën dorëza të bardha, ma vendosën një duvak të bardhë në kokë i cili shtrihej mbi shpinën

time të vogël dhe të njomë. M’i mbathën një palë këpucë të bardha me taka të larta mbi dhjetë centimetër, të cilat më bënë të ndihesha sikur të m’i kishte lidhur dikush dy cunga në këmbë dhe të kërkonin nga unë që të ecja nëpër dhomë për t’i ushtruar këmbët. Gati sa nuk u rrëzova sepse nuk dija të lëvizja me hapa normalë. Më quan në një dhomë ku mund të vinin të më shihnin të gjithë ata që ishin të interesuar, të ftuar e të paftuar, kuptohet vetëm gra e vajza sepse për meshkuj kjo ishte zonë e ndaluar. Sapo arrita te vendi im ngrita pak kokën dhe pashë se dhoma ishte mbushur përplot me gra, shumicën e të cilave kurrë nuk i kisha parë në jetën time. Në vend të nënës, e para erdhi gjyshja që t’ia merrja dorën ashtu siç ishte zakon dhe pas saj të gjitha me radhë. Këmbët më dhembnin në ato këpucë por nuk guxoja të flisja, dhe, edhe nëse e hapja gojën ndonjëherë, këtë e bëja vetëm për të marrë frymë thellë. Rrobat me të cilat më kishin veshur, ishin të rënda, më shtrëngonin dhe ma ndalnin frymën. Në dhomë hynin e dilnin shumë gra e vajza të cilat donin që t’ua merrja dorën. Kishin ardhur edhe disa vajza nga shkolla ime. Filluan të më dridheshin këmbët edhe më tepër. Nuk m’i ndanin sytë për asnjë çast. Pas disa orësh më larguan nga dhoma ato dy shtriga që të mund të ulesha e të pushoja pak dhe ta njomja fytin që më ishte tharë e bërë shkrumb pa e pirë asnjë pikë ujë. Sa njeriu ka hyrë e ka dalë sot nga kjo dhomë, sa që e kanë rënduar edhe ajrin. Disa prej tyre, do të ishte më mirë të mos e hapnin gojën fare, ngase era e gojës ta zinte frymën. Disave të tjerave që u dukej vetja se ishin bërë të bukura duke u parfumosur me parfume të lira e të këqija, era e tyre do t’i mbyste mizat jo vetëm të shtëpisë por edhe të lagjes.

Nuk më lanë të pushoja gjatë. Piva pak ujë, hëngra një copë bukë, u pastrova, dhe i futa këmbët prapë në ato këpucë të rënda, me take të larta e të ngushta. Shpresoja të mos kishte shumë mysafirë dhe lutesha të mos vinin më të tjerë. Por, sapo hyjmë prapë në dhomë, u binda se shpresa dhe lutjet e mia ishin të kota. Dhoma ishte plotë e përplot, disa kishin shkuar e më shumë të tjerë kishin ardhur. Filloi të më vinte nxehtë por kur i pashë në mesin e tyre edhe disa shoqe

të klasës dhe dy motrat e Shkëlqimit, m'u bë një lëmsh në fyt, dhe fillova të djersitesha, madje nuk bënin punë as pahitjet që m'i bënin. Edhe ato dyjat erdhën si të tjerat që t'ua merrja dorën. Nuk e folën asnjë fjalë, vetëm me ndiqnin me sy në një formë që s'mund ta përshkruaj, por thellë në zemër e ndieja se më urrenin. Dorën ua mora të gjithave me radhë, ndërsa atyre dyjave ua shtrëngova më shumë, që për mua përbënte respekt më të veçantë dhe dashuri ndaj dikujt. Ende pa u larguar shoqet nga dhoma, halla më pëshpëriti në vesh se kanë ardhur ata të familjes së Halimit për të më parë dhe më tha se duhej ta bëja çehren më të mirë. Të flisja nuk guxoja por u përbiva njëherë dhe mora frymë aq thellë që ta largoja nga mendja Shkëlqimin.

Në dhomë hynë rreth pesëmbëdhjetë veta të cilave u bënë vend në krye të dhomës dhe i shërbyen me pije freskuese dhe llokume. Të gjitha me shikonin mua gjatë gjithë kohës. Ndenjën rreth gjysmë ore, por mua m'u duk se ndenjën shumë më gjatë, sepse nuk e kuptoja pse kishin ardhur të më shihnin kur unë edhe ashtu pas disa orësh do të shkoja nuse me krushqi në shtëpinë e tyre...

Vazhdimisht hynin dhe dilnin gra dhe vajza. Më bëhej se i tërë qyteti ishin qar këmbë dhe kishin ardhur të më shikonin mua që isha bërë nuse. Më torturuan deri kah ora pesë pasdite. Atëherë më çuan prapë në dhomën tjetër ku i zhvesha me shpejtësi rrobat që më pengonin aq shumë, e veçmas dimitë të cilat gati sa nuk u pshurra në to, derisa i gjeta këmbët që më ishin mbështjellë në dymbëdhjetë metra stof. Për herë të parë pas shumë kohësh ndjeva lehtësi kur u ktheva nga tualeti sepse kishte qenë duke me plasur fundi i barkut. Sapo hyra në dhomë e gjeta darkën të përgatitur. Më kishin bërë pite, oriz me mish, sallatë dhe ëmbëlsirë.

Ndonëse isha shumë e uritur, nuk mund ta kapërdija asnjë kafshatë derisa erdhi Teuta e më tha se dua të ha darkë me ty edhe sonte se të kam motër dhe të dua shumë, edhe pse ndonjëherë të kam nervozuar. Derisa po hanim bukë, Teuta më tregonte se çka po ndodhte jashtë, sa shumë njerëz kishin ardhur, si ishin të veshura etj.

– Ha më shpejt Trëndafile se duhet të të lyej prapë e të ta vesh vellon se krushqit vijnë të të marrin kah ora shtatë, ngase Halimit nuk po i pritet (ha ha ha) qeshej ajo, pastaj thoshte; hajt se të ka provuar edhe më herët dhe qeshej prapë.

O zot i madh, nuk po më linin rehat të haja as darkën e fundit në shtëpi të babës me motrën time që e doja dhe më donte pa masë. M’i lanë në fyt kafshatat e fundit duke më trajtuar si të isha fëmijë i huaj, kopil apo fëmijë magjupi, si thonë. Nuk po mund të ngihen këto kuçedra. Pastrova dhëmbët dhe më në fund ma veshën vellon dhe më ulen në një karrige ku duhet të rrija derisa të vinin krushqit. Kah ora shtatë dëgjohej sirena e makinave e përcjellë nga kënga dhe muzika. Më kapën për krahu ato dyja që bënë sikur më donin aq shumë e kujdeseshin për mua kurse në realitet m’i kishin bërë gjithë ato të zeza...

Na hapën rrugën të gjithë, dhe më dukej se ishin mbledhur edhe më shumë njerëz. Zbritën ngadalë shkallëve. Sytë më duhej t’i mbaja të ulur dhe shihja vetëm këmbët e mia. Në fund të shkallëve më priste vetura në të cilën duhej të hyja. Lëvizja me shumë kujdes që të mos e këpusja një pe të kuq të cilin ma kishin lidhur rreth belit dhe duarve e të cilin duhet ta këpusja vetëm pasi të dilte vetura nga oborri. Deri në veturë më përcolli gjyshi, pasi që në shtëpi nuk e kisha babain apo një vëlla të rritur, ndërsa Adriani ishte shumë i vogël. Fillimisht më mori ngryk gjyshi i cili me një zë të dridhur më bekoj dhe më uroi fat, pastaj m’u afrua gjyshja, hallat, tezeta... Kur m’u afruan Teuta dhe Adriani, filluan të më rrjedhin lotët krua. U përqaftova, i putha që të dy, ju thashë që i dua shumë. Edhe ata qanin njëllor si unë dhe nuk largoheshin derisa nga oborri i shtëpisë së babës, ngase thonë se nëse ulem nuk do të bëhem rehat në atë shtëpi ku do të shkoja dhe do të mbesja përgjithmonë në shtëpi të babës (pallavra).

Edhe pse iu përmbajta disa rregullave që më kishin këshilluar dhe nuk u ula derisa vetura nuk doli nga oborri, vetëm pas pak ditësh fillova të mos ndihesha rehat.

VII

Në shtëpi të Halimit mysafirët vinin njëri pas tjetrit pa u ndalur. Gëzohesha kur vinte koha për të shkuar në shtrat. Më dhembnin këmbët nga takat e larta. Çdo mëngjes më duhej të zgjohesha herët, ta laja oborrin, t'i laja dy palë shkallë, dhe nevojtoreshën që gjendej nën shkallë. Pastaj më duhej t'u bëja kafe të gjithëve, njërit pas tjetrit, kur zgjoheshin. Për çdo ditë ishte në program të ma bënin frizurën, të më grimonin dhe të më vishnin sipas dëshirës së tyre. Asnjë ditë nuk më linin të qetë. Më dukej vetja si një robot e jo si njeri nga gjaku e mishi. Gjithsesi duhej të zgjohesha e para dhe ta fshija oborrin e pastaj derisa vjehrra përgatiste mëngjesin, mua me duhej t'i pastroja dhëmbët ku më ndihmonte edhe motra e Halimit që ishte e pamartuar. Hanim mëngjes me shpejtësi para se të vinin mysafirët. Pothuajse nuk kalonte ditë pa mysafirë, ngase familja e Halimit merrej me tregti dhe kishin shume miq... Halimi punonte në shitoren e këpucëve e cila gjendej në katin përdhës të shtëpisë. Ndonjëherë nuk kisha uri ngase isha e pagjumë, e ndonjëherë nuk më pëlqenin gjellët e tyre, ndërsa kur më pëlqenin, më vinte turp të haja shumë! Nuk kalonte një ditë e vetme që të mos vinte dikush në kohë të drekës. Vendin e kisha gjithnjë te dera në një karrige të mbuluar me një boshçe të qëndisur që e quanin karrigia e nuses. Për fat të keq shumë rrallë më binte të ulesha në atë karrige sepse më duhej të shërbeja dhe të rrija në këmbë derisa ta pinin kafen dhe t'ua merrja filxhanin. Pa urdhër të vjehrrës nuk mund të ulesha, por edhe kur ulesha, më duhej të ngrihesha sa herë që hynte dhe dilte dikush, qoftë edhe ndonjë fëmijë. Ndoshte shumë herë që ende pa i përcjellë mysafirët e parë, vinin të tjerët. Halimi kishte pesë motra, tri prej të cilave kishin edhe fëmijë. Nganjëherë hanim drekë e nganjëherë jo, për shkak të mysafirëve. Kur vinte koha e darkës, shumë herë shtroheshin nga dy sofa të mëdha, dhe sigurisht nusja ishte ajo që duhej të ulej e fundit në sofër. Shumë herë kam ngelur pa hëngër bukë. Derisa të tjerët hanin qetë dhe shijshëm, mua me duhej të haja

me shpejtësi e të qohem e para nga sofa dhe ta përgatisja çajin. Merrja legenin dhe u qitja ujë duarve të gjithëve sepse nuk donin të dilnin e t'i lanin duart në çezme. Torturë të veçantë përbënte qitja e çajeve. Secili e kërkonte për qejf të vet, dikush më të lehtë, dikush më të rëndë, dikush me më shumë sheqer, dikush me më pak, dikush me limon, e dikush pa të, ndërsa fëmijëve pak më të ftohtë.

– Hajt nuse na i sjell edhe pak leblebija, e fëmijëve pak keksa...

Kjo torturë vazhdonte çdo mbrëmje dhe sapo i laja gotat e fundit, duhej t'i ndihmoja kunatës së pamartuar që t'i shtronim shtretërit. Kunatat e martuara që shpesh bunin aty me fëmijët e vet, flinin të shpërndara në dhoma të ndryshme dhe duhej t'ua shtronim shtretërit. Pasi i laja enët dhe i rendisja nëpër vendet e tyre, vetëm me urdhër të vjehrrës mund të shkoja për të fjetur, dhe atë vetëm pasi t'ua merrja dorën e t'u dëshiroja natë të mirë të gjithëve me radhë. Kur shkoja në dhomë, Halimi më priste i zhveshur, që nënkuptonte torturë të radhës për mua...

Mbas një jave më çuan për së pari në familjen time. Më çoi Halimi deri te dera e shtëpisë, por nuk hyri brenda. Më lejuan që të buaj dy net dhe kjo më gëzoi pa masë. Më kishte marrë malli shumë për Teutën dhe Adrianin, por edhe për gjyshërit. Sapo më hetuan që hyra në oborr, vrapuan drejt meje. U përqaftam me shumë mall. U futëm në shtëpi ashtu të përqaftuar, dhe gjyshin e gjetëm në vendin e tij të zakonshëm, ndërsa gjyshja ishte shtrirë për të pushuar dhe e kishin mbuluar me një batanije. Hallën, për fat, nuk e gjeta aty. Ajo kishte shkuar për të pirë kafe te fqinjët. Kafe, cigare, fall dhe përgojim të njerëzve, ky ishte pasioni i saj. Gjyshi me një zë të ëmbël më dëshiroi mirëseardhje dhe për çudi u zgjua edhe në këmbë për mua. Ndërsa gjyshja ashtu e ulur më tha mirë se erdhe. Unë u ula, e përqaftova, por nuk vëreja ndonjë ndjenjë tek ajo. Më pyeti siç është adeti dhe me kë kam ardhur. Kur u tregova se Halimi më kishte sjellë deri te dera dhe nuk kishte hyrë brenda, gjyshi sikur u prek dhe tha se është dashur së paku të hynte e ta pinte një kafe.

– Trëndafile, bija ime, mos ta bëjmë punën edhe më keq, je e

re dhe ke gabuar, andaj mos të të vijë turp. Kape telefonin, thirre babain dhe kërkoi falje për të gjitha. Qaj sa të mundesh dhe ndoshta e shtien në gjynah e ta fal, edhe pse për të nuk është e lehtë, ishin fjalët e gjyshit.

Nuk e di nëse e kuptova mirë porosinë e gjyshit. Më dukej se nuk më kishin hije rrobat e veshura, nuk ndihesha mirë me to. Disi më dukej vetja si e huaj. Në atë shtëpi ku isha rritur dhe kisha jetuar deri para disa ditësh, çdo gjë kishte ndryshuar, nuk ndihesha më e lirë dhe e lumtur, por nuk më shkohej as në shtëpi të Halimit. Më dukej vetja si një jetime që nuk ka vend askund. Sa e çuditshme është jeta, sa i çuditshëm është fati im. Aty ku më duhet të jetoj nuk ndihem fare e lumtur, ndërsa aty ku do të jetoja me dëshirë, mund ta përjetoja vetëm në ëndërr. Të vetmit që i jepnin kuptim jetës sime në atë çast ishin Teuta dhe Adriani, me të cilët fjeta së bashku në një dhomë siç flinim përpara.

Të nesërmen nuk ndryshoi asgjë. Gjyshja vazhdoi të rrinte indiferente, ndërsa ato dy shtrigat që bëheshin si melaqe, ndaj meje sillleshin sikur të isha një lavire, një e pafe, një e pandershme. Për çudi para disa ditësh pikërisht ato shtireshin para njerëzve sikur më donin mua dhe brengoseshin për fatin tim. Thuhet se ka njerëz me dy fytyra, por këto të dyjat kanë nga shumë fytyra, apo siç thuhet janë shëriat për shtat. Por unë po i mbështetem Zotit të madhërishtëm i cili është një dhe i sheh të gjitha.

As të nesërmen nuk erdhi kush të rri te ne ashtu siç ishte zakon që kur të vijë bija së pari, e pritnin të gjithë me padurim. Ishte një atmosferë e ftoftë akull si dimri në Siberi. As prindërit nuk thirrën në telefon. Dy ditë më kaluan kështu dhe u binda se në këtë shtëpi nuk kishte vend për mua. Situata kishte ndryshuar siç kisha ndryshuar më shumë. Kur u përshëndeta për t'u kthyer në shtëpi të Halimit, ndjeja një zbrazëti të pafund. Doja të qaja por nuk më dilnin lotët. Doja të flisja por as fjalë nuk kisha, më dukej vetja sikur të isha prej druri. U përshëndeta me të dy gjyshërit dhe ato dy shtrigat, ndërsa Teutën dhe Adrianin i përqafova shumë. U nisa rrugës si një drenushë e

plagosur dhe derisa ecja, shumë herë më mbushej mendja t'i dilja përpara ndonjë makine, por hiqja dorë nga ky veprim sepse nuk doja që ta merrja në qafë dikë. Pastaj nuk mund të bëhesha katil i shpirtit tim sepse këtë nuk e lejon feja jonë myslimane, nuk e lejon kurani të cilin e kisha mësuar tri vjet me radhë.

Ndryshime të mëdha nuk kishte në shtëpi të Halimit, jeta vazhdonte dhe gjithçka sillej si akrepat e orës. Askush nuk e hapi këtë derë për mua, askush nuk më bëri telefon. Ndihesha sikur një lule e vetmuar në saksi që priste ta ujisë dikush pas vapës së madhe. Kaluan kështu dy muaj prej se për herë të fundit kisha parë dikë nga familja ime. Pëshpëritej se kishin ardhur prindërit në pushim. Sa herë që hapej dera e oborrit, prisja që të vinte dikush të më vizitonte. Halimi, sa herë që kthehej në shtëpi, e sillte ndonjë lajm. Flisnin pas shpinës sime kundër familjes sime. Ndonjëherë fjalët arrinin edhe deri tek unë. Halimi ka filluar të ndryshojë. Nuk po i mban më fjalët dhe premtimet e dhëna. Po del në mbrëmje nga shtëpia dhe po kthehet vonë duke u arsyetuar se ishte me shoqëri. Më vonë filloi të mos vinte edhe në kohë të darkës, e dikur nisi të mos vinte deri pas mesnate. O zot i madh, çka po ndodh me mua? Pse po dënohem në këtë mënyrë? Ditët më kalonin duke i bërë punët, duke bërë kafe, duke pritur e përcjellë mysafirë. Isha bërë si një robot. Të gjithë shkonin diku, ndërsa vetëm unë si e cunguar mbetesh në shtëpi e mbyllur si një zog në kafaz. Kishte kohë që nuk kisha qeshur, kishte kohë që nuk kisha biseduar me dikë. Që sa kohë vetëm lotët më janë bërë. Sa herë që të tjerët shkonin për të fjetur dhe gjumi i përkëdhelte ata, mua më rridhnin lotët derisa lodhesha duke qarë. Halimi filloi tërë natën të mos vinte në shtëpi. Edhe atëherë kur kthehej, i vinte erë aq e keqe nga goja sa që të qohej tugu.

– Mos i trego askujt që jam kthyer në këtë kohë në shtëpi. Mbeta në shoqëri, kemi festuar një ditëlindje...

Kjo iu bë përditshmëri Halimit, dhe secilën herë më gënjente diçka.

– Të dua Trëndafile, – mezi i shqiptonte fjalët, nuk më lente

të paktën me hallet dhe mërzinë time, por kërkonte të bënim marrëdhënie seksuale.

– Eja zhvishu, mos prit të të zhvesh unë, a nuk po e sheh që mu ka qu dhe mu ka bërë guri. Nuk të kam marrë vetëm të të shikoj me sy, të kam zgjedhur ndër më të bukurat e qytetit sepse i ke pëlqyer edhe këtij shokut tim të vogël. Sa herë që më shkonte mendja te ti, më duhej të masturboja se përndryshe nuk mund të qetësohej ky shoku im i vogël.

Pa më pyetur fare me shtrinte në shtrat, m'i shtrëngonte duart dhe më përdorte si një lodër për t'i shfryer epshet e tij. Nuk kam ndier asnjëherë kurrfarë kënaqësie dhe nuk po e kuptoj se si të gjitha femrat kurrë nuk më kanë treguar se sa e gërditshme qenka të bësh seks me dikë që nuk e ke dashuruar asnjëherë. Për mua kjo përfundonte gjithmonë me dhimbje.

Ato pak net kur Halimi ishte në shtëpi, sillte nga videoteka videokaseta me përmbajtje pornografike dhe nuk i pritej sa të shkonim në shtrat. Menjëherë e mbyllte derën dhe lëshonte televizorin. Kurrë nuk kisha parë më herët gjëra të tilla, kur dy apo tre meshkuj njëkohësisht bënin seks me një femër, ndërsa ajo bërtiste nga kënaqësia. Nuk mund ta besoja se si mund të kënaqej një femër duke bërë seks njëherësh me tre meshkuj të ndryshëm. Nuk mund ta kuptoj se si mund të funksionojë seksi pa dashuri të vërtetë. Derisa unë shikoja me sy të hapur dhe nuk mund ta kuptoja këtë lloj kënaqësie, mbase për shkak se nuk kisha përjetuar kurrë kënaqësi seksuale, më shkonte mendja te Shkëlqimi me të cilin isha e bindur se do ta kisha përjetuar këtë kënaqësi. Derisa mundohesha ta paramendoja se si duket Shkëlqimi pas shumë muajve, Halimi ma kapte dorën dhe ma çonte drejt penisit të tij i cili kishte ereksione pa masë. Ai dëshironte që t'i provonte disa gjëra si në videokasetë... Sa budallaqe që isha. Në fillim mendoja se kështu bëjnë të gjithë dhe se është normale dhe gruaja të bënte atë që i kërkonte burri. Po çuditëm me vetveten si nuk e dija se ku kishte mbetur ajo Trëndafilja e vjetër. Nuk po mund ta kuptoj se si kisha mundur ta lejoja veten të

shndërrohesha në një robëreshë të tij. Nuk po mund ta pranoj se si nga një vajzë inteligjente, e bukur që ishte e dashuruar dhe që kishte shumë plane në jetë me të dashurin e saj, tashmë funksiononte vetëm si objekt i të tjerëve, gjatë ditës për familjen e Halimit, ndërsa natën për dëshirat e tij seksuale. Më shkonte shumë herë mendja që të ikja, por nuk e dija se ku të shkoja. Shumë herë më shkonte mendja te Shkëlqimi por nuk kisha guxim ta thërrisja. Me siguri më nuk i intereson për mua, sepse unë e dija shumë mirë se si flitej për femrat të cilat kishin pasur fatin sikurse unë...

VIII

Pas pesë muajsh mbeta shtatzënë. Të gjithë u gëzuan ngase që nga dita që isha bërë nuse, nuk kishin lënë hoxhë pa më shkruar. Në fillim për fat, dhe pastaj për mësysh, e mbas disa javësh për të mbetur shtatzënë. Sa më përket mua, as isha gëzuar e as hidhëruar. Kjo shtatzëni për mua nuk ndryshonte asgjë, ngase më duhej t'i kryeja punët njëjtë si më parë, askujt nuk i interesonte për shëndetin tim. Nganjëherë kur lodhesha shumë, i lutesha vjehrrës që të më lejonte të pushoja pak në mesditë. Shumë herë prejse jam shtatzënë, kur vinte koha e drekës, më mbylleshin sytë edhe duke ecur. Halimit nuk i interesonte kjo punë, ai vazhdimisht dehej, vinte vonë apo nuk vinte fare në shtëpi tërë natën. Një natë kishte ardhur shumë vonë. Unë, e lodhur nga punët e ditës dhe shtatzënia, nuk doja asgjë tjetër përveç gjumë. I vinte erë e keqe. Ashtu i dehur fillonte të më zhvishte dhe për herë të parë protestova, por edhe e luta të më linte të qetë se isha shumë e lodhur. Nuk hiqte dorë derisa i thashë qartë se sonte nuk dua t'i hapi këmbët për të.

Oh Zoti e vraftë të pamëshirin. Më kapi për floku dhe më shtyri me kokë për muri duke më goditur me grushte fytyrës derisa ma çau buzën dhe duke më ofenduar me fjalë të ndyra. Ma shante tërë familjen me radhë dhe vazhdoi torturat derisa trokitën në derë prindërit e tij që ishin zgjuar nga zhurma dhe britma. Babai i tij për herë të parë e vërejti se Halimi ishte i dehur. Ai ishte njeri shumë fetar dhe në familjen e tyre nuk lejohej të përdorej alkooli.

– Çka po bën kështu or i pashpirt? Çka të ka bërë kjo e ngratë që po e rrah? A nuk po të vjen aspak gjynah që është shtatzënë?

– Jo nuk po më vjen, nuk e dua më këtë magjupe. Nesër në mëngjes le t'i mbledhë plaçkat dhe le ta thyejë qafen, do t'ia kthej babës së vet kështu të fryrë. Nuk dua më ta shoh këtu...

Isha e ulur në një skaj të krevatit dhe lotët më përziheshin me gjakun që vazhdonte të më rridhte nga buzët. Nuk dija se çka të bëja. Babai i tij mundohej ta qetësonte, i thoshte shko pusho njëherë e kur

të kthjellohesh, në mëngjes i bisedojmë të gjitha. Ndërsa sa i përket kthimit të Trëndafiles në shtëpi të babës së vetë, mos e përsërit edhe njëherë këtë fjalë sepse ti e ke sjellë vetë në shtëpi dhe e di mirë që nuk ke lënë gjë pa bërë me të. Mos harro se do të behësh baba, kujtohu mirë se çka po bën dhe si po sillesh sepse askush nuk të ka detyruar me zor të martohesh...

Nuk kisha si ta fshihja fytyrën që më ishte fryrë si bukë samuni dhe nuk kishte grim që mund t'i mbulonte njollat e zeza nëpër fytyrë. Fatkeqësisht kjo gjë përsëritej vazhdimisht dhe nuk gjeja rrugëdalje tjetër përpos të bëja vetëvrasje. Mendoja ta varja veten apo të helmohesha. Gati për çdo ditë më shkonte ndërmend një gjë e tillë, po nuk mund ta bëja. Zemra nuk dëshironte të jetoja më, ndërsa nga mendja nuk më hiqej mësimi që kisha bërë në xhami se nuk duhet të bëhesha katile e shpirtit tim, por as katile e një shpirti të vogël ende të palindur që mbaja në bark.

Halimi, si gjithmonë, natën e kalonte nëpër lokale me prostituta nga Bullgaria apo Moldavia, dhe vinte i dehur. Më rrihte, më torturonte dhe më detyronte dhunshëm që të shkoja me të në shtrat. Ai gjithmonë më dhunonte... Barku më rritej çdo ditë e më shumë. Nga lodhja dhe pagjumësia më dhembnin këmbët dhe shpina dhe prisja me padurim që të vinte nata, t'i shtrijsa këmbët dhe ta pushoja trupin. Nuk mund ta përballoja më këtë jetë si në kafaz. Ndoshta dikujt tjetër edhe do t'i pëlqente sepse në këtë shtëpi bliheshin rrobat dhe këpucët më të mira e më të shtrenjta, hahej ushqimi më i mirë, ta sillnin frizerin në shtëpi, çdo rrugë, sado e shkurtër, bëhej me veturë, ndërsa ar e argjend kishte secili me kilogram. Por mua nuk më joshte asgjë nga këto sepse më mungonte mirëkuptimi, kënaqësia, më mungonte dashuria e hareja. Buzëqeshja në fytyrën time ishte larguar kaherë dhe kishte marrë rrugën e pakthim. Nga vuajtjet shpirtërore, goja, sytë dhe fytyra më ishin deformuar. Shumë herë e pyesja veten se a u bie ndërmend prindërve të mi për mua? Si mund të shtirem sikur të mos kisha ekzistuar fare? Thuhet se çdo prindi i dhemb zemra për evlat të vet, por unë nuk po mund të bindem për

këtë. Ata ndoshta mendojnë se unë jam e lumtur dhe po kënaqem e nuk e dinë se për çdo ditë po e lus Zotin që kur të bie në gjumë, mos të zgjohem më. Ata nuk e dinë se pikëllimi dhe vuajtja vetëm se më janë shtuar më shumë. Nuk mund t'i kuptoj se si po kalojnë kah dera dhe nuk kthehen të më shohin, të më pyesin se si jam, ta shohin ku dhe me kënd po jetoj...

E kam të qartë se edhe unë kam gabuar, por shumicën e gabimeve m'i kanë imponuar, ndërsa gabimet tjera i kam bërë nga frika dhe mosbesimi sepse askush nuk më besonte. Shumë herë pyesja Zotin pse më ka falë, por edhe më shumë po e pyes pse nuk po ma merr shpirtin kur po e sheh se kaq shumë jam duke vuajtur...

Duke vuajtur kështu herë më shumë e herë më pak, kaluan nëntë muaj të shtatzënisë, disi i gëzohesha ardhjes në jetë të bebes sime, ngase nuk do të isha më e vetmuar. Ajo do t'i jepte kuptim jetës sime. Nuk e dija a do të lindte vajzë apo djalë, por për mua kjo nuk ishte me rëndësi. Kisha frikë se si do të kalonte lindja sepse gjatë gjithë shtatzënisë isha vetëm një herë te mjeku, edhe atë kur kisha dhimbje të mëdha para disa muajve.

Emrin ia kisha gjetur verës kur ishim në det, atëherë kur për herë të parë u lirova nga kafazi. Nëna e Halimit dëshironte gjithsesi të shkonte në Ulqin me një shoqe, duke thënë se i bënte hair për reumë dhe pasi që Halimi duhet t'i çonte me veturë, vendosën që të më merrnin edhe mua. Edhe pse nuk kisha qenë asnjëherë më parë në det, nuk gëzohesha fare, i vetmi lehtësim që ndieja ishte se liroheshja nga ky burg shtëpiak, të paktën për disa ditë. Nuk ndieja kurrfarë kënaqësie. Vjehrra më rrinte në kokë si xhebraili duke më mësuar se çfarë duhej të haja, çfarë të pija, a duhej të rrija në diell apo nën hije, a duhet të hyja në det apo jo. Për çdo gjë gjendej ndonjë koment vetëm që të mos më linte rehat. Halimi dëshironte të shkonte për çdo mbrëmje nëpër muzika dhe kur nuk i konvenonte nënës së tij, ajo më drejtohej mua me stilin kur nuk mund t'i mëshosh kalit, bjeri samarit. Halimi duke mos e ditur të vërtetën, më urdhëronte secilën herë që ta mbyllja gojën dhe për ato dy javë sa ishim në det më

kishte rrahur disa herë. Një natë pasi u kthyem nga muzika, unë rrija si e ngujuar në një tavolinë me një pije, ndërsa Halimi nuk ndalej së kërcyeri me shumë femra që gjendeshin aty. Shkonte prej tavolinës në tavolinë për t'i cakërruar gotat derisa mbetëm aty pothuajse të fundit. Kur u kthyem në banesë filloi të më ngacmojë me fjalë. Unë isha e lodhur dhe nuk dëshiroja të fjalosesh me të, por ai nuk më linte rehat. Kur i thashë se jam e lodhur dhe po dua të fle, filloi të më mëshojë me shuplaka fytyrës, ndërsa kur i vura duart përpara që të mbrohem, atëherë i pashpirti nisi të më mëshonte në bark duke më thënë lindma fëmijën tim e ti inshallah vdes menjëherë! Në ato çaste, pa menduar fare, ashtu me këmishë të natës u nisa rrugës kryesore që ishte vetëm disa minuta larg banesës. Kisha vendosur që t'i dilja përpara veturës së parë që do të vinte, sepse nuk mund t'i duroja më ato tortura. Por, për fat të keq më erdhi Halimi papritur mbrapa shpine dhe duke më tërhequr zvarrë, më çoi në banesë. Qava tërë natën pa ndërprerë derisa m'u shterën lotët. Nuk po arrij t'i kuptoj këta njerëz. Lëre që nuk po më lejojnë të jetoj, por nuk po më lejojnë as të vdes. I vetmi përjetim i mirë në këtë pushim ishte kur u njoftova me një familje nga Peja që kishin dy fëmijë. Ata rrinin vetëm dy tri metra larg nesh dhe ishin të moshës rreth 35 vjeçare, ndërsa fëmijët, vajza ishte gjashtë vjeçare, ndërsa djali 5 vjeçar. Ishin të dy shumë të bukur, por edhe emrat e tyre më pëlqyen shumë, andaj edhe vendosa që nëse më lind vajzë, ta quaja Merita, ndërsa nëse më lind djalë, ta quaja Meriton.

Më 30 dhjetor patëm mysafirë pothuajse si gjithmonë. Ishin aty të gjitha motrat e Halimit, derisa njëra bëhej gati që pas darke të shkonte në shtëpi të vet, të tjerat kishin vendosur që festën e Vitit të Ri ta kalonin aty. Pasi e përcollën atë, prindërit e Halimit shkuan për të fjetur, ndërsa unë me shpejtësi i pastrova dhëmbët sepse kisha shumë të ftohtë. U thashë të gjithëve natën e mirë dhe vendosa të shkoja të shtrihesha në shtrat, ndërkohë që Halimi mbeti të rrinte edhe pak me motrat e veta. Nuk më prishej qejfi aspak që nuk vinte me mua në dhomë, madje gëzohesha kur nuk ishte ai aty. Ende pa

i mbyllur sytë nisi të më dhembte fundi i barkut. Ishin dhimbje të shkurtra dhe të rralla, por isha aq e lodhur dhe nuk mund t'i hapja sytë, dëshiroja vetëm të flija. Dhimbjet nisen të më shpeshtoheshin dhe të bëheshin pak më të forta. Dola dy herë në tualet duke menduar se do të më ndihmojë diçka, por nuk më pushonin dhimbjet. Duke u kthyer brenda, më hetoi motra e pamartuar e Halimit. Më pyeti se çka kisha dhe i tregova se kam dhimbje të cilat nuk po më ndalen. Më ndihmoi që të hyja brenda dhe i thirri motrat tjera dhe e njoftoi edhe Halimin. Erdhën të gjithë në dhomën time ku më gjetën të përkulur. Nuk mund të rrija asnjë minutë në një vend. Dhimbjet sa vinin e më shtoheshin dhe ishin secilën herë më të forta. M'i përgatitën me shpejtësi disa rroba, ndërsa Halimi e ndezi veturën dhe u nisëm menjëherë për në spitalin e Gjakovës.

Gjatë tërë rrugës nuk më pushuan lotët nga dhimbja, ndërsa motra e vogël e Halimit që erdhi me ne, mundohej të më qetësonte. Në një vend na ndali policia pasi që Halimi kishte vozitur shumë shpejt, por na liruan kur e panë se unë isha me dhimbje të lindjes. Sapo arritëm në spital, më futën në një sallë ku më kontrolluan. Ishte bërë ora diku rreth një pas mesnate.

– Zonjë, edhe pse ke dhimbje, ti ende nuk je gati për të lindur. Shëtitu këtu nëpër dhomë dhe duro pak sepse barna nuk guxojmë të të japim. Nëse të pushojnë pak dhimbjet, ja ku e ke një shtrat ku mund të pushosh, – më tha mjekja dhe u largua.

Dhimbjet nganjëherë ma ndalnin frymën, por çka ishte një gjë e çuditshme, kurrë në jetën time nuk më ka ardhur gjumi më shumë se në ato çaste. Gjumi dhe dhimbja më kishin kapluar. Ishte një kombinim i rrallë dhe i çuditshëm!

Pas dy apo tri orësh dhimbja ia mori primatin gjumit. Edhe pse ishte kjo për mua lindja e parë dhe mjekja më tha që ende nuk ishte koha për të lindur, ndjenja dhe dhimbja më thoshin diçka tjetër. Ashtu me një gjysmë shpirti dola në korridor ta gjeja dikë. Dhoma e mjekëve gjendej përballë dhe duke i ngrehur këmbët zvarrë, arrita deri te dera dhe trokita, por pa e pritur fare përgjigjen, e hapa derën

duke bërtitur se kam dhimbje të madhe.

– Zonjë, ju duhet të prisni në dhomë e jo të shëtitni nëpër spital, – u dëgjua zëri i mjekes kujdestare, e cila erdhi nga korridori e jo nga dhoma.

– Kam dhimbje shumë të mëdha, ju lutem më besoni.

– Eja të kontrolloj edhe një herë.

Sapo u shtrina, ende pa i hapur mirë këmbët, mjekja filloi të bërtiste shpejt, shpejt, se fëmija po don me dalë. Menjëherë arritën aty edhe dy motra ndihmëse.

– Merr frymë thellë dhe jepi zor me gjithë fuqinë që ke.

Këtë fjalë e përsërisnin pa ndërprerë. Unë veproja ashtu siç më thoshin dhe nuk e di sa kohë ka zgjatur deri në çastin kur e dëgjova zërin e bebes që qante. M’u kthjellën sytë që në atë çast, por m’u larguan edhe dhimbjet sikur të m’i kishte hequr dikush me dorë!

– Është një vajzë e bukur dhe e shëndoshë. Urime zonjë, mbaja pak dorën derisa t’ia pres kërthizën.

O Zot i madhërishtëm, të faleminderit për këtë krijesë kaq të bukur. E mbaja për atë dorën e vogël dhe të njomë derisa mjekja ia preu kërthizën. Ishte një ndjenjë që nuk mund të përshkruhet më fjalë. E pastruan, e matën, e lidhën dhe ma prunë në krahun tim atë shpirt të vogël që i përngjante një engjëlli. Ishte e bardhë si biluri, kishte shumë flokë në kokë dhe të zeza si korbi. Shkurt, për mua ishte fëmija më i bukur që kisha parë ndonjëherë. Mbretëresha e nënës! Ende nuk mund ta besoja se isha bërë nënë! Ishte një ndjenjë vërtet e çuditshme...

– Kjo vajzë e bukur e ka emrin Merita, e nderuar mjekje. Mund ta regjistroni menjëherë, jam shumë e sigurt dhe nuk më duhet kohë që ta mendoj.

– Atëherë e gëzofte emrin vajza juaj zonja Trëndafille! Ju tash duhet të pushoni që të dyjat, dhe ma morën vajzën. Ato kishin të drejtë por unë nuk doja të ndahesha nga zemra ime e vogël.

– Mos u brengos se ne do të kujdesemi mirë për të dhe sapo të keni pushuar pak, do ta sjellim prapë te ju për t’i dhënë gji.

Tri ditë ndenja në spital. Gjatë kësaj kohe m’i mësuan disa gjëra kryesore, për shembull si ta mbaj beben në dorë, si ta lidh dhe ta zgjidh, si t’i jap gji, si ta pastroj e tjera. Me mua në dhomë gjendeshin edhe dy gra tjera, të cilave për çdo orë, nga mëngjesi deri në mbrëmje, u vinte dikush në vizite dhe u sillnin prej shtëpie ushqim. Ndërsa mua për tri ditë vetëm një herë më vizitoi Halimi. Ndihesha shumë e emocionuar dhe e vetmuar. Më shkonte vazhdimisht mendja te nëna ime. O sa kisha dashur që ta shihja, të më përqafoje e mësonte sikur nënat tjera që i mësojnë vajzat e tyre se si duhet të kujdesën për beben. Ndërkohë, ajo nuk e dinte fare që ishte bërë gjyshe. Por e ngushëlloja veten me shpresën se sapo të ketë dëgjuar për lindjen e Meritës, do të vijë e të më shoh. Nuk mund ta paramendoja se ka nënë në këtë botë që mund ta bëjë zemrën akull ndaj pjellës së saj.

Halimi më solli në shtëpi. Sapo hymë në oborr, të gjithë na dolën përpara duke e uruar njëri-tjetrin. Të gjithë dëshironin ta shohin Meritën dhe ta mbanin në duar. Të gjithëve u buzëqeshte fytyra përpos nënës së Halimit e cila nuk mund të rrinte pa folur.

– Nuse inshallah tash një vit na e lind një djalë.

Më erdhi shumë siklet por vetëm u kapërdiva pa ia kthyer asnjë fjalë. Ajo më ngjante në një shtrigë të cilës edhe kur nuk i fliste goja, i fliste prapanica! Motra e Halimit ma kishte ndrequr shtratin në njërën nga dhomat e pritjes. Të paktën këtë herë mund të rrija vetëm shtrirë dhe larg torturave të Halimit. Lehonat thonë e kanë një javë varrin e hapur dhe gjatë kësaj kohe nuk i lejojnë të bëjnë asgjë, madje edhe bukën ua bien në shtrat. Kjo javë do të më bënte mirë sepse më pushonte trupi i lodhur dhe i rraskapitur. Më duhej të qohesha disa herë natën e t’i jepja gji Meritës dhe t’ia ndërroja pelenat, ngase kjo mbretëreshë sapo lagej, fillonte e qante dhe nuk rehatohej derisa e pastroja.

Pas dy ditësh familja e Halimit kishte përgatitur një darkë të madhe në të cilën ishin ftuar të gjithë të afërmit e tyre por edhe të afërmit e mi. Filluan të mblidheshin gratë njëra pas tjetrës, ndonëse ishte afruar koha e darkës dhe kishin ardhur pothuajse të gjithë nga

familja e Halimit, unë vazhdoja të shpresoja se deri në çastin e fundit do të vinte dikush edhe nga familja ime. Kjo sepse një ditë më parë më erdhi një lajm se gjyshja ime kishte qenë në një dyqan për të blerë basmë për fustan për mua që do të ma sillte si dhuratë, kështu që mendoja se së paku gjyshja do të vinte. Pothuajse gjatë tërë mbrëmjes sytë i mbaja kah dera, me shpresën se do të futej gjyshja brenda. Por shpresat e mia ishin të kota. Edhe në këtë mbrëmje më të rëndësishme të jetës sime nuk e kisha askënd nga familja. Gratë që ishin në dhomë, nuk ndaleshin duke hedhur shigjeta fjalësh që ma shponin zemrën time. Kaloi kjo mbrëmje, kaloi edhe kjo javë dhe tani më duhej ta vazhdoja jetën si më parë. Ndonëse kishte kaluar një javë, unë prapë ndihesha shumë e lodhur dhe kisha dhimbje, ecja dhe urinoja shumë me vështirësi. Thithat e gjinjve më ishin plasaritur dhe mua më duhej ta duroja dhimbjen e tmerrshme derisa Merita thithte dhe kënaqej me qumështin që i takonte asaj. Kështu ishte fati im. Po të ishte çdo gjë në rregull, do të vinte nëna në shtëpi dhe do të rrinte së paku dhjetë ditë, e pastaj një javë do të shkoja në familjen e prindërve ku do të mund të pushoja, sepse nëna do të kujdesej për fëmijën. Ndërsa mua as nuk më solli kush petulla, as nuk më thirri kush në telefon që të më urojë lindjen e vajzës, as nuk më vizitoi kush. Sikur të kisha pikur nga qielli dhe të mos e kisha askënd timin. Po çuditë me vetveten se si jam në gjendje t'i përballoj të gjitha këto. Nuk po më mjafton gjumi, ditën as që më lejonin të flija. Mezi gjeja kohë të ulesha për të ngrënë diçka dhe pushoja pak kur duhej t'i jepja Meritës gji. Për fat ajo është shumë e urtë dhe i pëlqen shumë kur përkundet në djep. Derisa nëna e Halimit e përkundte pëllumbeshën time, unë duhej t'i kryeja punët. Kur zgjohej Merita dhe qante, unë gëzohesha! Jo pse ajo qante, por që mund të ulesha pak e ta merrja vajzën time në duar. Por edhe ky gëzim ishte i shkurtër sepse thithat e gjinjve më dhembnin pa masë. Më ishin çarë aq shumë sa që pikonin gjak nganjëherë. Motra e pamartuar e Halimit, që ishte më ndryshe nga të tjerët, një ditë më solli nga barnatorja një yndyrë me të cilin duhet t'i lyeja thithat pasi

t'i jepja gji vajzës. Ajo kishte sjellë edhe një kokërr arre të cilën pasi e kishte çarë përgjysmë dhe ia kishte hequr thelbin, më tha që t'i vendos nëpër maja të gjinjve që të nesërmen filluan të më shërohen majat dhe kjo më ndihmoi shumë.

Mbas një jave m'u shëruan plotësisht dhe prisja me padurim që t'i jepja për të thithur vajzës sime. Kjo ishte një ndjenjë e mirë jo vetëm për mua por edhe për Meritën. Më kënaqej zemra kur e shikoja atë engjëll derisa thithte dhe njëkohësisht me dy duart e vogla mbante gjirin sikur dëshironte ta mbronte që të mos ia merrte kush. Thellë në brendinë time dëshiroja që të isha vetëm me Meritën. Kuptohet pa Halimin të cilin e urreja dhe mërzhitesha për ditën kur do të isha e detyruar përsëri të flija me të. Saktësisht pas gjashtë javësh, kur isha gjysmë e vdekur nga lodhja, sapo e kishte marrë gjumi Meritën, Halimi më zhveshi dhe m'u vërsul si ndonjë kalë i egër. Unë i kisha kthyer sytë nga Merita dhe më rridhnin lotët nga dhimbja dhe trishtimi. Derisa shikoja Meritën që flinte e qetë, i lutesha Zotit të madh që të mos e përjetonte edhe ajo këtë fat si timin. Kisha frikë se prapë do të mbetja shtatzënë. Nuk doja të lindja më fëmijë, së paku jo menjëherë dhe jo me këtë bishë të egër. Sa më shumë që ditët kalonin, aq më të qartë e kisha se unë nuk jetoja si të tjerët për vetveten, por vetëm funksionoja për të tjerët.

IX

Diçka e çuditshme po ndodhte me mua. Kisha filluar të mos e njihja as vetveten. Kam humbur shumë peshë, nuk më hahej as nuk po më pihej. As ndjenja më nuk kisha për asgjë, gjithçka më dukej njëjtë. Nuk mund të qeshja as të qaja. Përgjigjesha vetëm kur më behej ndonjë pyetje, edhe atë vetëm shkurt. Më dukej vetja si një robot pa ndjenja. Kjo qenka skllavëri moderne që i ngjan thënies ‘të rrahin e nuk të lënë ta qash.

Fillova ta humbja edhe atë pak shpresë që e pata se e kisha Meritën dhe nuk më interesonte për të tjerët. Me të më shumë po kalonin kohë të tjerët sesa unë që jam nëna e saj. Ma merrte mendja se po më mbanin në atë shtëpi vetëm që të mos përqesheshin nga njerëzit dhe vetëm sa për t’i dhënë gji Meritës derisa të rritet.

Si të mos mendoja ashtu kur nëna e Halimit filloi të thoshte se sapo të rritet vajza, ajo do të fle me gjyshen, kjo është vajza ime, ju jeni të rinj dhe bëni një fëmijë tjetër për vete.

Nuk mund ta kuptoja se si mund të fliste ashtu ajo budallaqe. Ajo është edhe vetë nënë dhe ka pasur vjehërr dikur, të cilën e kishte përzënë nga shtëpia se nuk mund ta duronte. Ajo shtrigë plakë çdo ditë më ngacmonte me fjalë, vetëm e vetëm që të më detyronte të flisja diçka e pastaj ajo të ankohej te Halimi. Unë vazhdoja të duroja. Mbase atë po e pengonte fakti se isha gjallë!

– Sot je zgjuar më herët, dje më vonë, pse e ke veshur këtë rrobë e jo atë, pse nuk po e ndërron dukatin më shpesh, atë nuk ta kam blerë për ta lënë në dollap ku nuk e sheh askush, as nuk po lyhesh si i ka hije një nuseje. Nuk do të thotë që je një vit në këtë shtëpi e të bësh çka të duash. Ti je ende nuse dhe ashtu duhet të sillësh. Ti nuk po lahesh për çdo ditë! Unë jam vesveselie dhe nuk kam dëshirë që t’i prekësh sendet në shtëpinë time pa u larë, apo nuk të ka mësuar askush se nuk duhet ta kalosh as pragun e derës kur je xhynype! Halimi për çdo mëngjes po lahet ashtu siç e thotë feja, ndërsa ti i ke gjithmonë flokët të terur dhe çka të prekësh me dorën tënde, nuk ka hair!

Oh Zoti i madh, si t'ia shpjegoj kësaj? Unë lahem gjithmonë mbasi më fëlliq ai xhahil dhe jo vetëm për shkak se e thotë feja, por sepse më duket vetja e ndyrë dhe e poshtëruar. Edhe lëkurën e djeg duke e fërkuar dhe prej ujit shumë të nxehtë dhe deri në mëngjes po më teren flokët. Nuk do të thotë se sa herë që Halimi t'i ketë flokët të lagura, ka pasur marrëdhënie me mua. Ku e di unë ku po shkon ai natë për natë, ku e di unë se me çfarë prostituta po e kalon natën. Ai, vetëm kur nuk ka të holla për t'i paguar ato, apo kur nuk e lejojnë se është shumë i dehur, vjen e zbrazet në mua. U përpiva edhe këtë herë si herët tjera.

Shtëpia ishte plot me mysafirë dhe mua më duhej të rrija në këmbë që t'i bëja të gjitha. Halimi shumë herë nuk vinte për darkë në shtëpi pasi e mbyllte shitoren, ndërsa Meritën e mbanin në dorë herë njëri e herë tjetri. Derisa të tjerët hanin, pinin e qeshnin, unë sillesha si një qyqe vetëm duke u bërë hyzmet atyre. Diku ka ora dhjetë, dola deri te dera e oborrit me të tjerët që t'i përcillja mysafirët. Vjehrra më tha se Halimi e kishte veturën para shitores, që nuk do të thotë se është shumë larg, sepse të gjithë e dinin se ai vetëm në wc shkonte pa veturë! Po çka të bej unë tash. Ai me siguri është në këtë kafenenë e fqinjit, se ata i kanë prurë nja dy bullgare të reja. Skam çfarë t'i bëj, po shkoj të fle se jam e lodhur dhe më duhet të zgjohem disa herë natën për shkak të vajzës. Disi nuk më pengonte fare kjo gjë. Le ta thyejë qafen ku të dojë vetëm mua të më lërë rehat. Hyra brenda dhe mezi prisja ta merrja vajzën dhe të shkoja në dhomën time. Nuk kaluan as pesë minuta, kur hynë brenda Halimi me vëllanë dhe prindërit e tij. Shihej mirë se sa i dehur që ishte. Mezi rrinte në këmbë derisa e mbanin për krahu nëna dhe vëllai, ndërsa babai i tij i bërtiste pa ndërprerë.

– O i pafe, po kujt i ngjave kështu me alkool e kurvëllëk. Nuk ke pasur kujt t'i ngjash tjetër veçse atij dajës tënd pijanec. Askush me zor nuk të ka shti me u martue dhe me e marrë në qaf këtë qyqe. Kjo për ty është këtu e jo për ne. Mos u tutsh prej saj, tutu pak prej Zotit. Nuk ke lënë gjë pa bërë derisa e ke pru në shtëpi Trëndafilën.

O i paiman, qysh nuk po të vjen gjynah të paktën për evlatin tënd. Pse e ke bërë atë kur nuk je në gjendje të kujdesesh për të.

Nuk la gjë pa i thënë. Unë nuk flisja fare por më vinte mirë që së paku dikush e kishte kuptuar drejt situatën. Halimi doli nga dhoma për t'i larë dhëmbët që të mos i vinte era shumë. Mbasi i pastroi dhëmbët, m'u afrua.

– Pse nuk po flet ti. Ti u ke thënë atyre që të më sjellin në shtëpi. A po mendon se duhet të të ruaj ty gjithë kohën a? Unë dua të kënaqem dhe kurrë më mos provo ta bësh një gjë të tillë. Kë po mundohesh me e shti në gjynah? Ty nuk po të donë prindërit e tu e lëre më dikush tjetër. Mos u mundo të më kontrollosh kurrë më dhe mos spiuno se unë nuk jam qyqar me luajt gruaja si të dojë me mua. Sapo e hapa gojën t'i thosha se unë nuk kisha kurrfarë lidhje me këtë punë, më goditi me shpullë dhe më tha mbylle gojën lavire, të mos ta ndiej zërin, duke m'i sharë motrat dhe nënën.

– Sapo të rritet Merita pak, e të mos ketë nevojë për gjirin tënd, shko kah të duash vetëm mos të t'i shoh sytë këtu se mjaft kam bërë qejf me ty.

Gati sa nuk plasa nga mllefi. Sa më shumë ditë që po kalonin, aq më mirë e kuptoja se çfarë njëri ishte Halimi. Ky nuk ishte dyfytyrësh por shumëfytyrësh. Ma bëri mirë të qartë se do të vijë dita kur do të më qiste në rrugë ky i poshtër. Nuk do të më prishej qejfi aspak që mos ta shihja më, por nuk doja të më ndante nga ylli i jetës sime dhe nuk kishim ku të shkonim ne të dyja. Kësaj po i thënkam “hip se të vrava, zbrit se të vrava”. Do të duroj sa të mundem, por nuk do të lejoj të më ndajë për së gjalli dikush prej saj. Qaja vazhdimisht duke u përpjekur të gjeja zgjidhje për problemin tim. Nuk do të lejoja që të më ndanin për së gjalli nga vajza ime.

Hyra në dhomë ku ishin të gjithë ulur. Halimi hyri para meje dhe u ul e rrinte si një melaqe, sikur të mos kishte folur asgjë para pak minutash. Të gjithë e shikonin televizorin ndërsa unë e mora vajzën dhe u ula me një qosh të dhomës për ta lidhur e bërë gati për gjumë. I dhashë gji derisa u ngop mirë. Lotët nuk më ndaleshin. Më dhembte

zemra derisa i mendoja ato fjalë të ndyra që m'i tha Halimi, por më së shumti kur mendoja që po don të më ndajë nga shpirti im i vogël. Derisa ia lëmoja flokët Meritës, gjithkrah më shkante mëndja. Mbas asaj nate nuk mund ta paramendoja që ta lejoja që të më prekte ky fëlliqan...

Pasi i mbylli sytë dhe fjeti loçka ime e vogël, atëherë nisa t'i pëshpëritja asaj qetë: nuk do të lejoj që të më ndajnë për së gjalli nga ti zemërushja im e bukur. Të lutem më fal por unë nuk kam tjetër rrugëdalje, dhe më mirë është që kurrë të mos e kuptosh se sa kam vuajtur për ty dhe sa e pafat kam qenë. E putha në të dy faqet, ia putha sytë hundën, ballin dhe buzët. E përkëdhela në fytyrë dhe e vura në djep. Dola nga dhoma pa e folur asnjë fjalë. Ata me siguri mendonin se do ta ndreqja së pari shtratin e pastaj do të vija ta merrja vajzën. U ngjita shkallëve përpjetë me zemër të thyer, hyra në dhomë, mora fotografinë e Meritës në dorë dhe i premtova se gjithmonë do ta dua gjallë apo vdekur. Hyra në banjo mora shishen me varikin dhe vendosa që ta pija derisa të më mbyste njëherë e përgjithmonë. E dija se në këtë mënyrë e kanë mbytur veten disa vajza. Varikini është i fortë dhe t'i copëton të gjitha organet e brendshme. Ia hoqa shishet kapakun dhe fillova ta pi, derisa e pija me kujtoheshin të gjitha që m'i kishte bërë Halimi deri më sot. Pija dhe qaja. E vetmja gjë që më dhimbsej ishte Merita. Le të çlirohen të tjerët. Edhe prindërit e mi. As te varri të mos më vijnë... I vinte një erë shumë e rëndë por unë pija sa mundesha. Mëndja filloi të më turbullohej, sytë nisën të më mbylleshin, ndërsa duart dhe këmbët nuk kishin më fuqi. Dola nga banjoja me atë pak fuqi që më kishte mbetur duke u mbajtur për mur gjersa arrita te dollapi ku ishin rrobat e Meritës. I mora disa ashtu siç ishin të palosura dhe e vendosa kokën mbi to si mbi jastëk, mbylla sytë dhe m'u errësua gjithçka... Por, në këtë botë të mallkuar, as nuk të lënë të jetosh, as të vdesësh. Dy veta më mbanin për krahu, ndërsa një ma hapte gojën dhe më jepte të pi diçka me zor derisa nuk më plasi tugu për hunde e për goje...

– Si e ke emrin? Hapi sytë e mos fle. Mos e shtrëngo gojën,

duhet ta pish këtë ujë që po ta japim ne se të pastron.

Prapë villja sa mundesha dhe i dëgjoja fjalët tek thoshin se po i vjen një erë shumë e rëndë. Vazhdonin të zbraznin me litra ujë në fytin tim. Nuk e di sa ka zgjatur kjo, sytë i kisha ende të mbyllur por dëgjoja vetëm zëra të ndryshëm. E dalloja zërin e motrës së Halimit që ishte ulur afër meje. Disa gra interesoheshin ta dinin se çfarë kishte ndodhur me mua. Oh sa e re, oh sa gjynah.

Mbas dy ditësh më lëshuan nga spitali. Halimi kishte ardhur të na merrte me veturë. Nuk mund ta shihja me sy. Nuk folëm asnjëri asnjë fjalë gjatë tërë rrugës për në shtëpi. Mbasi që e parkoi veturën Halimi, më tha a po të duket mirë se çka ke bërë? Unë nuk i dhashë kurrfarë përgjigje. Hymë brenda në shtëpi. Nuk fliste askush, vetëm më shikonin sikur të kisha ardhur nga ndonjë planet tjetër. As unë nuk u thashë gjë, vetëm mora vajzën time dhe shkova në dhomë e cila ishte ashtu siç e kisha lënë. Më mirë ishte sikur të mos isha zgjuar më. Ata brengoseshin më shumë se si do t'u arsyetoheshin njerëzve të cilët e kanë kuptuar se çfarë ka ndodhur. Prapë u burgosa në dhomë për disa ditë derisa të forcohesha pak. Të vetmit ishin Halimi dhe motra e vet të cilët ma merrnin dhe ma sillnin vajzën dhe më sillnin për të ngrënë. Merita më dhimbsej në shpirt por nuk guxoja t'i jepja me thith për disa ditë pasi që ma ndaloi mjeku. Së pari duhet t'i zbrazja gjinjtë nëpërmjet një pompe speciale derisa të pastroheshin që të mos e helmoja vajzën. Dy ditët e para nuk guxoja as ta puthja në fytyrë sepse më dilte erë e fortë nga goja. Vjehrra nuk ma hapi derën që të më shihte apo të bisedonte me mua, por atë ditë që shkova poshtë, nisi të më fajësonte për sjelljen dhe veprën time që e kisha bërë. Donte të më hante për së gjalli. Nuk kishte ndryshuar asgjë, gjendesha prapë aty ku nuk dëshiroja të isha.

X

Dy muaj më vonë pëshpëritej diçka nëpër shtëpi, por mua nuk më informonte askush për asgjë. Flisnin mbrapa shpinës sime dhe këtë herë isha e sigurt se nuk kishte të bënte me mua. Nuk kaluan as dhjetë ditë e Halimi shkoi në Kroaci. Nuk e dija për çfarë arsye po shkonte. Thellë në brendi dëshiroja që t'i ndodhte ndonjë aksident rrugës, apo të shkonte në ndonjë vend ku nuk do të kthehej më në shtëpi, por dëshira ime as këtë radhë nuk u plotësua. Halimi u kthye në shtëpi pas pak ditësh dhe e mbylli edhe shitoren e këpucëve. Menjëherë të nesërmen më tha që të bëhesha gati se duhet të shkonim për të bërë fotografi për pasaportë. Rrugës duke shkuar për te fotografi, nuk mund të duroja pa e pyetur se çfarë po ndodhte.

– Më ka ardhur ftesa që të shkoj ushtar, por unë nuk dua t'i shërbej asaj ushtrie. Unë para katër vitesh isha disa muaj por nuk mund të rrija sepse kisha frikë të bëja roje natën gjersa të tjerët po flinin. U paraqita si i sëmurë, por dështoi ky plan që të më lirojnë nga ushtria. Dikur u njoftova me një shok nga Novi Pazari që ishte boshnjak dhe ai më tregoi se planifikonte të paraqitej sikur nuk ishte normal. Kjo ide nisi të më pëlqej edhe mua. Fillova të nesërmen menjëherë t'i ndryshoja sjelljet. Nuk zgjohesha në mëngjes, i vishja rrobat mbrapshtë, folja vetë me vete dhe bëhesha sikur kisha halucinacione. Këndoja kur të tjerët mbanin qetësi, shtrihesha në shtretër të huaj... Mbasi që nuk përmirësohesha dhe as mjeku nuk kishte se çfarë të bënte me mua, u realizua plani im dhe më liruan nga ushtria duke më shpallur të paaftë. E tani më ka ardhur thirrja papë dhe nuk dua të shkoj sepse ka filluar lufta në Bosnjë dhe shkijet duan të na çojnë atje që të vrasim gra pleq dhe fëmijë muslimanë.

Nga rrëfimi i tij e vëreja se Halimi ishte mashkull frikacak. Ky, trimëri tregonte vetëm ndaj meje që isha e pafuqishme. Por njëherësh edhe u trishtova kur dëgjova se në Bosnjë kishte filluar lufta sepse më dhimbeshin të pafajshmit.

– Trëndafille, unë dhe familja ime kemi vendosur që të shkojmë

diku në perëndim. Ende nuk e di se ku duhet të shkojmë, por së pari duhet të ta ndreqin ty një pasaportë, sepse pa të nuk mund ta qesim hapin, ndërsa Meritën e qes me pasaportën time. Në rastin tënd, pasi që ti nuk i ke mbushur ende tetëmbëdhjetë vjet, nevojitet nënshkrimi i prindërve të tu, por si ta marrim atë nënshkrim? Po të ishin në Kosovë, unë do t'iu lutesha që ta nënshkruajnë mirëpo nuk e di a do të pranonte babai yt. Më duhet gjithsesi ta gjej dikë të njohur, qoftë nevoja edhe t'i jap para që ta kryejë punën sa më shpejt sepse kemi vetëm edhe dy muaj kohë. Babai më ka thënë se nuk do të më lejojë kurrsesi të shkoj pa ty dhe Meritën.

I bëmë fotot dhe u kthyem në shtëpi. Ashtu në heshtje gëzohesha që do të largohesha nga ky vend dhe këta njerëz dhe uroja që kjo punë të bëhej sa më shpejt. Halimi e kishte rregulluar punën e pasaportës me njoftësi dhe shkuam që të dy në Prizren, ndërsa Meritën e lamë në shtëpi.

– Trëndafile, ti mos fol asgjë, nëse duhet diçka, unë do të jam aty.

Çka të flisja unë kur nuk dija asgjë. Zyra ku duhej të paraqiteshim ishte në katin e parë.

– Ju jeni Trëndafilja?

– Po, u përgjigja.

Nëna e Trëndafiles është shumë e sëmurë dhe gjendet në spital. Ne për këtë arsye duam të shkojmë në Zvicër ta vizitojmë, të paktën ta shohë edhe një herë sa është e gjallë, shtoi Halimi (hajde rrenë hajde...). Nënshkrova aty ku më thanë dhe ma dhanë pasaportën duke më uruar rrugë të mbarë.

– Do të kujdesem që ta gjej ndonjë lidhje që të shkojmë sa më shpejt.

– Sa për mua nisemi menjëherë sot, – i thashë.

Mbas dy dite më tha Halimi që t'i përgatisnim disa gjëra më kryesore sepse të shtunën do të niseshim. Nisja do të bëhet pasi të terrohet që të mos e kuptojë qyteti që po largohemi. Përgatita disa gjëra, por më së shumti për Meritën. Për vete mora vetëm pak rroba.

Vjehërrve ua dorëzova tërë stolitë e arit dhe argjendit. Kishin ardhur të gjithë për të na përcjellë. Nëna e Halimit qante duke i përmendur herë Halimin e herë Meritën. Nuk më vinte keq aspak për këtë plakushe. Inshallah nuk më kthen kurrë më Zoti në këtë shtëpi. Për herë të parë, prej se jam martuar, sot mbatha këpucë të rrafshëta dhe vешa prapë xhinse të cilat m' i kishte blerë motra e Halimit. O sa mirë ndihesha me to. Të gjithë qanin dhe na merrnin me radhë ngrykë. Qaja edhe unë, por qaja nga gëzimi që po largohesha nga ai vend i mallkuar. Nuk qaja pse po ndahesha nga ata njerëz edhe pse babën dhe motrën e Halimit i doja në një farë mënyre sepse ishin të vetmit që ishin kujdesur për mua, por qaja që kurrë nuk përjetova të më presë apo përcjellë dikush nga familja ime.

Hipëm në veturën e një shoku të Halimit i cili na çoi deri në aeroportin e Sofjes në Bullgari, e prej aty fluturuam për në Çeki. Kur arritëm në Çeki, Halimi na vendosi në një banesë të vogël që kishte vetëm një dhomë dhe banjë. Ai e njihte mirë këtë vend sepse kush e di sa herë kishte kaluar kohën me prostituta që gjendeshin në çdo qosh. Mua dhe Meritës na sillte për të ngrënë bukë, djathë e suxhuk, për të cilin nuk e dija nëse ishte nga mishi i dërrit apo jo. Ndenjëm aty disa ditë, të mbyllura në një dhomë, ndërsa Halimi disa herë gjatë ditës shkonte në qytet. Një mbrëmje erdhi dhe më tha që shpejt t' i përgatisja plaçkat sepse brenda dy orësh do të vazhdonim rrugën në drejtim të Suedisë. I bëra gati të gjitha, e lava Meritën dhe u nisëm. Ecja mbas Halimit me Meritën ngrykë si e trullorur, pa e ditur se ku po shkonim. Disa minuta ecëm në këmbë, por Halimi që nuk ishte mësuar të prekte punë me dorë, vendosi që të paguajë një taksë deri në stacionin e trenit, vetëm që të mos i bartte ato çanta, të cilat nuk kishin kushedi sa të renda. Për herë të parë kisha fluturuar me aeroplan, për herë të parë po udhëtoja edhe me tren. Më pëlqente edhe pse nuk e dija se ku po më çonte. Udhëtuam tërë ditën derisa dielli ia lëshoi vendin muzgut. Këmbët më ishin mpirë duke mos lëvizur fare. Dikur ka mesnata, e pyeta Halimin se edhe sa kohë na duhej të udhëtonim. Më tha se brenda një ore do të zbritnim nga

treni dhe do të hipnim në anije dhe më premtoi se do të kujdeset për ta gjetur një kabinë për fjetje. U befasova kur e pashë se i tërë treni kishte hyrë në anije. Aty nuk ishte vetëm treni por kishte dhe autobusë e shumë vetura. Halimi për herë të parë e mbajti premtimin, e gjeti një kabinë për fjetje e cila, ndonëse ishte mjaft e ngushtë, të ofronte njëfarë rehatie për trupin. Të nesërmen në mëngjes dolëm për të ecur nëpër anije dhe u befasova kur pashë se në anije kishte ashensor. Kjo nuk i ngjante një anijeje, por një qyteti të tërë. Ishte shumë e bukur, shumë e pastër dhe kishte shumë rregull. Aty brenda kishte edhe dyqane dhe rroba shumë të bukura, kishte restorante të cilat vetëm i kisha parë në televizor. Kishte edhe kënde të posaçme për fëmijë me shume lojëra. Në njërën anë të anijes gjendej një pishinë shumë e madhe, ndërsa në anën tjetër gjendeshin karrige dhe shtretër ku mund të shtriheshë dhe shihje vetëm qiellin mbi ty dhe detin para teje. O Zot i madh, kjo më ngjante në një parajsë. Hymë në një restorant për të ngrënë diçka sepse kishim shumë uri. Halimi porositi diçka edhe për mua. Ky ushqim kishte shije krejt ndryshe nga ai që isha mësuar të haja. Nuk isha mësuar të haja me lugë e pirun... E kaluam gati tërë ditën duke shikuar gjëra që nuk i kishim parë kurrë më parë. Filloi prapë të më kthehej shpresa dhe vullneti për jetë. Gëzohesha kur paramendoja të jetoja në një vend të tillë. Nëse do të paraqitej nevoja, do të jetoja edhe në çadër, vetëm e vetëm të mos zgjohesha në mëngjes shumë e lodhur dhe t'i bëja punët e shtëpisë e t'u bëja hyzmet të tjerëve, të mos i dëgjoja më thashethemet të cilat më pengonin shumë. Po të ishte nevoja, do të haja e do të pija më pak vetëm e vetëm të mos kthehesha në atë vend që m'i përkujtonte vuajtjet, fyerjet dhe poshtërimin ndaj meje. Nuk dua më kurrë të jetoj në atë qytet ku nuk m'u plotësua asnjë dëshirë, në atë qytet ku më ndanë nga të gjithë ata që i doja. Më ndan nga shkolla, nga dashuria ime e parë – Shkëlqimi. Më ndan nga shoqëria dhe në fund edhe nga gjiri familjar. Kur më kujtohen të gjitha këto, jam e sigurt se nuk dua të kthehem kurrë më në Kosovë. Nga këto mendime më zgjoi Halimi i cili tha se duhet të kthehem

prapë në tren ngase gati arritëm në Suedi. Kur hymë në këtë shtet, na i kërkuan pasaportat. Halimi ua tregoi dhe filloi një bisedë ndërmjet tij dhe policëve suedeze. Përveç fjalës azil të cilën Halimi e përmendte shpesh, nuk kuptoja asgjë tjetër. Na zbritën në stacionin e parë të trenit dhe na çuan në një vend ku kishte njerëz që u takonin kombësive të ndryshme. Policët i folën diçka një portieri i cili na e hapi një derë të madhe prej hekuri dhe hymë brenda. Na futën nëpër disa korridore dhe na urdhëruan që të prisnim para një dërrë derisa erdhi polici me një përkthyes që fliste shqip. Filluan të na parashtronin pyetje të cilave u përgjigjej vetëm Halimi. Unë mbaja në dorë Meritën e cila fatmirësisht nuk qante por vetëm shikonte andej e këndeje. Pas një orë na thanë që të presim prapë në korridor. Gjatë pritjes Meritës i dhashë gji dhe ia ndërrova pelenat, disa prej të cilave i gjuajta në shportë sepse nuk kisha ku t'i laja. Përkthyesja na urdhëroi që të hynim prapë brenda në zyrë dhe pasi u ulëm në vendet ku ishim më parë, një grua suedeze nëpërmjet përkthyeses na njoftoi se duhet të largoheshim nga Suedia dhe në pasaportë na kishin vendosur vula që na ndalonin hyrjen në këtë shtet për dy vjet. Ata u arsyetuan duke thënë se në Kosovë nuk është luftë dhe se Halimi nuk është i ndjekur politikisht. Nuk na lanë më asnjë minutë aty dhe me veturë të policisë na kthyen deri në stacionin e trenit, ku na hipën në tren dhe pritën derisa treni u nis. U mërzita shumë, isha e uritur dhe shumë e lodhur, e nuk kisha qumësht të mjaftueshëm në gji për Meritën. Edhe Halimit iu prish qejfi. Ishte i detyruar të gjente tjetër zgjidhje sepse nuk donte të kthehej në Kosovë, ngase e dinte mirë se çfarë e priste. Më tha se do të shkojmë në Gjermani dhe më tregoi se i ka një dy shokë në Wurzburg.

– Ata punojnë të dy në një restorant, e kam edhe adresën e tyre me vete, e pastaj shohim e bëjmë më tutje, – më tha Halimi.

U kthyem nëpër të njëjtën rrugë që kishim bërë deri aty. Nuk e kam vërejtur fare se kur kemi hyrë në Gjermani, por sapo zbritëm nga treni, Halimi thirri një taksì të cilit ia tregoi adresën e shokëve të vet. Taksì na çoi deri para derës. Shokët e Halimit na përshëndetën

dhe u treguan shumë mikpritës edhe pse e panë se nuk do të kenë kohë për ne pasi që kishin shumë punë. Na çuan në dhomën e tyre që të pushonim dhe të pastroheshim. U gëzova që e gjetëm një vend për të pushuar, ndonëse kisha uri të madhe e cila m'u shtua edhe më shumë nga erërat e gjellëve dhe picave që përgatiteshin poshtë në kuzhinën e restorantit. Derisa e pastrova vajzën, picat ishin bërë gati edhe pse nuk i kishim porositur. Ishin shumë të shijshme. Hëngra derisa u ngopa mirë e mirë, sa që filloi të më dhembte edhe barku i cili kohë e fundit nuk ishte mësuar të hante aq shumë. Pasi hëngrëm Halimi shkoi poshtë ndërsa unë hyra u pastrova në banjë dhe u shtriva bashkë me Meritën në shtratin të cilit i vinte era parfum mashkulli por jo të pakëndshëm. Nuk e di sa kohë kishim fjetur kur u kthye Halimi prapë në dhomë. Ai fliste diçka, por unë nuk e kuptoja se isha përgjumshëm. Kur më tha se nuk mund të rrinim asnjë natë, m'u kthjellën sytë menjëherë. Më tregoi se shokët e vet e kishin këshilluar se si duhet të veprojë. Duhet t'i linim pasaportat aty dhe të shkonim të lajmëroheshim në polici pa pasaporta. Hipëm në një taksi i cili na dërgoi drejt e në polici. Në hyrje të stacionit policor, takuam dy policë të cilët ndonëse nuk na pyetën asgjë, Halimi filloi t'u drejtohej me fjalët azil azil, njëjtë sikur në Suedi. Na futën menjëherë brenda, na pyetnin diçka, por ne nuk e kuptonim asnjë fjalë përveç fjalës pasaportë. Ne bënim sikur nuk kuptonim. Më pas na hipën me një kombibus dhe na dërguan në një vend që quhej Zirndorf, të cilin më vonë e kuptuam se ishte vetëm për azilantë. Aty na e sollën një përkthyes të gjuhës shqipe i cili m'u duk mjaft antipatik dhe mendjemadh. Unë vetëm heshtja, ndërsa të gjitha bisedat ata i bënë me Halimin. Pasi u krye kjo procedurë, na dërguan dhe na treguan cila ishte dhoma jonë. Na treguan ku gjendej kuzhina dhe banja të cilat ishin të përbashkëta për tërë banorët e këtij kati. Në dhomë gjendej një dollap për rroba, dy krevate metalike me nga një sfungjer të hollë, një frigorifer dhe një larëse e duarve për t'i larë duart dhe sytë. Kurrë më parë nuk kisha jetuar në një dhomë kaq të vogël dhe të parregulluar, por isha e gatshme të jetoja edhe

kështu, vetëm e vetëm të mos i shihja disa njerëz më. Më mjaftonte të kisha vetëm bukë, ujë dhe rehati me engjëllushen time të vogël. Halimit nuk i pëlqente aspak këtu sepse ishte mësuar të jetonte në mënyrë luksoze pa e lodhur asnjëherë trupin dhe trurin. Këtu u detyruam të rrinim më shumë se dy muaj derisa të na transferonin në ndonjë vend tjetër të Gjermanisë ku kishte kushte më të volitshme. Kjo vlente për të gjithë azilantët. Ne na transferuan në një fshat të vogël afër qytetit Azbach. Na vendosën në një shtëpi të re ku banonin vetëm dhjetë familje azilantësh dhe shumica ishin shqiptarë nga Kosova. Këtu kishim një dhomë më të madhe dhe të pastër. Na dhanë menjëherë jorganë dhe jastëkë të rinj, na dhanë një shtrat të vogël druri për Meritën dhe dy herë në javë na shpërndanin pakot e ushqimit. Kuzhinën dhe banjën e përdornim së bashku me dy familje boshnjake, të cilat banonin në të njëjtën hyrje. Edhe ata e kishin nga një vajzë të vogël, por Merita ishte më e vogla. Ata na pritën për zemërsisht dhe na ndihmuan që të akomodoheshim. Sa më shumë që kalonte koha, aq më mirë ndihesha. Këtu më pëlqente shumë dhe ndihesha e lirë me engjëllushen time. Më pëlqenin edhe rrobat që vishja dhe filloi të më pëlqente prapë vetja ashtu si dikur kur isha në bankat e shkollës. Edhe Meritës i pëlqente shumë ky vend. Me bukurinë e saj tërhiqte vëmendjen e të tjerëve. Nganjëherë nuk e dija se cilën prej ne të dyjave po na shikonin më shumë, atë që ishte shumë e bukur apo mua që isha shumë e re për të pasur fëmijë. Por edhe Halimit filloi t'i pëlqente jeta këtu. U shoqërua me të gjithë banorët e ndërtesës, por edhe me gjermanë. Sa më mirë që ndihesha, aq më shumë kisha frikë se mos isha në ndonjë ëndërr. Filloja të shtoja kilogram, gjinjtë m'u bënë më të mëdhenj dhe më të plotë, gjë që për Meritën ishte e mirëseardhur sepse për një kohë të shkurtër iu bënë faqet e kuqe si mollë. Por, për fat të keq, kjo nuk zgjati shumë.

XI

Halimi filloi të xhelozonte pa masë, edhe pse nuk kishte fare arsye. I telefononte çdo ditë nënës së vet nga telefoni që na e patën vendosur në hyrje të banesës. Kisha filluar tashmë të mësohesha me këtë lloj jete, por më pengonte nëna e Halimit e cila telefononte shumë shpesh. Ajo thoshte se po mërzhitet shumë për Meritën dhe dëshironte që ta shihte atë. Një ditë ma mbushi mendjen Halimi që të kthehesha e të rrija nja dy-tri javë për shkak të nënës e cila po mërzhitej shumë për Meritën dhe pastaj do të vinte edhe ai të rrinte nja një javë dhe të ktheheshim së bashku. Më premtoi se do të kujdeset për të gjitha. Për të shkuar në Kosovë nuk ishte problem sepse ne i kishim pasaportat që i kishim fshehur, por problemi ishte që të kthehemi prapë në Gjermani, sepse e kanë bërë me viza. Por Halimi tha se e kishte gjetur një shok i cili do të na priste në kufi të Çekisë. Nuk e di pse, por pranova. Halimi ma bleu biletën e autobusit dhe duhej të nisesha pas katër ditësh.

Ishte dimër, nuk kishte shumë borë, por bënte shumë ftohtë. Autobusi ishte përplot me udhëtarë dhe mua më duhej ta mbaja Meritën në prehër deri në Kosovë. U rraskapita nga rruga, duart më nuk i ndija si duhet. Çdo katër apo pesë orë autobusi ndalej që të shpiheshin pak udhëtarët. Kësaj i gëzoheshin më shumë duhanxhinjtë pasi që ishte e ndaluar pirja e duhanit në autobus. Habitem me vetveten se si arrita që gjatë gjithë asaj kohe të qëndroja në autobus pa ngrënë, pa pirë dhe pa dalë për nevojë. Arritëm vonë në stacionin e autobusëve në Prishtinë ku kishin dalë të na prisnin babai dhe dhëndri i Halimit. M'u çliruan eshtrat kur u ula në veturë. Sapo mbërritëm në shtëpi, ku kishte plot mysafirë si gjithherë, na pritën e na përshëndetën mua e Meritën. Pushuam pak dhe mbas tri dite hëngra bukë me shije derisa u ngiva. E mora vajzën dhe shkova u shtrina në dhomë. Isha aq e lodhur sa nuk më mbanin këmbët. Kur u zgjova në mëngjes e pushuar dhe me mendje të kthjellët, e kuptova se isha treguar mendjelehtë që kisha ardhur këtu. Në këtë

shtëpi nuk kishte ndryshuar asgjë. Nga unë përsëri kërkoheshin të njëjtat punë, por fati im që Merita nuk e njihte askënd dhe sapo nuk më shihte mua, niste e qante. Çdo ditë që kalonte, më shtoej më shumë urrejtja për vetveten për gabimin që kisha bërë. Prisja me padurim që të vinte Halimi e të ktheheshim prapë në Gjermani. Nuk kishte këtu asnjë njeri të vetëm që interesohej për mua. Për çudi shumë herë mendoja për shkollën dhe për Shkëlqimin. Më ka marrë malli shumë për të edhe pse kam frikë ta shoh pas shumë kohësh. Nganjëherë më paraqitet në ëndërr. Në ëndërr edhe jemi puthur për herë të parë! Por nganjëherë, sa dua t'i afrohem, ai po zhduket. Ëndrra mbetet ëndërr. Nuk ia fal vetes këtë gabim por kisha shpresë se do të më ndihmonte Zoti dhe të kthehesha edhe një herë atje ku isha e nuk do ta përsërisja këtë gabim.

Mbas dy jave erdhi Halimi. U gëzova shumë, jo për atë por për ditën që do të ktheheshim prapë. Halimi nisi me avazin e vjetër. Dilte nga shtëpia dhe krenohej para shokëve me mendjemadhësi. Natën e tretë erdhi vonë i dehur në shtëpi. E dëgjova por u shtira sikur po flija, por ky i poshtër u zhvesh e hyri në shtrat e filloi të më prekte. I thashë që jam e lodhur dhe dua të fle, dhe e luta me fjalë të buta që të më linte të qetë. Nuk e përfilli kërkesën time dhe u soll me mua në mënyrë të vrazhdë e pasi e qejfin e vet nisi të më ngacmonte me fjalë. Unë edhe pse e urreja shumë, nuk doja të ngatërrohesha me të. Iu luta me fjalë të buta që të mos fliste me zë të lartë sepse do ta zgjonte Meritën nga gjumi. Sapo u ktheva nga banja, e vështa me shpresën se do të pushoja pak, ai papritmas filloi të më godiste nëpër fytyrë si katil derisa ma theu një dhemb dhe ma shqeu buzën. Gjaku nuk më ndalej. Pasi u zbraz në të gjitha mënyrat, u shtri dhe fjeti si të mos kishte ndodhur asgjë. Shkova prapë në banjë për ta pastruar gjakun. I ndërrova rrobat dhe ashtu e përlotur e përqafova engjëllushën time. Iu luta Zotit që të mos e përjetoja këtë që po e përjetoja unë. Sapo zbardhi drita, u zgjova ndonëse edhe ashtu nuk kisha futur gjumë në sy. U trishtova kur e pashë veten në pasqyrë. Më ishte nxirë pjesa e djathtë e fytyrës. Në fillim ngurova të dilja

nga dhoma sepse më vinte turp të më shihte dikush në këtë gjendje, por ndërrova mendje. Le të më shohë kush të dojë, le ta dinë të gjithë se me çfarë njëri po jetoja. Shkova poshtë e ndeza zjarrin, i përgatita xhezvet për kafe dhe i hapa rrugët nëpër oborr të cilat ishin mbuluar nga bora e u qita hi që të mos rrëshqiste dikush. Në fillim nuk më pyeti askush por më vonë babai i Halimit u interesua se çka më kishte ndodhur. Ia thashë të vërtetën. I thashë se nuk i kisha bërë e as thënë gjë. I tregova që ka ardhur natën vonë i dehur dhe më ka rrahur. Buza epërme më ishte ënjtur aq shumë sa dukej se çdo çast do të plaste. Kur hapja gojën, dukej dhëmbi i syrit i thyer përgjysmë. Ngjaja sikur të isha kthyer nga lufta. Ndenjëm edhe tri ditë të tjera dhe të gjithë më panë ashtu të rrahur, por këtë radhë kisha vendosur që të mos i fshihja veprimet e Halimit. Erdhi dita që të niseshim prapë, e unë isha ende me plot shenja në fytyrë dhe dhëmb të thyer në gojë. Nuk më pritej që të dilja përgjithmonë nga kjo shtëpi ku isha betuar se nuk do të kthehesha më as e gjallë, e as e vdekur. U përshëndeta me të gjithë me radhë siç e do rendi, por këtë herë nuk më doli asnjë pikë loti, mbase për faktin që e dija se nuk do të kthehesha më kurrë. Dhëndri i Halimit na çoi deri në stacion të autobusëve në Prishtinë, prej nga udhëtuam me autobus deri në Çeki. Aty pritëm derisa u errësua që të mund të kalonim kufirin në këmbë ndërsa andej kufirit duhej të na priste një shok i Halimit.

Ishte shumë ftohtë për të pritur përjashta. Afër kufirit gjendeshin disa kafene që ishin të mbushura përplot me njerëz. Në fytyrat e tyre vërehej frika. U ulëm në një tavolinë. Halimi porositi ushqim dhe pije. Përballë nesh ishte i ulur një mashkull i cili shikonte shumë herë në drejtim timin. Pasi hëngrëm gjellën na erdhi edhe një desert që nuk e kishte porositur Halimi. Ai u çudit por nuk e pyeti kamerierin asgjë. Halimi nuk ishte as vetë i sigurt se çka kishte porositur. Kur erdhi koha për të paguar, erdhi prapë e njëjta kameriere por pa faturën e llogarisë dhe mundohej t'ia shpjegonte Halimit se të gjitha i kishte paguar zotëria që ishte në tavolinën përballë. Halimi ngriti kokën dhe e përshëndeti me dorë duke iu falënderuar atij, ndërsa

unë vetëm e drejtova shikimin nga ai por e ula kokën menjëherë që të mos më vërente Halimi. Isha e sigurt se ai e kishte bërë këtë për mua dhe Meritën. Edhe pse nuk e njihja, shikimet dhe shprehjet e tij më dhanë shpresë se nuk janë të gjithë njerëzit të pashpirt. Dikur Halimi më tha që po nisemi. Ai e mori çantën e vogël me rroba të Meritës, ndërsa mua ma la vajzën. Shkuam tek ai farë tipi që po na priste jashtë i cili kur na pa mua e Meritën, i tha Halimit se me fëmijë të vogël kalimi kushton 3 mijë marka. Halimi e kundërshtoi duke i thënë se nuk kishte nevojë të na çonte deri në banesë por vetëm deri në anën tjetër të kufirit, sepse ne e kishim dikë që do të na priste e tjera... Atij nuk iu mbush mendja. Mbasi që u larguam nga aty, Halimi më tha se do të provojmë ta kalojmë kufirin pa përcjellës. Kisha shumë frikë, por nuk kishim tjetër rrugëdalje. Isha e vendosur të mos ktheheshim më në Kosovë. Isha e gatshme që të ecja në këmbë kushedi sa vetëm që të arrija në Gjermani. Bora ishte deri në gjunjë dhe ishte e vështirë të kalohej. Ecja mbas Halimit me Meritën ngrykë. Bëra bismillah para se të nisemi dhe e luta Zotin që Merita të mos qante, që të mos na dëgjonte kush. Ecnim nga disa hapa dhe ndaleshim për t'u fshehur prapa lisave. Orientoheshim në bazë të dritave të kufirit të cilat nuk ishin më larg se 100 metra njëra nga tjetra. Nuk e ndieja më të ftohtit, përkundrazi më vinte nxehtë edhe pse nuk kisha dorëza dhe shishja e qumështit që e kisha përgatitur për Meritën më ishte ngrirë në xhep të xhaketës. Kur e pashë që ishte bërë akull, e gjuajta në borë pasi që nuk mund ta përdorja më. Halimi vetëm përsëriste fjalën edhe pak, edhe pak. Nuk e di se kë e motivonte më shumë me këto fjalë, mua apo vetveten. Dikur arritëm në anën tjetër të kufirit. Kur mbërritëm në asfalt m'u kujtua se disa herë madje nuk kisha marrë as frymë. Nëse askush tjetër nuk e meritonte të quhej engjëllushë, këtë e meriton vajza ime e cila e përballoi këtë rrugë plotë acar pa iu dëgjuar fare zëri. Halimi më tha të ecja prapa tij. Fshiheshim herë mbas një veture e herë mbas tjetrës, kur papritmas na kapën dy kufitarë. Na morën menjëherë me vete dhe na çuan në stacionin e policisë kufitare që ishte aty

afër. Na i kërkuan dokumentet, por Halimi prapë i kishte fshehur pasaportat ndër xhaketën e Meritës para se ta kalonim kufirin. Ua tregoi atyre vetëm letrat e njoftimit (ausweis-at) që na kishin dhënë në Gjermani. Pas kësaj, kufitaret disi u acaruan edhe më tepër derisa Halimi mendohej t'u thoshte atyre se kishin dalë t'i prisnin prindërit e tij që donin të vinin në vizitë për shkak të Meritës që nuk e kishin parë shumë kohë. Na i morën shënimet dhe na e tërhoqën vërejtjen që të mos largoheshim nga komuna ku jetonim, pa leje paraprake. Na thanë se për këtë do të duhej ta mbanin ndonjë dënim por për këtë gjë nuk vendosnin ata vetë. Pasi që na liruan, Halimi e lajmëroi atë shokun e tij që të vinte të na merrte. Pritëm së paku edhe dy-tri orë derisa erdhi ai. Isha e stërlodhur. Më dukej se duart nuk do të ma mbanin më vajzën. Isha mërdhirë, këpucët më ishin bërë qull nga bora. Nuk kisha kohë t'ia qaja hallin vetes por më dhimbsej Merita e ngratë që po hiqte pa kurrfarë faji. S'më pritej sa të arrija në banesë. Hymë në një restorant që ishte afër stacionit kufitar. Aty ishte, të paktën, më nxehtë. E ndërrova engjëllushen time dhe i porositëm asaj një gotë qumësht të nxehtë. Qau pak nga uria derisa i erdhi qumështi, ngase që prej se e ka mbushur një vit më nuk po i jap gjë. Mbasi u ngi me qumësht, Merita fjeti prapë, ndërsa Halimi hante e pinte sikur të ishim për herë të parë në liri. Kjo natë m'u duk si të ishte 100 vjet e gjatë. Sytë më mbylleshin, nuk dëshiroja asgjë më tepër në atë çast sesa të shtrihesha në një vend e të flija. Mbas tri orësh kur gati i kisha humbur shpresat, erdhi ai shoku i Halimit të na merrte. Sa shumë u gëzova kur arrita në banesë. U shtriva menjëherë në shtrat. Të nesërmen të gjithë interesoheshin se çfarë kishte ndodhur me mua. Nuk ishte hera e parë që më kishin parë në këtë hall, por nuk isha edhe e vetmja që vuaja në këtë mënyrë. Mbas disa ditësh u ndanë një çift boshnjak. Flitej se gruaja kishte shkuar në Frauen Haus (shtëpi të grave). Ia kisha lakmi, jo që janë ndarë, por që ka pasur guxim të veprojë kështu me dy fëmijë. Fati i saj ishte që e dinte gjuhën gjermane. Kjo më shtyri që edhe unë ta mësoja gjuhën.

XII

Prej se ishim kthyer nga Kosova, Merita rrinte disi e zbehur dhe nuk hante si përpara. Kjo zgjati disa javë dhe Merita nuk bëhej rehat ditë as natë, filloi të kishte temperaturë. Më dhembte shpirti kur e shihja në atë gjendje pa mundur t'i ndihmoja. E luta Halimin që ta çonte te mjeku dhe doja që edhe ai të hynte me mua brenda që ta kuptoja më mirë mjekun se çfarë po thoshte. Mjeku kur e pa vajzën në atë gjendje, urdhëroj që ta shtrinin në spital pa humbur kohë. Derisa e bënte gati udhëzimin, përpara derës priste ndihma e shpejtë. Nuk paska gjë më të rëndë sesa ta shohësh evlatin tënd të shtrirë dhe me sy të mbyllur. Nuk më mbeti tjetër vetëm që t'i lutesha Zotit që të na ndihmonte edhe këtë herë të djave.

Kur arritëm në spital, u mblodhën të gjithë mjekët dhe pa humbur kohë nisën që t'i jepnin gjak. Halimi u kthye në shtëpi ndërsa unë gjatë gjithë kohës rrija ulur pranë shtratit të saj duke ia lëmuar flokët. Sytë nuk më tereshin për asnjë minutë. Kisha frikë të madhe se do ta humbisja. Kjo nuk ishte frikë si të tjerat, kjo nuk ishte frikë si ajo që kisha nga babai apo si ajo që kisha kur mendoja se nuk kam mësuar mjaft apo nuk jam përgatitur mirë për hartim apo si frika se do të m'i zbulonte kush letrat e dashurisë të Shkëlqimit. Dikur vonë ma prunë edhe mua një shtrat që të pushoja për disa orë dhe më lutën që të haja diçka. Nuk e doja asnjërin as tjetrën, doja vetëm të rrija pranë vajzës sime, t'ia mbaja dorën dhe ta shihja kah merrte frymë. I gjithë personeli mjekësor kujdeseshin për ne. Gjendja e Meritës përmirësohej gradualisht, edhe pse nuk i kuptoja mjekët plotësisht se çka më shpjegonin përveç fjalës “sehir ghu” (shumë mirë). Kënaqësia e tyre iu vërehej nëpër fytyra. Halimi erdhi vetëm pas dy ditësh të na vizitonte dhe nuk i kishte rënë ndërmend të paktën të na kishte sjellë ndonjë lëng apo diçka tjetër për të ngrënë. Mjeku, sapo e pa, iu drejtua me kritika Halimit pse nuk kishte ardhur që dy ditë, duke ia kujtuar se Merita ishte edhe fëmijë i tij dhe ai si prind duhej të kujdesej jo vetëm për të, por edhe për mua. E kuptova

mirë mjekun kur i tha se njëren e kemi shëruar, ndërsa tjetra do të sëmuret pa ngrënë e pa fjetur nga derti për vajzën. Halimi nuk fliste asnjë fjalë por vetëm shikonte si i ngrirë. Pas katër ditësh, Meritës nisi t'i skuqej fytyra, të hajë rregullisht dhe dëshironte të shoqërohej me fëmijët tjerë. Një javë ndenjëm në spital dhe gjatë kësaj kohe Halim zeza ishte vetëm dy herë të na vizitonte. Nuk bujti asnjë natë me ne që të më zëvendësonte të paktën një herë. Nuk kisha as rroba për t'u ndërruar dhe kisha frikë se më vinte era, andaj shkoja për çdo ditë të lahesha kur flinte Merita. Kur u kthyem në shtëpi, e kishin kuptuar edhe shumë familje gjermane, të cilët më falnin rroba për mua dhe Meritën. Na vizituan, edhe pse nuk dija të komunikoj mirë me to, por kontakte të tilla ishin të mirëseardhura dhe të dobishme për mua, sepse secilën herë mësoja diçka nga to. Çdo ditë e më shumë integroheshin në rrethin e tyre. Më ftonin për festa ku takoheshin grupe të ndryshme të grave. Nganjëherë madje shkonim edhe në kishë të dielave. Ta them të drejtën kur kam shkuar për herë të parë në kishë, më ka ardhur shumë vështirë. Ato e dinin se jam myslimane dhe donin vetëm të më njoftonin me fenë dhe kulturën e tyre. Megjithatë, nuk ndiheshin mirë në kishë ku shihja shumë kryqe nëpër mure, apo kur shihja figurën e Krishtit të gozhduar dhe ata qirinjtë e mëdhenj dhe të trashë. Në fillim shkoja vetëm për respektin që kisha ndaj këtyre grave, por më vonë filloi të mos më pengonte kjo gjë duke menduar se edhe këta njerëz besonin në Zotin e madhërisëm, në të njëjtin Zot që edhe unë e besoj. Mua më ka mësuar Kurani që të gjithë ata njerëz që besojnë në Zot, janë të njëjtë, sepse vetëm një Zot ka. Atyre nuk iu pengonte që unë lutesha me dua dhe duar të shtrira dhe mbaja kokën lart derisa ato luteshin në mënyrën e tyre me duar të bashkuara dhe kokën e përkulur, dhe ato kryqëzoheshin në fund ndërsa unë e përshkoja fytyrën me shuplaka siç kisha mësuar në xhami. Jam shumë e bindur se nuk ka aspak lidhje se çfarë feje i takojmë, por rëndësi ka se a besojmë në Zot dhe a jemi të pastër në zemër. Realisht edhe brenda myslimanëve në mbarë botën ka dallime. Mos të shkoj më larg se

në Kosovë ku më kujtohet se në shumë raste nuk i kanë lënë të martohen vetëm pse kanë qenë hoxhallarë dhe dervishë. Ka dy lloje të dervishëve, njëra palë agjëron shtatë ditë, ndërsa tjetra dhjetë ditë. Në raste të shumta gjatë agjërimit të ramazanit, apo të matemit, që dallojnë shumë në mes vete sa i përket rregullave të ushqimit e deri te pastrimi i trupit dhe i rrobave. Gjatë ramazanit është e lejuar të hash gjithçka, ta pastrosh trupin dhe rrobat në mënyrë të rregullt si çdo herë, dhe për të martuarit është e lejuar edhe marrëdhënia seksuale. Ndërsa gjatë matemit nuk janë të lejuara shumë gjëra, që nga ndalesa e pirjes së ujit të pastër të cilit duhet t'ia qesim së paku një lugë kos për ta turbulluar, pastaj ndalimit të mishit, yndyrave, qumështit, vezëve dhe shumë gjëra tjera. Nuk është e lejuar muzika, larja e rrobave, pastrimi i trupit si dhe marrëdhënia seksuale. Ndërsa në anën tjetër, bajramet, syneti, martesat, shkuarja në Qabe, falja e namazeve, mbulimi i trupit, madje edhe larja, falja dhe varrimi i xhenazeve bëhet e njëjtë me të vetmin dallim se atyre që kanë ramazan, xhenazja iu falet në xhami, ndërsa atyre që kanë matem në teqe... Mendoj se është me rëndësi që njerëzit të lutën, pavarësisht se ku i bëjnë këto lutje, në xhami, teqe apo kishë.

Unë lutesha në mënyrën time aty ku gjendesha. Të gjithë e dinin që ne jetonin nga ndihmat sociale sikurse azilantët tjerë. Ata këtë e kuptonin dhe donin të më ndihmonin që të jetoja më mirë dhe të kisha një lloj pavarësie financiare. M'i gjetën nja dy vende për të pastruar. Në fillim nuk isha kushedi sa e gëzuar, sepse në të vërtetë nuk ishim të varur si njerëzit tjerë, ngase Halimit i dërgonin familja të holla rregullisht por ai nuk e di se nga i harxhonte dhe i ankohej familjes duke i gënjyer se nuk po na mjaftonin paratë që po na jepte shteti. Për të gënjyer nuk ia kalonte njeri atij! Vendosa që të shkoja të pastroja, me qellim që të kisha sadopak të holla për vete dhe Meritën. Jo vetëm që fitoja pak të holla në këtë mënyrë, por secilën herë i mësoja disa fjalë të reja. Shumë herë më paguanin më tepër sesa duhej. Ishin njerëz të vjetër, njëri çift pa fëmijë ndërsa tjetri kishte dy vajza të martuara që banonin diku larg dhe, ndonëse

i kishin të gjitha, prapëseprapë ndiheshin të vetmuar sikurse unë! Halimi ka nisur që edhe këtu me disa boshnjakë të shkojë rregullisht nëpër muzika dhe të kthehet secilën herë i dehur në shtëpi. Madje nganjëherë nuk po vjen fare nga dy ditë dhe po gënjen diçka, kurse unë as që po ia vë veshin. Tashmë ka filluar të m'i kërkoj edhe të hollat që po i fitoj duke pastruar. Disa herë më gënjeu duke më premtuar se do të m'i kthente, por e dija se ishte i njëjti Halim që m'i kishte shpenzuar të gjitha të hollat e tubuara kur isha bërë nuse dhe të hollat që ia kanë falur kur ka lindur Merita. Vendosa që të mos i jepja më të holla. Nuk kishin kaluar as dy javë që nga fillimi i muajit, e ai i kishte shpenzuar të gjitha. Ishte fundi i javës dhe Halimi dëshironte të shkoja gjithsesi në disko dhe më kërkoi prapë të holla. I thashë se i kam shpenzuar, u fjalosëm tërë pasditen dhe në mbrëmje më rrahu prapë. Më kapi për flokë dhe më përplaste kokën për dysheme. Merita filloi të qante, unë mundohesha ta qetësoja engjëllushen time dhe prapë më shkante mendja të bëja vetëvrasje. Megjithatë, më dhimbsej vajza. Si ta lija atë në duar të huaja. Jam e lodhur nga jeta, nuk kam më vullnet, nuk kam më shpresë, nuk kam më fuqi... As të nesërmen nuk folëm me Halimin, nuk mund t'ia shihja sytë edhe pse më pengonte duke më ngacmuar pandërprerë me fjalë. Më ofendoi ashtu siç dinte ai. Nisi përsëri të ma shante prejardhjen, të fliste fjalë të ndyra për familjen time. Ai kishte bërë plane se një ditë babai im do t'ia falte gabimet, do të pajtohet me ne dhe do të na merrte në Zvicër që t'i fitojmë letrat. Kur e pa që ky plan i ka dështuar, atëherë filloi të sillet me këto poshtërsi. Po çuditë sa i pakarakter e i pashpirt paska qenë Halimi. Më ndau nga shkolla, më ndau nga Shkëlqimi, shpërndau thashetheme të ndryshme që nuk kishin të bënin fare me të vërtetën. Më zhvirgjëroi me dhunë në veturë të huaj. Më shkëputi tërësisht nga familja, më rrihte disa herë, më dhunonte dhe më ofendonte me fjalë të ndyra. Isha unë fajtores, pse nuk kemi letra të rregullta në Zvicër por gjendemi në azil në Gjermani. Unë mundohesha t'i përpija këto të gjitha në heshtje, por atij nuk i ndalej goja. Nga inati pse nuk flisja fare me të, nisi të më

kërcënohej se do të më qiste në rrugë. Të gjitha i durova por në fund kur më tha se do të ta dhunoj edhe motrën e vogël sikur ty, atëherë eksplodova.

– Shko dhunoje motrën dhe nënën tënde mor i pafytyrë.

Humba kontrollin dhe fillova t’ia ktheja fjalët. E mori një rrip dhe nisi të më godiste nëpër tërë trupin, ndërsa Meritës i thoshte mos u friko se unë mamin vetëm po e dua, ne po bëjmë shaka, mami nuk po qan vetëm po qesh! Më rrahu derisa u lodh. Pas pak minutave filloi të më ënjtejt tërë trupi. Sapo desha të shkoja në kuzhinë për ta vënë Meritën në gjumë, si e porositur erdhi njëra nga gjermanet për vizitë. Nuk kisha si t’ia fshihja njollat e duarve dhe të fytyrës. U trishtua kur më pa në atë gjendje. Më pyeti se çka kishte ndodhur dhe ndonëse kisha vendosur të mos fshihja asgjë meqë ishte e huaj, i thashë se jam rrëzuar. Por ajo nuk më besoi dhe m’u lut që t’ia tregoja të vërtetën. Tha që e dinte se Halimi është duke më rrahur. Atëherë ia tregova të vërtetën. Halimi sapo e pa atë, u largua dika me shpresë se unë, si edhe herëve tjera, nuk do ta tregoja të vërtetën. Ajo gjermanja më shpjegoi se këtu në Gjermani ligjet janë tjera dhe se nuk duhet ta duroja Halimin të më rrihte, m’i shpjegoi shumë gjëra dhe më premtoi se do të më ndihmonte. I premtova asaj por edhe vetvetes. Mbas disa orësh u kthye Halimi prapë, filloi të më ngacmonte me fjalë duke më kërcënuar se nëse i tregoj dikujt, do të më mbyste. Nga rrahja më dhembte trupi, ndërsa nga këto fjalë më dhembte edhe shpirti. Më detyroi t’i përgatis darkë duke më thënë se do të më rrihte për çdo ditë derisa të më bëj për qejf të vet. Ia përgatita darkën por nuk u ula të haja me të. E ushqeva Meritën dhe e çova në gjumë. U ktheva që t’i laja disa enë në kuzhinë. Më thirri që të shkoja në dhomë dhe të haja darkë me të. I thashë të më linte të qetë se nuk kam uri. Deshi të më detyronte që të haja me zor. Nisi të më kërcënohej dhe mbante një thikë të madhe afër vetes në tavolinë. I hëngra me zor nja dy kafshatë, pastaj i largova të gjitha nga tavolina përveç thikës. Pasi i pastrova enët dhe i vendosa nëpër vende, shkova për të fjetur. E shtrova një sfungjer afër shtratit të

Meritës, ngase nuk doja të flija në një shtrat me Halimin.

– Çka je duke bërë aty? Mos më detyro të ta bëj më zi se më parë. Derisa unë të kthehem nga banja, ke kohë të kujtohesh se cilën po e zgjedh.

Ai doli nga dhoma dhe unë dola pas tij që të sigurohesha se a është në të vërtetë në banjë e cila gjendej në fund të korridorit. Mbylla ngadalë derën e dhomës dhe me shpejtësi vrapova te telefoni dhe e thirra policinë. Iu thashë se burri po më rrah dhe kam shumë frikë nga ai, po më kërcënohet edhe me thikë. Më pyetën për adresë dhe për emër, dhe më premtuan se do të vijnë sa më shpejt që është e mundur. Mbylla telefonin dhe bëhesha sikur po i palos rrobat. Sapo hyri Halimi në dhomë, më pyeti nëse kisha vendosur. I thashë së pari po shkoj në banjë e pastaj të tregoj. Mbylla derën e banjës me çelës. Trupi më dridhej si thupër dhe shikoja nga dritarja kur do të arrijë policia. Vendosa gjithsesi të pres aty derisa të vijnë policia dhe të jem e sigurt se nuk do të më ndodhte asgjë. Nuk vonoi shumë dhe u duk vetura e policisë nga e cila zbritën dy vetë dhe u drejtuan nga hyrja e banesës. U çlirova pak ndonëse trupi vazhdonte të më dridhej. Hapa derën ngadalë dhe dola përpara derisa policët kërkonin emrin. Iu thashë që unë i kisha thirrur. Iu tregova që burri më ka rrahur shumë. Më pyetën ku është dhe më thanë që të mos kisha frikë më se nuk do të guxojë të më prekte. Kur hyra në dhomë, Halimi i zgurdulloi sytë sikur të kishte parë ndonjë lugat. Ata nisën ta marrin në pyetje, ndërsa ky në prani të tyre përpiquej të më godiste. Pas shumë diskutimeve policët kërkuan që unë të vendosja. Nëse nuk dua të rri me të, ata do të më merrnin dhe do t'i bisedojmë të gjitha, ndërsa nëse dua të rri këtu, nuk mund të më garantonin se Halimi nuk do të më rrihte prapë. Vendosa që të shkoja me ta, sepse nuk mund të rrija në një dhomë e në një shtrat me këtë katil. Më thanë që t'i merrja me vete vetëm disa gjëra kryesore. Mora një çantë dhe kur nisa t'i merrja disa gjëra të Meritës, Halimi filloi të bërtiste se nuk do të më lejonte ta merrja vajzën. Nisi të shtyhet me policët, ndërsa njëri nga policët propozoi që ta lija sonte Meritën

këtu pasi që është vonë dhe do ta marrin të nesërmen. Sipas ligjit, vajza më takonte mua. Më erdhi shumë rëndë ta lë këtu dhe t'ia ktheja shpinën, por isha e vendosur se nuk do të kthehesha të jetoja kurrë më me Halimin. I mora disa rroba kryesore për vete. E hoqa unazën e fejesës dhe të martesës nga gishti dhe ia lashë në tavolinë Halimit që ta ketë të qartë se kanë marrë fund të gjitha. E putha Meritën ashtu në gjumë. I thashë se e dua shumë dhe së shpejti do të vij për ta marrë. Dola nga ajo banesë ku më ishte nxirë jeta dhe hyra në veturë të policisë. Këtë herë më mungonin edhe fjalët se si të lutesha. Atë natë më çuan në stacionin policor, më thanë që të zhvishem dhe ma fotografuan tërë trupin. U trishtova edhe vetë kur i pashë ato fotografi të cilat dëshmonin se sa më kishte rrahur Halimi. Nuk kishte mbetur pjesë e trupit pa u nxirë. I morën të gjitha shënimet pastaj më çuan në një shtëpi të grave (frauenhaus). Atë natë nuk munda të fusja gjumë në sy. Kur zbardhi drita, së pari më shkoi mendja te Merita që e kishte kohën për t'u zgjuar. Shkova në dhomën e ditës që ishte e madhe dhe me një kuzhinë në njërën anë. Secila prej grave që gjendeshin aty, kishte dhomë në vete, ndërsa kjo e ditës dhe kuzhina ishin të përbashkëta. M'i treguan të gjitha me radhë, më prezantuan para atyre grave që ishin aty. Ishin rreth dhjetë gra të cilat kishin probleme të ngjashme si unë. Një gjë kishim të përbashkët, brenda këtyre mureve ishim të sigurt. Në fillim më vinte turp për ato që më kishin ndodhur edhe pse e dija që nuk isha fajtorë. U çlirova kur i dëgjova rrëfimet e tyre. Tani e kisha të qartë se kisha gabuar që i kisha heshtur të gjitha. Gratë të cilat gjendeshin aty, i kishin me vete fëmijët e tyre ndërsa unë nuk e kisha vajzën time. Kur i dëgjoja fëmijët duke i thirrur nënat e tyre mami, më bëhej sikur po më therte dikush në zemër me thikë. Nuk hëngrta tërë ditën, vetëm qaja, nuk doja asgjë më shumë sesa ta kisha Meritën me vete. Të gjithëve iu ra në sy se sa shumë po vuaja për vajzën time. Më premtuan se shumë shpejt do të më bashkonin me engjëllushen time. Kaluan dy ditë që m'u dukën si dy vjet derisa erdhi çasti që herët në mëngjes të nisemi. U nisëm me dy policë

nga të cilët njëri ishte i shtetit dhe i specializuar për këto raste. Pak u çlirova kur e pashë këtë njëri sepse ishte nga i njëjti fshat dhe na njihje mirë ne. Më premtoi se do të më ndihmonte. Më tha që të mos kisha frikë sepse i kemi edhe dy policë tjerë me vete. Nuk ishte e domosdoshme të shkoja unë me ta, por ishte më mirë për Meritën që të mos frikohej nga njerëzit që nuk i kishte parë më herët. Prisja me padurim që ta përqafoja zemrën time të vogël për të cilën më kishte marrë malli aq shumë. Arritëm shumë herët kur të gjithë flinin. Ata, me qëllim, e kishin planifikuar kështu që të vinin papritur, mbasi që ditën ekzistonte rreziku që të mos e gjenim Halimin aty. Hapa derën e banesës me çelësat që i kisha me vete, dhe hymë brenda me gjithë policët. Para meje hyri ai që ishte më kryesori. Ua tregova dhomën ku ata trokitën dhe pas disa trokitjeve Halimi e hapi derën me sy të përgjumshëm. Kur na pa ne, u befasua aq shumë dhe deshi ta mbyllte derën, por policët e shtynë dhe u futën brenda. Merita ishte duke fjetur në shtratin e vet dhe derisa dy policët shtyheshin me fjalë me Halimin, ai kryesori më ndihmonte duke m’i përkujtuar gjërat që duhej t’i merrja për mua dhe Meritën.

– Merri ato që mundesh sepse çka mbetet këtu, do të mbetet përgjithmonë.

Me shpejtësi i mbusha me rroba disa qese të najlonit, i mora disa lojëra dhe disa fotografi të Meritës. Në fund e mora ngadalë edhe Meritën që ishte e përgjumshme... Halimi shante, bërtiste e shtyhej me policë, por nuk kishte shanse të më bënte diçka. U larguam nga aty dhe e lamë Halimin duke m’u kërcënuar se do të më gjente dhe do të më mbyste.

XIII

Tash ndihesha më mirë, pasi që Merita ishte me mua. Më merrnin shpesh në pyetje dhe secilën herë më pyesnin nëse e kisha dikë nga familja. Donin të dinin se kush mund të më ndihmonte dhe te kush mund të shkoja nëse më kthenin në Kosovë. Iu tregova se familja më kanë përjashtuar për shkak të Halimit dhe që tri vjet nuk kam kontakt me askënd.

Koha më kalonte mirë këtu. Merita luante me fëmijë, nganjëherë dëshironte të dilte jashtë objektit, por nuk ishte e lejuar pa përcjelljen e dikujt. Në shëtitje dilnim të gjithë së bashku dhe më përcjelljen e së paku pesë personave. Pas dy muajsh, më ftuan që të shkoja poshtë në zyrë. Më njoftuan se kishte thirrur dikush nga policia dhe kishte thënë se një anëtar i familjes sime dëshironte të bisedonte me mua.

– Ti mund të bisedosh me të edhe nëpërmjet telefonit pa e parë. Mos ki frikë se nuk lejojmë që ta dijë kush se kush je dhe nuk e lejojmë që të të afrohet. Mendojmë se ia vlen që së paku një herë të provosh të bisedosh. Është me rëndësi që ke tani dikë nga familja jote që të të ndihmojë.

Më tha që të kthehesha aty pas gjysmë ore. Pasi u ktheva, cingëroi telefoni. Sapo u kapa dëgjuesen e telefonit, dëgjova zërin e xhaxhait tim, Ismailit.

– Ku je moj Trëndafille? Si je? Kemi dëgjuar se çka ka ndodhur, por mos të bëhet kjo punë më e madhe. Këta policët nuk po më tregojnë se ku gjendesh, vetëm më thonë se je në shtëpi të grave. Unë kam ardhur të interesohem në emër të babait tënd, sepse ai nuk ka pasur kohë. Të lutem Trëndafille vetëm po dua ta kryej amanetin e babait tënd e të flas me ty personalisht e pastaj vazhdo ti prapë si të duash. Unë do të të thërras nesër prapë.

Zonja që ishte atë mbrëmje kujdestare, më tha që të provoja të bisedoja njëherë me xhaxhain sepse, mbase, do ta kenë ndryshuar mendjen, e nëse nuk është ashtu atëherë do të mund ta ndërprisja kontaktin prapë. Nuk kisha se çfarë të humbisja. Të nesërmen xhaxhai

thirri prapë dhe e lamë për t'u takuar në disa rrugica larg shtëpisë së grave, që të mos e dinte se ku gjendeshim saktësisht. Dëshiroja të besoja se do të bëhet mirë, por kisha një parandjenjë të keqe që nuk më largohej asnjëherë. Prej së largu e njoha veturën me regjistrim të Zvicrës. Xhaxhai zbriti së bashku me një djalë të hallës time, të cilin nuk e doja fare dhe nuk më erdhi aspak mirë kur e pashë. Ishte pesë vjet më i vjetër se unë dhe shumë herë më ngacmonte derisa ishim fëmijë. Njëherë kishte provuar të më dhunonte. Më kishte mbërthyer me duar përmbi rroba dhe kishte nisur të më puthte në gojë duke më thënë se kjo nuk është asgjë e keqe dhe se e bën nga dashuria. Ndihesha shumë keq, doja t'i tregoja dikujt por kisha frikë. Këtë gjë provoi ta bënte disa herë. Pas fejesës me Halimin e kuptova që këta dy janë edhe shokë të ngushtë në mes vete.

U përshëndetëm, Merita filloi të qante kur iu afruan sepse nuk i njihte. Shkuam në një restorant dhe ende pa u ulur mirë, xhaxhai Ismail nisi të më këshillonte duke e quajtur veprimin tim fatal.

– Pak na e ke marrë fytyrën në fillim me të, e tash po don me na e nxirë mirë. Ti tash je grua e burrit dhe duhet të durosh. E ndërpreva duke dashur t'ia tregoja të vërtetën, por ishte e kotë sepse ai nuk dëshironte ta dinte të vërtetën. Më tha se nuk është bërë nami nëse të ka sharë, ndërsa sa për rrahje, nuk ka burrë që nuk e ka rrahur ndonjëherë gruan e vet. Babai yt që i ke nxjerrë telashe pa masë, tash këtë problem duhet ta zgjidhë me burra. Ti e di mirë Trëndafille se për kësi punësh bëhen gjaqe. Unë të kisha këshilluar të mos bëhesh kokëfortë dhe të kthehesh te burri yt. Bëhu e dëgjueshme dhe mos na bëjë telashe se përsëri një burrë duhet ta marrësh. Nuk po mund ta kuptoj pse e ke marrë Meritën, ajo është vajza e tij. Ti e di mirë se fëmija i takon babait. Ti nuk je e vetëdijshme se je duke na futur në një bela të madhe...

I humba të gjitha shpresat që i pata se këtë herë do të më kuptonte dikush nga familja ime. Shkuam në postë ku xhaxhai e mori babin në telefon dhe pas pak çastesh më ftoi mua të hyja në kabinë dhe ma zgjati dëgjuesen. Qe fol me babain tënd.

– Po ku je moj Trëndafilë? Dëgjo mirë se çka po të them: unë nuk kam pasur kohë që të vij, por dëgjoje mirë axhën Ismail se çka po të thotë dhe mos vepro ashtu. Mos ma merr fytyrën edhe më shumë se çka ma ke marrë deri më tash.

E lëshoi dëgjuesen pa u përshëndetur fare. Nuk i interesonte mendimi im sepse nuk më lanë të flisja asnjë fjalë. Babai im nuk kishte ndryshuar aspak. Kishte tri vjet që nuk më kishte parë e as dëgjuar zërin, dhe nuk po e kuptoja se si nuk e kishte marrë malli për mua. Më la prapë në duar të huaja. Pasi dolëm nga posta, xhaxhai e thirri Halimin në telefon dhe i tha që të takohemi të gjithë së bashku për të biseduar. O Zoti madh, po më çojnë prapë në gojë të ujkut! U takuam në një parking. Më vinte shumë vështirë që ta shihja Halimin prapë. Jam shumë e sigurt se po mos ta kisha Meritën me vete, do të kisha ikur prej këtyre bishave të egra. Ata u përshëndetën në mes vete siç është zakoni, kurse unë mbeta si e shtanguar. Halimi shtirej si një engjëll dhe thoshte se për të gjitha isha unë fajtores.

– Trëndafilja nuk po kujdeset për Meritën ashtu siç duhet, nuk po na përgatit bukën, po bën çka po don vetë. Madje unë po dyshoj se mos është e lidhur me ndonjë mashkull tjetër ngase nuk po më lë as të fle me të. Po dyshoj mos është njoftuar me ndonjë gjerman sepse edhe gjuhën e ka mësuar shumë mirë për një kohë të shkurtër...

Nuk la send pa gënjer... Vendosën që unë shpejt t'i rregulloja të gjitha e të kthehesha te Halimi, dhe të mos ia ndaloja ta shihte Meritën. Më shtynë pa dëshirën time që t'i tregoja Halimit se ku gjendesha. Ata ishin të mendimit se burri ka të drejtë ta dinte se ku gjendej gruaja e tij. Më në fund më lanë në duar të Halimit i cili u premtoi se kurrë nuk do të ma bënte ndonjë të padrejtë, dhe shkuan. Halimi më ktheu prapë në shtëpi të grave që t'i bëja plaçkat gati dhe më tha se nesër do të vinte të më merrte. Unë duhej t'u thosha atyre të shtëpisë së grave se po kthehem vullnetarisht te Halimi. M'u desh të veproja ashtu si më urdhëruan, edhe pse prapë u dëshpërova. Nuk doja ta humbja shpresën që t'i shihja prapë prindërit e mi, t'i shihja motrat dhe Adrianin. Më kishte marrë malli ta përjetoja ndjesinë e

të qenit në rrethin familjar. Të mos isha më e vetmuar, por që edhe Merita të njihej me të gjithë. Ndonëse nuk e mirëpritën këtë vendim timin në shtëpinë e grave, ato e respektuan dhe më dëshiruan fat. Nuk mund ta shihja me sy atë xhahil, por tjetër zgjidhje nuk kisha. Më mbeti ta shihja se si do të zhvillohej ngjarja.

XIV

Ditët kalonin dhe filloi çdo gjë të përsëritej. Babai nuk më telefonoi më asnjëherë. Dhunimet vazhduan. Halimi edhe njëherë ia arriti qëllimit të tij. Nuk mund t'ia falja vetes këtë gabim. Halimi më kontrollonte në çdo hap, më nënçmonte dhe më provokonte me fjalë. Çka është më e keqja, ai planifikonte që të kthehemi në Kosovë. E kam dëgjuar duke folur në telefon me nënën e tij dhe duke i premtuar se do t'i ndreqë të gjitha në shtëpi. Fliste me nënën e vet në telefon, por pa e kuptuar unë se çfarë po planifikonin. Një mbrëmje u acarua shumë. Më urdhëroi që ta përgatisja Meritën për shtrat dhe më tha se dëshironte të bisedonte diçka me mua. E kuptova se prapë dëshiron të më ndante nga Merita. U përpoqa të paraqitesha sikurse çdo gjë ishte në rregull. E ushqeva Meritën. Zemra më vajtonte për të. E puthja dhe e përqafoja pas secilës kafshatë që hante dhe në heshtje i lutesha Zotit që të më jepte fuqi sepse nuk mund ta mbaja premtimin që i kisha dhënë Meritës se më nuk do ta lija vetëm. E di që Halimi do të përkujdesët për të. Pasi u ngi Merita, e përqafova edhe një herë, thashë se mami vetëm do t'i pastrojë enët dhe do të kthehet menjëherë. Halimi e shikonte televizorin, i shtrirë si pasha. Dola jashtë i lëshova pa zhurmë ato dy tri enë që pata në dorë, i mbatha këpucët, e lashë derën e hyrjes hapur dhe u largova me shpejtësi. Së pari desha të shkoja të Teuta dhe Agimi me të cilët njiheshim mirë sepse i kishim miq. Ata banonin në një fshat afër nesh rreth dhjetë minuta. Por kur arrita në udhëkryqin e udhës kryesore, mendja më tha që të shkoja te një familje gjermane që ishin të vjetër e nuk kishin fëmijë e që na donin shumë mua dhe Meritën. Mirëpo, këta banonin në një qytezë të afërt, por më larg sesa Teuta dhe Agimi. Megjithatë, te gjermanët ndihesha më e sigurt. Përpiqesha t'i ndaloja veturat që kalonin, por nuk u ndal askush. I tërë trupi më dridhej derisa vrapoja. Isha e vetëdijshme se Halimi nuk bën të më zinte sepse pas kësaj nuk kishte më shpëtim. Sa më shumë që i afrohesha shtëpisë së gjermanëve, aq më shumë lutesha që t'i gjeja aty. I rashë ziles disa

herë pa kontroll. Për fatin tim u ndez një dritë dhe u hap dera. Zonja Adam, e çuditur ma hapi derën dhe më la të hyja brenda. Menjëherë erdhi edhe burri i saj dhe shkua në kuzhinë. Ua shpjegova se çfarë kishte ndodhur me mua vitet e fundit. Më dëgjonin me vëmendje dhe më besonin, ndonëse shumë gjëra për ta ishin të pakuptueshme. Natyrisht pranuan që të rrija sa të doja me ta. Më qetësuan me fjalë të buta, zonja më përgatiti pak bukë për të ngrënë dhe ma bëri gati shtratin. Të nesërmen thirra në shtëpi të grave dhe ua tregova të gjitha me radhë. Më thanë që mund të shkoja prapë aty por kjo nuk ishte e mundur pasi që Halimi e dinte atë vend. Më duhej ta gjëja një tjetër zgjidhje. Tri ditë ndenja e mbyllur pa dalë as në kopshtin që gjendej mbrapa shtëpisë. Koha më kalonte më frikë e ankth, me mërzi dhe mall që ndiente zemra ime për Meritën. Meqë Halimi e dinte se ku gjendej shtëpia e grave ku isha më parë, më transferuan nja 100 kilometra larg në një shtëpi të azilantëve. M'i dhanë disa rroba nga Kryqi i Kuq sepse nuk kisha asgjë me vete. M'i dhanë disa enë dhe disa gjëra ushqimore. M'i shpjeguan disa rregulla dhe më çuan në dhomën time. Hyra në atë dhomë të vogël dhe të ftohtë, e mbylla derën që të mos futej kush brenda e u ula në shtratin e hekurit duke qarë. Nuk më rrihej pa Meritën. Aq shumë më mungonte sa më dukej se nuk e kisha parë disa muaj.

Nuk kam më fuqi, jam lodhur duke ikur. Sa i përket Meritës, këtë herë duhet të vendos gjykata sepse unë isha në një komunë tjetër. Megjithatë, nuk po e humb shpresën, do të luftoj deri në fund. Më ftuan që të shkoja në zyrë sepse kishte një letër për mua. Mendoja se ka ardhur nga shtëpia e grave, por kur hyra në zyrë, punëtorja më shpjegoi se kishte ardhur një letër nga gjykata. Së pari u gëzova sepse mendja më shkoi të Merita, por kjo zonjë ma ktheu gëzimin në pelim kur më tha se ajo nuk ishte letër e mirë. M'i lexoi ata rreshta në të cilët shkruante se mbas dy ditësh duhej të paraqitesha vullnetarisht për ta mbajtur një javë burg. M'u duk se m'u shemb tërë ndërtesa mbi kokë. Nisa të qaja dhe e pyeta pse po dënohesha me burg, ç'kisha bërë, nuk isha ndonjë kriminele. Zonja më qetësoi

duke më treguar se arsyeja ishte për shkak të kalimit të kufirit të Çekisë pa leje duke thënë se dy herë na kishin dërguar dënimin. Njëherë ishim të dënuar me të holla, por pasi që Halimi nuk i ka paguar, na kanë dënuar që të punonim përafërsisht 100 orë punë në mënyrë sociale. Por, meqë as kësaj nuk iu kishte përgjigjur Halimi, tash më duhej të shkoja në burg. I tregova që unë nuk kisha pranuar ndonjë letër nga gjykata dhe po dëgjoja për herë të parë për këtë gjë. Halimi kishte filluar të hakmerret, kushedi se çka ka gënjyer. Nuk kisha tjetër zgjidhje pos të shkoja vullnetarisht në burg. Nëse nuk shkoja, mund të më kthenin me polici në Kosovë. Duke pyetur rrugës, mezi e gjeta ndërtesën e burgut, cingërova dhe u hap dera e hekurt e hyra në oborrin e rrethuar me mure të larta dhe me gjemba prej teli. U hap një derë tjetër pa trokitur e as cingëruar ku më priste një polic roje. Hyra brenda dhe ua tregova atë letrën e gjykatës. M'i kontrolluan rrobat një nga një, m'i morën të gjitha përpos gjërave elementare. Më treguan se si duhet të sillem këtu dhe më çuan në kat të parë në një qeli ku gjendej një krevat, një tavolinë, një karrige, një dollap njëkrahësh, një larëse e duarve dhe wc-ja. Sapo hyra brenda, u mbyll menjëherë dera e hekurt. O Zot i madh nuk po e dija se çfarë po ndodhte me mua. Qaja e i mëshoja shtratit me duar, i mëshoja murit me kokë derisa u lodha dhe koka më dhembte e sytë donin të më plasnin. Si do ta kaloja një javë këtu? Çka do të ndodh pastaj? Çka po ndodh me Meritën? Duke u lutur dhe qarë e kalova natën e parë. Rojet i kontrollonin rregullisht qelitë nëpërmjet dritareve të vogla që hapeshin vetëm nga jashtë. M'u desh ta bëja një javë në mesin e rebelëve, hajnave, kriminelëve e të droguarve. Sytë nuk m'u ternin fare. Mendja më rrinte vetëm te Merita. Gjithçka do të bëj për engjëllushen...

U ktheva prapë në shtëpinë e azilantëve. Shkova në zyrë që të paraqitesha dhe ta merrja çelësin e dhomës. Kur hyra në dhomë e pashë se nuk kishte mbetur asgjë nga ato pak gjërat që i kisha lënë. Gjithçka më duket si një ëndërr e keqe. Sa do të dëshiroja që kjo ëndërr të merrte fund. Shumë e dëshpëruar dhe e mërzitur për

Meritën, vendosa që të shkoja në qytet në një kabinë telefoni dhe me ato pak të holla që i kisha, ta merrja ndonjë informatë për Meritën. Nuk e kisha idenë se kë ta thërrisja. I vetmi njëri që më ra ndërmend ishte ai shoku i Halimit që kishte ardhur të na merrte te kufiri. Me familjen e tij mbanim kontakt të rregullt. Ata e dinin se si sillej Halimi ndaj meje, por nuk kisha numër të tyre. Vetëm e dija se ku banonin. Tani gjendeshin më afër se përpara. Shkova në stacion të trenit, e bleva biletën dhe u nisa pa e ditur fare se si do të reagonin kur të më shihnin. Më priten mirë dhe kjo më befasoi. Nuk kishte nevojë që t'iu tregoja asgjë sepse Halimi nuk kishte lënë kujt pa i treguar në mënyrën e tij se si gjoja unë e kisha tradhtuar me një gjerman dhe shumë gjëra tjera që nuk kishin të bënin aspak me të vërtetën. Më thanë se Halimi kishte qenë një ditë më parë me Meritën në vizitë te ta. Më lutën që të flija atë natë te ta. Pranova ngase dëshiroja të merrja më shumë informata për Meritën. Më treguan shumë e shumë gjëra, në të vërtetë shumë e shumë gënjeshtër që i kishte përhapur Halimi. Ai e kishte informuar prapë familjen time se kisha ikur dhe sikur gjoja nuk më interesonte fare për Meritën. Më thanë të mos brengosesha se Merita ishte mirë dhe nuk e di nëse u lehtësova apo u mërzita edhe më shumë. Të nesërmen prapë më lutën që të flija aty, duke u shprehur se e kuptonin pozitën time. Ata i kanë vetë fëmijët e moshës sime dhe me siguri do të kenë biseduar rreth meje. Ndenja edhe një natë dhe u ktheva prapë në shtëpinë e azilantëve. Nuk dija si ta kaloja kohën. Mendjen e kisha te Merita, ndërsa për familjen time as që më interesonte se si po ndiheshin. Secila ditë që kalonte, ma shtonte mërzinë. Lotët nuk më ndaleshin dhe më mbyste vetmia. Një pasdite erdhi ai çifti shqiptar dhe ma bënë një propozim që të shkoja te ta dhe të rrija sa të doja. Më thanë se nuk është mirë që një femër e kësaj moshe të rrinte e vetme në një shtëpi të tillë. Më thanë se mund të flija me vajzën e tyre në një dhomë dhe se do të më ndihmonin sa të mundën. Pranova dhe shkova tek ata. Ishte më mirë sesa ta kaloja kohën këtu. I kisha dhënë vetes detyrë që ta merrja Meritën prapë. Halimit sikur nuk i mjaftonin këto që m' i kishte bërë

dhe më kishte paditur në gjykatë. Më kishin ftuar në gjyq ku duhej të merrja pjesë patjetër. Më duhej ta gjëja një avokat. E gjeta, ajo quhej zonja Schnabel. Isha e detyruar t'ia tregoja të vërtetën që nga fillimi. Më besoi dhe më premtoi që do të më ndihmonte. Më shqetësonte shumë fakti se duhej të shkoja në gjykatë, por shpresoja se pas një kohe të gjatë do të mund ta shihja Meritën. Njëherësh kisha frikë edhe nga sjellja e Halimit, andaj nuk i largohesha avokates sime. Halimi erdhi në sallë me avokatin dhe përkthyesin por pa Meritën. Qëllimi i tij ishte që të kthehem prapë tek ai. U munduan që të më bindnin, por ua bëra të qartë se më nuk kthehem. Kur dolëm jashtë, papritur m'u drejtua Halimi duke më thënë se nuk do ta shihja kurrë më me sy Meritën. Kjo gjë më preku dhe ma shtoi frikën. Halimi i kishte blerë biletat për në Kosovë, ai vetëm kishte pasur qëllim që të ma mbushte mendjen që të shkoja me të. Mora vesh që qysh të nesërmen mbas gjyqit ishte kthyer në Kosovë me Meritën. Nuk doja ta besoja këtë lajm derisa nuk e vërtetoi avokatja ime e cila ma sqaroi që ligji gjerman nuk ka të drejtë që të ndërhyjë në shtet të huaj, kështu që Merita i takonte Halimit. Kjo do të thoshte se unë nuk do ta shihja më Meritën. Më humbi fuqia, nuk më punonin duart, nuk më punonin këmbët e as truri. Mbeta si një qyq në këtë botë, e zhgënjyer dhe e mallkuar. E rrethuar nga mashtrimet, gënjeshttrat, intrigat dhe vuajtjet. Për mua më nuk ka kuptim jeta. Tashmë gjendesha aty ku as hasmin më të madh nuk doja ta shihja. Nuk mund të pajtoheshja kurrësi me faktin se nuk do ta shihja kurrë më vajzën time. Nuk kishte gjë më të vështirë sesa të të ndajnë nga fëmija yt. Më mirë të ma kishte marrë Zoti shpirtin sesa që mbeta kështu gjallë e për gazep. Nuk do të lejoj që Merita të mendojë se nuk e kam dashur. Dua t'ia tregoj të vërtetën asaj edhe pse kam frikë se nuk do të më kuptojë.

XV

U detyrova të kërkoja punë, sepse po të rrija në shtëpi, do të çmendesha. Mendoj se nga kjo vetëm mund të përfitoja sepse s'kisha çfarë të humbisja. Nisa ta mësoja gjermanishten dhe nuk lija vend pa kërkuar punë. Pas një kohe të shkurtër gjeta punë në disa vende. Në një vend pastroja, në një tjetër ngarkoja dhe shkarkoja pemë e perime, ndërsa në mbrëmje laja enët në një restorant grek. Nuk ishte e lehtë që për çdo ditë shkoja prej njëres punë në tjetrën, por vetëm në këtë mënyrë mund të shpëtoja nga shkatërrimi që më kishte përgatitur Halimi. Sa më shumë që punoja, aq më pak kisha kohë për të menduar, por edhe më duheshin të holla që ta paguaja qiranë te familja te e cila jetoja. Edhe pse ata më kishin pranuar përkohësisht të banoja aty, unë shkoja vetëm sa për ta bërë gjumin. Atë pak kohë të lirë që e kisha, shkoja në ndonjë park dhe tërhiqesha në botën time. Në këtë mënyrë mund të meditoja në qetësi pa i penguar të tjerët. Për disa muaj kurseva pak të holla sepse nuk shpenzoja shumë, vetëm paguaja qiranë dhe blija gjërat e domosdoshme për veshmbathje, madje edhe ato i blija kur ishin në lirim. Mendoja që pas një kohe të gjeja një banesë të vogël dhe të jetoja vetë, pasi edhe ashtu më duhej të paguaja qiranë.

Kështu kaluan ditë, javë e muaj, me të vërtetë kishte kaluar më shumë se një vit, e nga familja ime nuk kisha kurrfarë lajmi. Malli për Meritën më shtothej pandërprerë e sidomos në ditë të veçanta, në ditëlindjen e saj, në ditët e Bajramit... Sa herë shihja ndonjë fëmijë moshatare të saj, më dilte parasysht ajo. Vetëm zemra ime e di se si e përjetoi.

Një ditë papritmas më thirri Teuta e Agimit në telefon. E kisha vizituar nja dy herë dhe shpresoja se do të ma kthente edhe ajo vizitën apo së paku të ruajmë ndonjë kontakt si në fillim kur u shoqëruam. Teutën e kisha të vetëm shoqe shqiptare, por me kalimin e kohës kontaktet tona u rralluan. Nëse unë i telefonoja ndonjëherë, ajo më telefononte shumë rrallë. Për këtë arsye telefonata e saj më

gëzoi. Pasi biseduam një kohë të gjatë, më tregoi përse më kishte telefonuar. Më tha se tek ajo gjendet një letër e adresuar me emrin tim që më kishte ardhur nga motra ime Teuta.

– Trëndafile, unë kam qëlluar rastësisht për një vizitë te një shoqe në shtëpinë e azilantëve ku keni banuar ti e Halimi dhe të gjithë interesoheshin për fatin tënd. Letrën e ke tek unë, kur të duash eja e merre.

Dëshiroja ta dija se çka shkruante në atë letër. Nuk kisha durim të prisja, pasi që kisha një veturë të vjetër por që funksiononte mirë, u nisa menjëherë. Teuta më rrinte disi e ftohur, nuk e di pse. Nuk ndenja gjatë, pasi që biseda e jonë rridhte me vështirësi, por nga ana tjetër doja që sa më parë ta lexoja letrën. Sapo arrita në banesë, e lexova, jo një e dy, por pesë herë. Teuta, motra ime, nuk më kishte harruar. Secila fjalë ma zinte frymën. Sa mirë e kishte shkruar atë letër motra ime, për të cilën unë dikur isha kujdesur. Sa ishte rritur dhe zbukuruar. Nuk mund t'ia ndaja sytë asaj fotografie që e kishte futur në mes të letrës. Herë lexoja nga një rresht, e herë e shikoja fotografinë. Në fund të letrës m'i kishte shkruar këto vargje:

Für Dich!

Ich dachte an Dich drum schreibe ich Gedicht.

Ich habe eine Wut, in mir treibt die Glut.

Ich werde es nie verstehen, wie sollen meine Gefühle vergehen?

Immer wieder denke ich, an die Geschichte ich glaubs einfach nicht.

Ich träume von dir, du wärst hier und sagtest nette dinge zu mir.

Schlimm war das erwachen, heute kann ich nicht mehr lachen.

Ich hab dich so Lieb, doch du bist ein Dieb!

Du hast mir mein Herz gestohlen, ich will's mir wiederholen.

Doch das ist nicht leicht, das braucht noca zeit.

Du kannst nur eins, und das ist Lügen, ich kann nur eins, Dich Lieben.

Gjithashtu ma kishte shkruar edhe një numër telefoni të punës së saj dhe premtimin se askujt nuk do t'i tregonte. Më ishte lutur që t'i besoja dhe të flisja me të. Të nesërmen në terminin që ma kishte caktuar ajo, i telefonova. U gëzova shumë kur ia dëgjova zërin, u gëzua edhe ajo shumë. Më tregoi ku punonte, çka punonte, më tregoi për të gjithë anëtarët e familjes e veçmas për nënën e cila po vuante shumë për mua.

Ia tregova edhe numrin tim të telefonit dhe e lamë që të kontaktonim rregullisht, por me premtimin se nuk do t'i tregonte askujt.

Pas asaj kohe më shpesh më telefononte ajo mua, sesa unë atë, ngase nuk dëshiroja ta pengoja në punë. Ajo shumë herë më thërriste nga shtëpia. Sa herë që prindërit shkonin diku, ajo e shfrytëzonte rastin e më telefononte dhe bisedonim gjatë. Një mbrëmje kur më thirri, zëri i saj tingëllonte disi ndryshe, mirëpo nuk i dhashë shumë rëndësi kësaj. Edhe herën tjetër prapë zëri i saj tingëllonte ndryshe. Më dukej se ishte një tjetër Teutë. Kështu vazhduan telefonatat disa herë derisa filloi të më tregonte më shumë për prindërit edhe pse unë nuk e pyesja shumë hollësisht. Më thoshte se i ka marrë shumë malli ata për mua dhe se nuk do të ishte keq të flisja edhe unë me ta. Më thoshte se babai është përmirësuar... Kështu vazhdonte mbas çdo telefonate. Më luti që për hir të saj të bisedoja njëherë me prindërit. I thashë që unë nuk kisha asgjë kundër prindërve por ia bëra të qartë se nuk do të lejoja që të më kthenin më te Halimi. Nuk mund t'iu besoja atyre, dyshoja se do të më mashtronin e të më kthenin ne Kosovë.

Teuta më tha se ishin përhapur fjalë se gjoja unë po jetoja në një kishë dhe se një revistë shqiptare kishte shkruar për mua: "Shqiptarja u nda nga burri shqiptar, ia ka kthyer shinën vajzës së vet të vogël, për t'u martuar me një zezak!"

I thashë se nuk kishte asgjë të vërtetë nga kjo, nuk isha as kundër asaj që babai të njoftohej me ata shqiptarë ku kam jetuar disa kohë dhe do të mësonte më mirë për mua. Ia përsërita edhe njëherë qartë

se nuk do të lejoja të më kthenin te Halimi apo të më martonin edhe njëherë me dikë.

Teuta ma përcolli premtimin e babait se vetëm dëshironte të takohej dhe të bisedonte me mua. I besova dhe caktuam një termin ta takohemi me babain.

Më kaploi një ndjenjë e çuditshme sepse babain do ta shihja pas shumë vitesh. Nuk dija si ta përshëndesja, a t'ia zgjatja vetëm dorën apo ta përqafoja. Isha shumë e shqetësuar dhe shqetësimi më rritej edhe më tepër kur e pashë nga larg dhe e njoha menjëherë. U ulëm në një kafeteri. Babai ia nisi menjëherë bisedës. Ishte kureshtar të mësonte se ku dhe si po jetoja. Më propozoi që të shkoja me të disa ditë në Zvicër, ngase nënën dhe motrat i kishte marrë shumë malli për mua.

– Ti ke familje dhe nuk bën të jetosh në shtëpi të hallkut, më tha babai gjatë bisedës.

Këtë e shihja si shans që t'ia shpjegoja babait fill e për pe se çka kishte ndodhur me mua e Halimin. I tregova se po punoja ngapak sa për t'i mbuluar shpenzimet e mia dhe ia tregova dëshirën që kisha për ta vazhduar shkollimin. Shumë herë ma ndërpriste fjalën me komente të ndryshme. I thashë që unë nuk do t'i fshija asgjë. Kur nisa t'i tregoja se si ka filluar lidhja me Halimin, ma mbylli gojën menjëherë duke më thënë se nuk më beson. Por më së rëndi më erdhi kur tha se njerëzit nuk flasin kot për dikë.... Doja t'i thosha se zemra ime shumë më herët i ka takuar Shkëlqimit, por nuk munda. Zemra donte t'i thoshte, por nga goja nuk dilnin ato fjalë. U përzieri respekti, mllefi dhe dashuria në një kombinim që ma ngurtësoi zemrën. I thashë çfarë doja t'i thosha qysh kur isha fëmijë.

– Edhe për ty kanë folur shumë njerëzit, kanë thënë se ke pasur një grua tjetër dhe fëmijë tjerë në Zvicër, se ti nuk ke dashur të na marrësh të gjithëve me vete sepse të ka ardhur turp me shumë fëmijë...

Këto fjalë nuk i pëlqyen aspak dhe iu ngrys fytyra. Më urdhëroi që ta mbyllja gojën dhe që të mos flisja pa lidhje. U binda se ai nuk

kishte ndryshuar, dhe, edhe pse doja t'i besojta fjalëve të Teutës, faktet më flisnin ndryshe. Kur e pa që e shpreha mendimin tim, më tha që t'i mblidhja mendtë mirë dhe të mos e çoja ndërmend shkollën sepse kjo, sipas tij, ka përfunduar.

– U zhgënjeva. Paskam menduar që ti je e mençur dhe e sjellshme, por me këto që po thua, ti paske me përfunduar në prostitutë.

I nxori njëmijë franga zvicerane nga xhepi dhe i qiti në tavolinë.

– Merri, tha, se të duhen.

Ia shtyra ato të holla prapë. I thashë se nuk më duhen, deri më tani kam mbetur gjallë pa të hollat e tij. Unë kam të hollat që i kam fituar vetë dhe më shumë nuk më nevojiten. Dëshironte gjithsesi të më merrte me vete qysh atë ditë në Zvicër. I thashë që nuk mund të shkoja për shkak të punës dhe një terminit që kisha caktuar te dentisti.

– Nuk po mund ta kuptoj Trëndafille se si disa gjëra qenkan për ty më të rëndësishme se familja jote. Nëna jote po qan natë e ditë për ty, e edhe Teuta e Adriani me padurim po të presin të të shohin. A e njeh ti Mirjetën dhe a mund ta dallosh nëse e takon rastësisht vetëm?

– Jo, iu përgjigja. Herën e fundit kur e kam parë, ishte 4 vjet.

– Trëndafille a nuk po do me pa se sa është rritur Mirjeta që ti e ke dashur me shpirt?

E dinte ky mirë se ku më dhembte shpirti. I thashë se më nevojitet një javë që t'i rregulloj disa punë dhe i bëra me dije se nuk kisha të drejtë të shkoja në Zvicër, sepse nuk kam kurrfarë dokumenti për ta kaluar kufirin. Kam patentë shoferi dhe një letërnjoftim që vlen vetëm për Gjermani. Nuk kam pasaportë. Pasaportën jugosllave që e kam pasur, ia kisha dhënë xhaxhait herën e fundit kur më pati premtuar se ju do të ma ruanit. Diçka nga brenda më thoshte që të mos i besojta babait, më thoshte “mos shko”. Por malli më kishte gërryer. Doja që pas shumë vitesh ta shihja familjen time, të dashurit e mi. E caktua një ditë, babai më tha që t'i merrja gjërat kryesore

dhe tha se do të vinte të më merrte. Sa i përket dokumentit që nevojitet për ta kaluar kufirin, më premtoi se ai vetë do ta gjente një zgjidhje. M'u shtua pak dyshimi kur më tha që t'i merrja rrobat me vete. E pyeta se a do të më kthente prapë në Gjermani, duke ia bërë të qartë se nëse nuk më kthente, nuk do të shkoja për Zvicër. I thashë të mos provonte të më kthente në Kosovë, duke ia bërë me dije se nuk kthehem me asnjë kusht. I thashë që të ma jepte besën që të më kthente prapë në shtëpinë time ku po jetoja. U përpi nja dy-tri herë por ma dha besën e shqiptarit se do të më kthente prapë. Tha se vetëm dëshironte të na bënte bashkë të gjithëve e pastaj do të shohim se si do t'ia bënim kësaj pune. Edhe pse kisha mjaft dyshime, kur ma dha besën – i besova. E dija që njerëzit më parë e kanë dhënë jetën sesa e kanë thyer besën. Gratë i kanë rritur fëmijët vetëm, kur iu ka vdekur burri, sepse e kanë dhënë besën. Gratë nuk janë martuar pas vdekjes së burrit edhe atëherë kur nuk kanë pasur fëmijë sepse e kanë dhënë besën. Gjaqet janë falur kur kanë dhënë besën. Të dashuruarit e kanë pritur njëri-tjetrin më vite kur ia kanë dhënë besën... Kjo ishte një fjalë me domethënie të madhe për mua.

XVI

Tërë rrugës për në Zvicër nuk flisja, vetëm shikoja. Nuk e dija se çfarë po më priste, por gjithherë mendoja për besën e dhënë. Babai më pyeste kohë pas kohe se a dëshiroja të haja apo të pija diçka, por unë gjithmonë i përgjigjesha me jo. Nuk e di a ishte rruga shumë e gjatë apo më dukej ashtu mua, ngase kurrë në jetën time nuk kam qëndruar aq gjatë vetëm me babain. Nuk ndihesha aspak mirë, madje u gëzova në një çast kur u ndal për ta furnizuar makinën me karburant. Mora frymë thellë, i lëviza të gjitha pjesët e trupit që më ishin shtanguar pa lëvizur fare. Pas tre apo katër orë udhëtimi arritëm te një liqe shumë i madh dhe hipëm bashkë me makinë në një anije të madhe. Pas gjysmë ore arritëm në anën tjetër. Para se të zbrisnim nga anija, babai ma dha letërnjoftimin e Teutës dhe më mësoi si të sillem në kufi. Më tha që së pari unë ta prisja në një shitore derisa të kthehej. Tha se do të shkonte ta parkonte veturën në anën zvicerane dhe do të kthehej në kamp për të më marrë mua, sepse kufitarët zviceranë nuk i kontrollonin shumë këmbësorët, ngase shumica e tyre dilnin në Gjermani për t'u furnizuar me gjëra ushqimore të cilat ishin shumë më lirë. Prita në shitore ashtu siç më tha babai. Blemë bukur shumë gjëra ushqimore, madje edhe disa gjëra që për mendimin tim nuk ishin të nevojshme, për këtë bëmë që t'i mashtronim kufitarët. Kalonin shumë njerëz në këmbë. Babai ecte përpara, kurse unë prapa tij. I treguam të dytë letërnjoftimet, kuptohet unë atë të Teutës. Kufitarët i shikuan nga larg letërnjoftimet dhe na dëshiruan rrugë të mbarë. Pastaj me vrap shkuam te vetura. Babai ende kishte frikë se mund të na hetonin dhe më tha se “a po e sheh sesa shumë po rrezikoj për ty”.

Kisha dëshirë t'i thosha se unë nuk e kam detyruar të bëja këtë punë dhe se nuk isha i sigurt nëse po e bënte për mua apo për vete, por natyrisht nuk thashë gjë.

Kur arritëm, zemra filloi të më rrihte me ritëm të përshpejtuar. Teuta më doli përpara dhe më përqafoi fort. Pas saj m'u afrua

Adriani, i cili ishte rritur dhe kishte ndryshuar shumë. Edhe Mirjeta më përqafoi duke më thënë se e ka ditur që e ka edhe një motër tjetër por që nuk e ka parë kurrë. Nuk mund t'i ndalja lotët që më rridhnin si krua. Motra ime e vogël dikur më priste me padurim derisa kthehesha nga shkolla dhe nuk më linte ta bëja një hap pa të, tash më thoshte se nuk po më njihte. Më në fund m'u afrua edhe nëna. U përqaftuam pa mundur ta flisnim asnjë fjalë. Më shtrëngoi aq shumë sikur donte të më thoshte se kurrë më nuk do të më linte të largohesha.

– Mjaft më, hyni tash brenda, – ndërhyri babai.

Florenti, vëllai i madh, tash jetonte në Kosovë, ngase e kishin larguar nga Zvicra për shkak të problemeve që i kishte shkaktuar në këtë shtet. Më thanë së pari të shkoja të pastrohesh nëse doja dhe më treguan se buka ishte gati. Unë isha pastruar në mëngjes, andaj vendosa të shkoja menjëherë në kuzhinë. Ata secili i kishin vendet e tyre, ndërsa unë nuk dija se ku të ulesha. Secili fliste diçka, tregonte diçka, ndërsa unë vetëm heshtja. Jo që nuk kisha çka të tregoja, por kohët e fundit kishin ndodhur aq shumë ndryshime sa bota ime dallonte tërësisht nga ajo e tyre.

Më treguan se kush ka lindur, kush është fejuar, martuar. Kush ku po gjendej dhe çka po bënte. Më treguan se edhe kush kishte vdekur. Shumë gjëra kishin ndryshuar. Pak lakmi ua merrja Teutës, Adrianit dhe Mirjetës, kur më tregonin për shkollën, thoshin se më mirë ishte në Zvicër sesa në Kosovë. Që të tre ishin nxënës të shkëlqyeshëm...

Për Meritën nuk më tregoi askush asgjë, madje as që përmendej diçka rreth kësaj teme. Por as unë nuk i pyeta, edhe pse dëshiroja t'i pyesja. Kisha një ndjenjë të çuditshme. Nuk ndihesha e lirë edhe pse isha me familjen time. Nuk mund të gëzohesha siç bëja dikur. Ata flisnin nganjëherë lidhje e pa lidhje vetëm e vetëm që të më shtinin mua të flisja apo të qeshja. Banesa ishte shumë e bukur. Secili e kishte dhomën e vet të rregulluar sipas dëshirës. Nëpër mure gjendeshin fotografi të ndryshme të të gjithë anëtarëve të familjes,

por jo edhe fotografi timen. Kjo më bënte të ndihesha se nuk jam pjesë e kësaj familjeje. Mezi prisja që të vinte nata dhe të shtrihesha e të pushoja. Kaloi disa ditë dhe nesërme e cila për fat ishte e diel dhe Teuta, të cilën e kisha shtyllë kryesore, ishte atë ditë në shtëpi. Nëna bëri torte, mbasi nga gëzimi që u bashkuam të gjithë. Por mua nuk ma ëmbëlsonte zemrën kurrfarë ëmbëlsire. Ëmbëlsira ime ishte Merita.

Ku është vallë ajo?

Ndoshta këtë herë me ndihmën e familjes do të mund që së paku ta shihja. Unë flija në një dhomë me Teutën. Dhoma ishte afër asaj të prindërve. Nuk më zinte gjumi, shumë gjëra më shkonin nëpër kokë. Teuta do të zgjohej herët dhe të shkonte në spital ku kishte filluar praktikën. Dëgjoja disa pëshpëritje por nuk isha e sigurt se çfarë po flisnin. Prisja se mos po ndaleshin, por nuk e bënë një gjë të tillë. Ishin prindërit e mi që diskutonin diçka por nuk mund t'i dalloja fjalët. Kështu vazhduan më orë të tëra, me gjasë po thurnin plane për mua. Sytë nuk mund t'i mbyllja nga shqetësimi. Në mëngjes të gjithë u nisën për në punët e veta, ndërsa unë shtiresha se po flija. Mbeta në shtrat deri pak para dreke, derisa më ftoi nëna për drekë. Më tha, boll fjete, e unë në fakt gjatë gjithë kohës isha e zgjuar, por i mbyllja sytë që të mos më hetonin.

U shtrua dreka. Të gjithë erdhën pothuajse njëkohësisht. Babai i pyeti të gjithë se çfarë kishin bërë, e në fund më pyeti edhe mua. Më duket se kjo ishte një lojë taktike e tij. I thashë se unë vetëm kisha fjetur deri pak më parë. Atëherë ia nisi:

– Trëndafile, unë kam dëshirë që të rrish edhe ti me ne, por puna është që nuk mund të të mbaj këtu. Ti i ke plotësuar 18 vjet, dhe ligji nuk ta lejon bashkimin familjar. Ti këtu je ilegalisht dhe sikur të të zë policia, mund të m'i prishin letrat edhe mua. E mbyllur gjithmonë nuk mund të rrish, mund të të shohë dikush...

Dhe aty e kuptova se çfarë kishin diskutuar ata gjithë natën.

– Unë kam biseduar me nënën tënde. Të premtëve fluturojnë aeroplanët për në Prishtinë. Do të telefonoj për t'i rezervuar dy bileta!

Më mbeti kafshata në fyt. I thashë se nuk ka pse të frikësohej sepse unë do të kthehesha prapë në Gjermani për t'ia filluar punës.

– Trëndafille, a po mendon ti se unë vërtet të lejoj që të shkosh prapë në Gjermani?

Filluan të më rridhnin lotët. Pak kisha vuajtur deri më tani – e tash edhe kjo! I thashë që ma kishte dhënë besën se do të më kthente përsëri aty ku më kishte marrë.

– Po pse po qan. Ti nuk po shkon vetëm, nëna do të vijë me ty së paku tre muajt e parë. Po shkon në shtëpinë tënde me nënën tënde, te vëllai yt, te gjyshërit tu. Kështu ua mbyll gojën të gjithëve që secilën herë më kanë pyetur ku e ke Trëndafilin. Nëse nuk dëshiron të ktheesh te Halimi, nuk të kthejmë me dhunë. E gjejmë dikë tjetër, ndoshta dikë që mund të t'i bëjë letrat edhe ty. Lind prapë fëmijë të tjerë...

M'u desh të vrapoja në banjë për të vjellë. Më plasi tugu për hundë dhe gojë, donin të më dilnin jashtë zorrë e mushkëri. Si nuk paska ndryshuar babai aspak! Si nuk ka mëshirë! Ai iu beson vetëm hallkut e jo mua. Ky nuk e di që po më kthen në shtëpi ku më janë bërë të gjitha të zezat. Në atë shtëpi që edhe ëndërr kur e shoh, trishtohem. Unë shumë gjëra i kisha treguar por ky nuk më ka besuar asnjëherë dhe nuk po më beson as tash.

Oh, e mjera unë, qysh nuk pata dikë që më kupton. Doja t'ia tregoja babait të gjitha, por fjalët nuk më dilnin, nuk mund ta ndalja vajin.

– Por ti ma ke dhënë besën, – pse nuk po e mban? Unë në Kosovë nuk dua të kthehem më asnjëherë.

– Më është dashur të ta jap besën që të të bind disi për të të sjellë deri këtu. Unë me duart e mia nuk të kthej rrugëve të Gjermanisë.

Shkova dhe u mbylla në dhomë dhe iu thashë që nuk doja ta shija askënd. Ky nuk e paska pasur për mua por për hallk...

As Teuta, por as të tjerët nuk flisnin asgjë. Nuk e di nëse nuk donin apo nuk guxonin nga babai. Por doja të shpresoja që nuk guxonin.

– Mos qaj, vazhdojmë bisedën prapë. U kthyen të gjithë nëpër

punë, vetëm nëna mbeti në shtëpi. Nuk po kuptoj më asgjë. E gjallë nuk pranoj të më kthejnë në Kosovë, por as nuk po mund të gjej zgjidhje si të lirohem nga ky kurth që ma kanë përgatitur. Ato pak të holla që kisha me vete, më mjaftonin vetëm për një biletë, por si ta kaloja kufirin pa kurrfarë dokumenti? Qeshë hidhëruar edhe me Teutën sepse edhe kjo më kishte premtuar se babai vërtet kishte ndryshuar dhe kishte thënë se nuk do të lejonte të më kthenin në Kosovë. Tani ajo po hesht dhe unë nuk e kuptoj heshtjen e saj. Qava prapë me orë të tëra dhe më dukej vetja si njëri më i pafat në botë. Sa do të dëshiroja të më ndaleshin këto vuajtje dhe dhimbje shpirtërore...

Erdhën në mbrëmje të gjithë në shtëpi dhe u ulën për të ngrënë darkë. Më ulën edhe mua me zor, por nuk më hahej. Më ishin ënjtur fytyra dhe sytë. S'i shihja dot asnjërin me sy. Babai prapë filloi të njëjtën temë dhe nuk e ndërronte mendimin aspak, ndërsa unë, çele gur gojën! E tërë mbrëmja vazhdoi kështu. Unë vetëm me trup isha aty ndërsa me mendje isha duke kërkuar zgjidhje se si të lirohesha edhe këtë herë. Mirjeta tha se do të vinte të flinte me mua dhe Teutën në dhomë. I bashkuam të dy shtretërit dhe unë rashë në mes të dyjave. Teuta e kishte parandie mirë se diçka nuk është në rregull me mua. Më pyeti nëse kam ndërmend të ik? Unë nuk i dhashë përgjigje, por vetëm ia përkujtova se e dua shumë pavarësisht se çka do të ndodhë me mua. I thashë të kujdeset për Mirjetën sepse e kemi motër... Ishte hera e parë dhe e fundit që flija me të dy motrat. I përqafoja herë njëren e herë tjetren derisa i mori gjumi. Nuk doja të flija. Dëshiroja të çmallesha me to sepse nuk e dija nëse do t'i shihja më. U zgjova me to në mëngjes sepse dëshiroja ta shfrytëzoja kohën edhe pak. Pasi që të gjithë dolën nga shtëpia dhe nëna filloi t'i bënte punët e saj, unë shkova në banjë për t'u pastruar. Studioja banesën! Kisha të mbathura një palë pantofla dhe nuk e dija se në cilin dollap m'i kishte lënë nëna këpucët. Ajo nuk më linte në asnjë hap të shkoja vetëm, madje edhe kur shkonte në bodrum, derën e dhomës e mbyllte nga jashtë me çelës. Siç duket e kishte kuptuar

qëllimin tim që të ik. Më vinte vështire të ikja prej prindërve të mi por ata më detyronin që, pavarësisht dëshirës sime, ta ndërmeroja këtë hap... I mendova të gjitha variantet dhe e vetmja zgjidhje ishte që të kërceja nga dritarja. Prita derisa nëna u habit në kuzhinë duke larë enë. Dëshiroja ta përqafoja dhe ta lusja të më lente të shkoja, t'i tregoja se sa shumë e dua dhe t'i kërkoja falje për secilën herë që e kisha hidhëruar pa qëllim. E shikova dhe një herë dhe hyra në dhomë. Hipa ngadalë mbi tavolinën e mësimit të Teutës që gjendej pranë dritares, hapa njërin kanat të dritares dhe kërceva poshtë e fillova të vrapoja pa e ditur as vetë se për ku isha nisur. Këmbët më dridheshin, zemra më rrihte fort e lotët më rridhnin faqeve. Vrapoja nga njëra rrugë në tjetrën në këtë vend të panjohur derisa hasa rastësisht në një stacion policor. Hyra brenda dhe me gjysmë shpirti ua sqarova problemin që kisha. Iu tregova se ku jetoj dhe ua përshkrova se si kisha arritur këtu. Iu thashë se kam ardhur me babain por nuk iu tregova se në cilin kufi kemi hyrë edhe pse ata pikërisht për këtë interesoheshin më së shumti. Iu thashë se nuk e di sa ka zgjatur rruga ngase më kishte zënë gjumi në veturë dhe se nuk na kanë kontrolluar askund. Nuk dëshiroja ta ngarkoja babain me probleme, e nëse e marrin atë në pyetje, le të thotë ai vetë çfarë të dojë. Nuk dëshiroja që atë ta dënonin. Qëllimi im ishte vetëm të kthehesha në Gjermani.

M'i morën shenjat e gishtërinjve, më fotografuan ashtu siç bënin me kriminelët, më pyetën sa të holla kisha në xhep dhe më thanë se duhet të prisja një apo dy ditë derisa të merrnin kontakt me komunën time që t'i vërtetojnë të dhënat. Më quan në një stacion policor që ishte afër kufirit gjerman. Sa më shumë që i afrohem kufirit, aq më mirë ndihesha deri në çastin kur hymë dhe më vendosën prapë në një qeli burgu. Kjo ishte më e madhe se ajo e burgut të parë, ishte edhe shumë e pastër, kishte edhe televizor brenda. Kur e mbyllën derën e hekurit, u shtrina në shtrat dhe ia plasa vajit. Më sollën menjëherë për të ngrënë por nuk e preka ushqimin me dorë. Nuk e dija se çka do të ndodhte me mua. Këtë veprim e kisha bërë

me bindje, por megjithatë e kisha një ndjenjë ndaj familjes. Po më dhimbset edhe pse nuk më kanë kuptuar. Derisa qaja, i lutesha Zotit që të mos e dënonin babain për shkak timin. I këndova të gjitha dovët që dija...

Pas dy ditësh me të hollat e mia ma kishin blerë biletën e trenit dhe më quan në stacion dhe pritën derisa u nis treni. Meqë nuk kisha kurrfarë dokumenti me vete, policët ma dhanë një vërtetim që t'ua tregoja në rast se më kontrollonin...

XVII

Një kohë të gjatë i kam ruajtur ato pantofle të cilat ma kujtonin atë situatë aspak të këndshme. Kisha ndërruar banesën, numrin e telefonit, veturën dhe qytetin ku jetoja. Nisa të punoja nëpër restorante modeste, jo më si pastruese, por si kameriere e veshur bukur. Punoja gjatë tërë javës, vetëm një ditë e kisha të lirë dhe këtë e shfrytëzoja sa për t'i larë e hekurosur rrobat dhe për ta pastruar banesën. Jo që fitoja kushedi sa, por ishte më mirë për mua sepse puna nuk më lente që të mendohesha shumë. Nuk kontaktoja më me askënd. E vetmja gjë që më lidhte me Kosovën, ishte revista "Kosovarja". Shefi ishte i kënaqur shumë me mua, mysafirët më donin shumë dhe shpesh herë më dhuronin bakshishe. Të gjithë më shihnin si një vajzë të bukur, punëtore, inteligjente, të edukuar e të sjellshme që rrinte vetëm duke u buzëqeshur. Madje shumë herë më pyesnin se a ndodh ndonjëherë që të mrrolem?! Interesoheshin ta dinin se çka po më bënte aq të lumtur? Kur më pyesnin prej nga isha, iu tregoja të vërtetën se jam shqiptare e Kosovës, iu tregoja gjithashtu se kam prindër, vëllezër e motra. Por kur më pyesnin kur isha herën e fundit në Kosovë, më duhej t'i shmangesha pak përgjigjes duke thënë se nuk shkoj shpesh ngase familja ime jetojnë në Zvicër. Ishin kureshtarë ta dinin se pse rrija këtu e vetmuar, pse nuk isha edhe unë në Zvicër me anëtarët tjerë të familjes? Iu thosha se kisha ardhur këtu në fillim si turiste për tre muaj me bashkëshortin nga i cili pastaj jam ndarë dhe unë kam mbetur këtu sepse më ka pëlqyer ky vend ndërsa ai është kthyer në Kosovë. Më ngushtë zihesha kur më pyetnin se kur kisha qenë për herë të fundit te prindërit - përgjigjesha disi, por pyetje të tilla më pengonin. Askush nuk e dinte se isha vetë nënë, se kisha një vajzë të bukur. Askush nuk e dinte se sa shumë vuaja për të. Kurrë nuk i kisha nënçmuar prindërit e mi përpara të huajve, as që do ta bëja ndonjëherë këtë, por nuk i kam përkrahur dhe nuk do t'i përkrah asnjëherë kur tregohen fanatikë dhe të padrejtë. Sidomos nënën e respektoj shumë edhe pse shumë herë më ka ndëshkuar pa

të drejtë. E kuptoj se as ajo nuk e ka pasur të lehtë dhe shumë gjëra i ka bërë pa qëllim të keq. U bënë shumë meshkuj që më adhuronin, më ftonin në takime apo edhe në pushime me ta. Disa prej tyre ma thoshin të vërtetën se dëshironin të jetonin me mua por kishte edhe të tillë që iu interesonte vetëm të kalonin një natë me mua... Për t'iu dhënë fund këtyre, e bleva një unazë fejeje dhe e vura në gisht. Kjo ishte ide e suksesshme sepse arrija t'i largoja të gjithë. Më nuk më pyetnin përpos disave që më njihnin një kohë të gjatë dhe dyshonin për "fejesën" time pasi që kurrë nuk më kishin parë me ndonjë mashkull. Por as që mund të më shihnin, ngase punoja ag e terr gjashtë ditë në javë. Arrita ta ndërtoja një lloj sistemi të punës e të jetës. Dita më e vështirë ishte kur Merita kishte ditëlindjen. Atë ditë më dukej se edhe qielli po qante. Mendohesha ta paramendoja se si dukej. Sa herë që shihja vajza të moshës së saj mendohesha ta paramendoja se edhe ajo ishte rritur aq shumë. Më kaplonte frika dhe malli kur e llogarisja se sa kohë e kisha kaluar pa të.

Disa herë gjatë kësaj kohe më kishte ardhur vendimi për t'u kthyer në Kosovë, por secilën herë e shtyja afatin me anë të avokatit të cilit duhej t'i paguaja shumë të holla për këto shtyrje. Nevojitej që tetë vjet të punoja, të mos isha e varur nga shteti dhe të mos isha e dënuar, që ta fitoja të drejtën të bëja kërkesë për nënshtetësi gjermane. Kisha lexuar se gjendja në Kosovë kohët e fundit ishte e vështirë. Unë i kisha përjetuar demonstratat, orët policore, udhëtimin në këmbë për Prishtinë nga të gjitha anët e Kosovës... Më mbante shpresa se bota nuk do të lejonte që në Kosovë të mos përsëritej ajo që kishte ndodhur në Bosnjë. Gazetave nuk iu besoja shumë ngase shpesh herë mund të lexoja aty edhe informacione të pasakta. I kisha shkëputur të gjitha kontaktet me njerëzit nga Kosova. Kisha punuar më shumë se dy vjet për atë familje shqiptare që më kishte ndihmuar në fillim. Doja që t'ua ktheja të mirën që ma kishin bërë. Meqë e njihja punën e restoranteve, nuk mund t'iu thosha se po punoj diku tjetër e jo te ju. Punoja shumë. Punën e nisja e para dhe e përfundoja e fundit. Në mëngjes herët e pastroja lokalitë në të gjitha

anët përpara se të arrinin mysafirët, pastaj e veshja uniformën e punës dhe vazhdoja punën time sipas kontratës. Ndërsa në mbrëmje vonë pasi që shkonin të gjithë mysafirët, e përgatisja restorantin për nesër. Punoja rreth 15 deri 16 orë në ditë. Katër muajt e parë nuk më pengoi kjo gjë sepse kisha qëllim që t’iu ndihmoja dhe t’ua ktheja të mirën me të mirë. I kryeja të gjitha punët që më kërkonin edhe pse ato nuk ekzistonin në asnjë kontratë. Dikur fillova që të lodhesha. Prej së lodhuri nuk më hahej e as nuk më flihej. Puna shtohet vazhdimisht. Ata herë ma jepnin një ditë të lirë e herë një gjysmë dite, por edhe kur ma jepnin këtë ditë “të lirë” m’i caktonin 100 detyra t’i kryeja...

XVIII

Kaloi kështu më shumë se një vit dhe fillova të ngjaja në një kufomë që sapo është zgjuar nga varri. Kisha humbur shumë peshë, sytë më ishin futur në gropë. Veshja këmisha me mëngë të gjata që të mos më shiheshin krahët dhe gjoksi i bërë asht. Pronarët bënë plane të ndryshme. I blenë dy vetura të tipit të ri, për çdo ditë blinin rroba të reja dhe të shtrenjta dhe dukej qartë se kishin fitime të mira nga restoranti. Kur u ankohesha se lodhesha dhe nuk mund t'i bëja të gjitha punët vetëm, ata arsyetoheshin se nuk po iu mjaftonin të hollat se kishin shumë shpenzime e tjera. Më paguanin vetëm për orët e punës që kisha në kontratë, por jo edhe për punën që bëja jashtë orarit edhe atë pagë të vogël herë ma jepnin me kohë e herë me vonesë... Unë kisha qëllim t'iu ndihmoja, ndërsa këta paraqiteshin se nuk po më kuptonin se sa e lodhur isha dhe se nuk mund të vazhdoja më punën e dy e më shumë vetave. Këta vetëm më shfrytëzonin. Shumë kush nga mysafirët pyetnin se çka po ndodhte me mua, më thoshin se duhet të kontrollohesha te mjeku ngase mund të kisha ndonjë sëmundje të rëndë. Dhe vërtet u sëmura nga lukthi. Mjekët nuk mund ta kuptonin se si në këtë moshë kisha këtë lloj problemi. Secilën herë që shkoja në kontroll, më pyesnin në mos kisha probleme me jetën private. Unë nuk iu tregoja, ngase po t'ua thosha problemet që vërtet i kisha, do të më drejtonin menjëherë për te psikologu. M'i përshkruan disa barna, por nuk më ndihmuan asgjë. Vazhdoja të kisha probleme me lukthin derisa një ditë mjeku këmbënguli: zonjë, nëse nuk dëshiron të tregosh se çfarë probleme ke, unë e respektoj këtë gjë. Por një gjë duhet ta kesh të qartë, ju nuk keni në lukth asgjë serioze, ndërsa dhimbjet shkaktohen nga nervat. Është në dorën tuaj që ta ndryshoni këtë gjendje ngase ju e dini mirë se nga po ju vjen kjo gjë. Po ua përsëris, nëse nuk ndërmerrni diçka shumë shpejt, mund të rrezikoheni nga kanceri.

Ky mjek kishte të drejtë. Unë e dija shkaku e kësaj sëmundjeje por nuk e dija se si ta shëroja. E dija vetëm një gjë. Se nuk do ta

lejoja veten të sëmuresha për të huajt derisa në Kosovë e kam një rreze të diellit e cila është e vetmja që m'i jep kuptim jetës.

Kam filluar prapë ta lexoj Kur'anin nga i cili kërkoja një lloj ndihme për t'i kuptuar sjelljet e njerëzve. Po i mbështetëm Zotit të madh duke thënë me vete se ky është fati im dhe duhet të pajtohem me të. Vazhdoja punën dhe për pronarët e restorantit isha vetëm një skllave... Një ditë kishte ardhur në lokal një kushëri i tyre dhe më urdhëruan që unë ta shërbeja. E shërbeva si çdo mysafir tjetër. Vetëm në mbrëmje e kuptova se për çfarë arsye zgërdhihej ai si një gomar!

- Trëndafille, është djalë i urtë e i mirë. I ke pëlqyer shumë, nuk po i pengon aspak që ke qenë një herë e martuar. Ti je e re dhe nuk duhet ta kalosh jetën kështu e vetmuar, martohu me të dhe bëhesh rehat e ia fillon jetës ashtu siç i ka hije. Nuk mund ta përshkruaj me fjalë sa shumë më pengoi kjo gjë. Tani u binda se këta njerëz nuk më kishin kuptuar kurrë. Iu thashë se nuk isha e interesuar që për momentin të njoftohesha me dikë. Refuzimi im e ndryshoi sjelljen e tyre. Gjendja filloi të keqësohet. Prej se e kisha refuzuar kushëririn e tyre, ata më injoronin në çdo aspekt, madje edhe pyetjeve të mia u përgjigjeshin me nervozë. Nga lodhja dhe dhimbjet e vazhdueshme të lukthit u sëmura aq rëndë sa përfundova në shtrat. Më dhembte i tërë trupi, sytë s'mund t'i hapja dot, këmbët më dridheshin dhe me shumë vështirësi shkoja në banjë. Iu telefonova në punë, u kërkova falje, u tregova se s'mund të punoja më sepse isha shumë e sëmurë dhe se do të shkoja te mjeku sapo ta merrja veten pak. Nga zëri e dallova se nuk iu pëlqeu kjo gjë. Pasi kisha pushuar pak shkova te mjeku. Më tha se kisha temperaturë dhe se më duhej së paku një javë që të pushoja. Këshilla e mjekut ishte me vend por unë nuk mund t'i përmbahesha sepse më duhej të shkoja nesër prapë në punë, ngase isha e sigurt se ata nuk do të më besonin...

Atë natë kisha fjetur shumë mbase më kishin trullësuar edhe barnat. U zgjova nga gjumi pa e ditur se sa ishte ora. Ë vërejta se ishte bërë vonë dhe vrapova drejt telefonit. I thirra në punë dhe

u mundova t'ua shpjegoja të gjitha. U thashë se mjeku më kishte propozuar të pushoja. Pas dy ditësh më telefonuan ata, mendoja se po interesoheshin për shëndetin tim, por ata më ftuan që të shkoja njëherë deri te puna sepse kishin për të biseduar diçka me mua. Shkova të nesërmen dhe prisja me padurim se çka do të thoshin. Ma përplasën menjëherë në fytyrë, më thanë, siç po e sheh edhe vetë në vendin tënd kemi punësuar dikë tjetër... E kuptova mirë se deri ku kishte arritur puna, jo që më dhimbsej ai vend pune por kisha punuar aty shumë gjatë dhe isha mësuar me myshterinjtë. Tani më duhej të interesohesha për një vend tjetër pune. Më thanë se dokumentet m'i dërgojnë nëpërmjet postës dhe kjo ma përforcoi bindjen se ata nuk duan të më shohim më aty. Dhe nuk duan që të më vërente dikush nga mysafirët sepse kishin frikë se mos po ua tregoja të vërtetën. Prej asaj dite më kurrë nuk kam pasur kontakt me ta.

XIX

Si nuk u bë asnjëherë rehat ky shpirti im. Isha e detyruar që ashtu e sëmure të dilja e të kërkoja punë. Pa punë nuk mund të rrija shumë ngase nuk kisha shumë të kursyera. Pranoja të punoja edhe punë të rënda dhe për pak para vetëm e vetëm për të mbetur gjallë dhe të mos varesha nga ndihmat sociale. E rëndësishme ishte që të mos i jepja arsye shtetit për të më kthyer në Kosovë. Me paratë e kursyera e bleva një veturë që të mund të shkoja në punë. Kisha dhe një banesë të vogël të cilës gjithashtu duhej t'ia paguaja qiranë. Për disa vite sa kisha punuar tek ajo familja shqiptare, nuk kisha kursyer shumë ngase paga ishte e vogël. Nuk e kisha menduar se kështu do t'i vinte fundi ndarjes me ta. Dëshira ime ishte që vetëm t'ua ktheja me të mirë të mirën që ma kishin bërë...

Çdo ditë prisja postën që të mi sillte letrat e punës të cilat ishin të domosdoshme për të filluar një punë të re. Një ditë më erdhi një letër, por ishte prej Teutës! E mbaja në dorë dhe hamendesha a ta hapja a jo. M'u parafytyruan të gjitha gjërat që kishin ndodhur më herët. Mendoja se e kisha flakur të kaluarën dhe nuk duhej të ballafaqohesha më me të. Por tani që po e mbaja në dorë këtë letër më dukej se gjithçka kishte ndodhur dje. E hapa dhe nisa ta lexoja. Teuta tashmë kishte banesë të veten, ajo ishte martuar dhe nuk banonte më me prindërit. Më shkruante se ndiente keqardhje për gjithçka që kishte ndodhur.

– Trëndafile sa u gëzova që të kisha parë prapë, kur erdha në kohë të drekës në shtëpi dhe e kuptova që kishe ikur prapë, nuk mund ta marrësh me mend se sa shumë isha e pikëlluar. Një gjë duhet ta dish se kurrë nuk kam pushuar të të dua dhe të mendoj për ty. Të kam motër dhe gjithmonë do të të dua, ku do që të jesh. Do të gëzohem shumë nëse më thërret në këtë numër telefoni... Unë tash kam burrin tim i cili më përkrah, jetoj jetën time dhe nuk më intereson se çka flasin e mendojnë të tjerët. Të përshëndet me shumë mall e zemër, motra Teuta. Mbes me shpresë se do ta pranosh këtë

letër dhe do të më telefonosh. Nëse jo, të dëshiroj gjithë të mbarat dhe të mirat në jetën tënde.

P. s. mos harro se të dua shumë.

I habe eine Rose gebrochen, (zu Hause)

Ihr Dorn hat mich gestochen,

Mit Blut hab ich geschrieben,

Ich werde dich immer lieben.

Viel Glück

Wünscht

Dir Teute

Të dua shumë Trëndafile – Teuta.

Lotët ma kishin mbuluar fytyrën sikurse vesa e vjeshtës. Edhe unë ndonëse kisha humbur besimin dhe isha e mllefosur në Teutën, thellë në zemër e kam dashur gjithmonë. Kjo letër m'i trazoi plagët e vjetra, disa prej të cilave kishin filluar të mbylleshin. Por njëherësh ndiheshja krenare që motra ime nuk më kishte harruar dhe mundohej të binte prapë në kontakt me mua. Isha ende e lodhur nga sëmundja, e shqetësuar që më kishin larguar nga puna, e tash edhe kjo letër! Nuk mund të mendoja kthjellët, truri më ishte bllokuar. Vendosa të shtrihesha të flija pak dhe kur të zgjohem ta vërtetoja nëse kjo e gjitha ishte vetëm një ëndërr. Kur u zgjova të nesërmen nga gjumi u binda se gjithçka kishte ndodhur në të vërtetë. Mendja më thoshte se duhej të kisha kujdes, por zemra më thoshte t'i besoja Teutës. Disa herë e sillja numrin e saj të telefonit dhe sapo i cingëronte telefoni, unë e lëshoja dëgjuesen. Nuk kisha guxim, nuk doja të dëshpërohesha edhe një herë, doja që ta mbroja veten nga ndonjë lëndim i ri. Dikur e mora guximin. U lehtësova shumë pas telefonatës. Ishte një bisedë e lirë. Folëm për jetën e përditshme, por pa e përmendur fare të kaluarën. Teuta ma përsëriti se do të vazhdonte të më donte kudo që

të isha dhe më premtoi se do të më përkrahte në të gjitha aspektet dhe do ta respektonte çdo vendim timin. Kështu i vazhduam kontaktet, por këtë herë ishte ndryshe. I besoja por edhe isha e kujdesshme sepse nuk doja të përvëlohesha prapë. Isha e matur në çdo telefonatë që e bënim. Më shumë më telefononte ajo mua sesa unë atë. Doja ta telefonoja por më mungonin fjalët. Isha betuar se kurrë më nuk do t'ia tregoja askujt planet e mia derisa të realizohen. Shumë herë nuk dëshiroja të dëgjoja nga ajo se sa herë ka qenë te prindërit për vizitë, sa herë ishin ata te kjo e tjera. Nuk e xhelozoja por më dhembte shpirti kur më tregonte se ka qenë në ndonjë mbrëmje a ndonjë koncert ndërkohë që mua më shoqëronte vetëm vetmia dhe mërzia. Nuk do të dëshiroja që ta ngarkoja askënd me hallet e mia. Plani im ishte që të bashkohesha prapë me vajzën time që e kisha shtyllë të jetës, dhe nëse ka bërë Allahu emër do të bashkohem. Zemra më thoshte ta pyesja Teutën mos e ka parë rastësisht Meritën diku kur shkonte për pushime, meqë ajo shkonte rregullisht me burrin e saj në Kosovë, së paku dy herë në vit. Por këto pyetje nuk më dilnin nga goja. Fundja çfarë dobie kisha nëse më tregonte diçka? Vetëm sa do të më shtohet mërzia. Nuk kalon javë pa e ëndërruar së paku njëherë Meritën. Për çudi asnjëherë nuk e kam ëndërruar duke qarë. Në ëndërr më paraqitej gjithmonë ashtu siç e kam parë herën e fundit, e bukur si një engjëll. Më thërriste me atë zë të ëmbël - mami, dhe më thoshte diçka që unë nuk mund ta kuptoja. Shumë pak herë kam arritur ta përqafoja. Sa herë që i afrohesha, diçka e padukshme më shtrëngonte dhe më pengonte që të mos mund ta përqafoja atë. Shumë herë më dilte gjumi natën dhe qaja. Rrallëherë mund ta vazhdoja gjumin ndonëse dëshiroja shumë që t'i kthehesha ëndrrës. Kohët e fundit kanë nisur të ndryshojnë edhe ëndrrat. Në fillim mund t'i afrohesha Meritës, nganjëherë arrija edhe ta ledhatoja apo t'ia prekja dorën, por në momentin që doja ta përqafoja, dikush e tërhiqte atë dhe e ndante nga unë. Sa më shumë që kalonte koha, aq më vështirë e kisha që t'i afrohesha. Ëndrra më e bukur për mua ishte ajo kur ne të dyja fluturonim diku nëpër qiell pa na penguar askush, luanim me

njëra-tjetrën si dy engjëj. Në fund kur vendosnim të ktheheshim në shtëpi, unë pa dashur fluturoja në drejtim të tokës, ndërsa ajo ngrihej edhe më lart në qiell derisa fshihej në re.

XX

Fatmirësisht pas pak ditësh gjeta përsëri punë. Nuk paguhesha shumë mirë, por kryesore kisha një punë dhe fitoja sa për të mos ia shtrirë dorën dikujt tjetër. Pas një muaj arrita në përfundim se më duhej ta gjëja edhe një punë tjetër pasi që të hollat që i fitoja mezi më dilnin për ushqim deri në fund të muajit. Tash po e kuptoj mirë se sa budallaqe paskam qenë kur nuk i kam dhënë rëndësi pagesës më përpara. Secilën herë e më shumë po bindem se nuk ka drejtësi e rahmet. Punoja në dy vende pune që të mund të kurseja pak të holla. Të holla që më nevojiteshin për ta rregulluar një pasaportë dhe mundësia e parë që më jepet të shkoja në Kosovë për ta parë vajzën time. U bënë shumë vjet pa e parë dhe po më verboheshin sytë për të. Sa më shumë që po e lexoja Kur'anin, më dukej se më lehtë po mund t'i përballoja të gjitha. Shumë po më ndihmon edhe puna që nuk po më lë kohë të thellohem në mendime. Kur po kthehem vonë në shtëpi, po e ndiej se jam lodhur aq shumë sa që po më djegin edhe shputat e këmbëve...

Mediet po njoftojnë për gjendje të rëndë në Kosovë. Po flitet për formimin e një formacioni ushtarak ilegal me emrin UÇK. Kohët e fundit edhe agjencitë më të njohura të lajmeve po flasin shumë për Kosovën. Ato thonë se shqiptarët po e duan një Kosovë të lirë, duan pavarësi. Gazetat shkruajnë se shqiptarët nuk duan t'u përkulen ligjeve dhe regjimit serb. Po flitet për kontrollë të shtuara të policisë serbe dhe për burgosje të shumë shqiptarëve të cilët po i transferojnë nëpër burgje të Serbisë. Kjo gjë filloi të më shqetësonte shumë. Frika më hyri në palcë, gjendjen e krijuar mundohesha ta krahasoja me ëndrrat që po shihja për Meritën. Ajo e vetme në qiell duke fluturuar ndërsa unë e shikoja nga toka. I lutesha Zotit për çdo ditë dhe e pyesja Teutën në telefon se a janë të vërteta ato që po thuhet për gjendjen në Kosovë? Ajo më thoshte se mediet ndoshta e teprojnë pak, por gjendja vërtet është e rëndë, po flitet shumëçka. Thuhet se serbët po hyjnë nëpër shtëpi për të kërkuar armë dhe po i

torturojnë njerëzit para anëtarëve të familjes. Thuhet se në Drenicë gjendja është më e rëndë...

Vendosa që të mos e lexoja më asnjë gazetë pasi që isha shumë në depresion këto ditë. Kisha frikë se mos bëja ndonjë gabim në punë. Shumë kolegë dhe kolege e vërenin se diçka nuk ishte në rregull me mua. Ata donin ta dinin çfarë më mundonte, por unë si gjithmonë nuk ua tregoja arsyen e vërtetë. Pas disa ditësh u qetësova pak. Kur kisha kohë, në vend të revistave e lexoja Kur'anin dhe vazhdoja t'i lutesha Zotit që të ma jepte fuqinë e duhur për t'i përballuar të gjitha. Vendosa që të mos e pyesja më as Teutën rreth gjendjes në Kosovë. Nuk thonë keq 'kurrë mos të gjetë ajo çka mendon nëna, por vetëm ajo çka dëshiron nëna!'

Kaluan disa javë kur papritur m'u turbulluan shpresat. Në mediet gjermane flitej për luftën në Kosovë. Kur e dëgjova këtë m'u bë se m'u ngri gjaku në damar. Po të kisha pasaportë do të nisesha për Kosovë pa u menduar dy herë, vetëm e vetëm që ta shihja vajzën time. Doja të isha diku afër saj dhe ta dija se çka po ndodhte me të vërtetë. Isha në gjendje që ta jepja veten time vetëm për ta shpëtuar atë. Të nisesha pa dokumente, kjo nënkuptonte se nuk mund të kthehesha më. Jo që kisha frikë nga lufta apo nga vdekja, por më mundonte ajo se çfarë do të thoshin për mua kur të mos isha më. Megjithatë asgjë nuk kishte rëndësi e as kuptim pa engjëllushen time. Nuk mund ta gjëja ndonjë zgjidhje të përshtatshme dhe shpëtimin e kërkoja te shpresa. Shpresa qenka vërtetë ajo që po vdiska e fundit. Doja që mos t'i ndiqja lajmet por nuk mund të rrija pa to. Sa herë që shikoja pamje nga Kosova, më helmohej zemra. Gjendja ashpërsohej gjithnjë e më shumë, lajmet tregonin se në disa fshatra ka pasur vrasje, plagosje dhe djegie të shtëpive, popullata ka filluar t'i lëshojë shtëpitë e veta. Për herë të parë u tregova egoiste kur mendoja dhe shpresoja se në qytet nuk kishte rrezik sikur nëpër fshatra pasi që aty popullata ishte e përzier. Lufta po përhapej me shpejtësi nëpër Kosovë. Njerëzit po detyroheshin të dilnin në male. Në lajme thuhej se ishin mbyllur të gjithë kufijtë e Kosovës. Nuk ka kanal televiziv që nuk flet për

Kosovën. Gjithkund flitej për gjendje luftime. Në ekrane shiheshin shtëpi të djegur dhe të rrënuara. Shfrytëzoja çdo minutë të lirë për të shikuar lajme të cilat secilën herë bëheshin më të tmerrshme. Nuk kalonte ditë pa njoftime për njerëz të vrarë, shumica prej të cilëve ishin pleq, gra e fëmijë. Disa nga meshkujt kanë dalë për të luftuar e disa të tjerë kanë ikur për në botën e jashtme. Shumë herë më ngjante vetja në një të droguar, ngase e dija që po bëhej luftë por nuk doja ta pranoja. Nuk bëja gjumë si duhet dhe nuk ndieja më as hidhërim e as mërzi, i ngjaja një cunq. Kishte kohë që lotët ia kishin zënë vendin buzëqeshjes dhe e kishin larguar atë tërësisht nga unë. Sa e padrejtë që është treguar jeta me mua, pse nuk pata fat njëherë të jem e lumtur dhe e gëzuar? Prej se kam lindur e deri më sot vetëm kam vuajtur. Por paska edhe më keq! Në lajme kisha dëgjuar se janë hapur në Maqedoni llogoret për refugjatë nga Kosova, të cilat janë mbushur përplot. Flitej që disa atdhetarë të vërtetë po kthehen për të luftuar në Kosovë dhe kjo më interesonte shumë. Doja edhe unë të paraqitesha vullnetarisht dhe ta jepja kontributin tim, mirëpo nuk kisha kontakt me asnjë shqiptar tjetër përveçse me Teutën dhe burrin e saj. I pyeta ata nëse mund të më ndihmonin që ta gjeja vendin ku mund të paraqitesha si vullnetare. Teuta filloi menjëherë të qante dhe të më lutej që të mos e bëja një gjë të tillë. Më bënte be në tokë dhe në qiell që t'ia plotësoja këtë dëshirë e të mos shkoja. Më tha që nuk kishin kurrfarë lidhje dhe se nuk mund të më ndihmonin në këtë drejtim. Nisën të më telefononin shumë më shpesh dhe nuk e kuptoja pse e bënin këtë? Vërtet brengoseshin për mua më shumë apo donin të më kontrollonin se ku isha. Nuk ishte qëllimi im që ta shqetësoja dikë por unë thjesht dëshiroja të ndërmeroja diçka. Rrallë ndodhte ndonjë natë që të mos qaja. Nuk ishte e lehtë që të mos i gjendesha pranë fëmijës tim në këtë kohë luftime. Çdo ditë bëheshin vrasje, dhunime, masakra. Nuk ishte aspak e lehtë për mua t'i shihja nënat duke i vajtuar fëmijët e tyre, duke i parë vajzat e dhunuara nga serbët. Thuhej se në shumë raste prindërit i kanë detyruar që t'i vrisnin fëmijët e tyre. Flitej për raste kur i kanë lidhur meshkujt

dhe ua kanë dhunuar gratë e nënat përpara syve. Nuk po mund të rri pa i përcjellë lajmet, por po rri në ankth se mos po e shoh apo dëgjoj emrin e Meritës. Gjithmonë rrija me vesh në krahë. Në çastet kur më merrte gjumi shihja ëndrra të këqija të cilat më bënin që të zgjohesha, ashtu e bërë qull nga djersët dhe lotët.

E tërë bota i kishte kthyer sytë nga Kosova por ende nuk ndërmerrnin asgjë. Nuk po i kuptoja se çfarë duhej të ndodhte më për t'i bindur që të ndërhynte dikush e ta ndalte atë kiamet. Po mundohen ta zgjidhin me dialog, ndonëse e kanë parë që me serbë nuk mund të bësh dialog. Mua nuk më kishte rënë në sy e as nuk isha e vetëdijshme se kishte kohë që po vishesha vetëm në të zeza. Një ditë më pyetën koleget e punës:

- Trëndafile na ka rënë në sy që po vishesh në të zeza, a mos të është vrarë dikush nga të afërmit tu në Kosovë? Prej se ka nisur lufta në Kosovë, ti ke ndryshuar tërësisht. Na trego çfarë po ndodh me ty, ndoshta edhe mund të të ndihmojmë.

Iu thashë se nuk kam askënd në Kosovë, dhe se nuk më ishte vrarë askush, ndërsa sa u përket rrobave të zeza, iu thashë se ato i kam veshur rastësisht. Kjo e fundit për rrobat ishte e vërtetë. Ata donin të më ndihmonin por unë doja të më linin në qetësinë time. Nuk besoja se mund të më kuptonte dikush se si ndihesha në të vërtetë. Ka njerëz që jetojnë 80 e më shumë vjet dhe nuk i përjetojnë këto që unë i kisha përjetuar për këto pak vite. Nuk kërkoja nga jeta mall a pasuri, por vetëm dëshiroja që të merrnin fund dhimbjet e zemrës sime. Mos gabofsha në Kur'an shkruan se Allahu i madhërisëm ka thënë se 'kënd ta duash më shumë se Mua, Unë atë ta marrë sepse Unë jam një dhe e kam fuqinë më të madhe se çdokush tjetër'. Kur po më kujtohet kjo, po më shkon mendja se mos po bëj gabim. Unë Zotin kurrë nuk e kam harruar, por nuk mund të gënjej se atë e kam dashur më shumë se njerëzit e jetës sime...

Ditët i ngjanin njëra-tjetrës. Mërzia, malli dhe vetmia më shoqëronin në çdo hap. Nuk e kisha idenë se si t'i largoja ato. Thonë se çka t'i lypësh Zotit Ai edhe ta çon. Mua nuk më kujtohet

ndonjëherë që i jam lutur Zotit të isha e vetmuar. Unë jam lutur që të isha e pavarur por jo kështu e vetmuar, larg të gjithëve e të vuaj kaq shumë. Qysh si fëmijë kisha dëgjuar të flitej se do të vinte koha kur shejtani do të hyjë brenda njerëzve dhe më nuk do ta dallonim njërin prej tjetrit. Thoshin se kur të vijë ajo kohë, atëherë kiameti është afër. Mendoja se kishte ardhur ajo kohë. Ka ardhur një kohë kur i forti në vend se t'i ndihmojë, e shtyp të dobëtin, i pasuri nuk i ndihmon të varfrit por mundohet t'ia marrë edhe atë që e ka, thonë se secili do të përgjigjet për veprat e veta. Më herët thoshin se secili do të hyjë në varr të vet, por sot nuk është e sigurt se kush me kënd do të hyjë në varr. Prej se ka filluar lufta në Kosovë, po flitet vetëm për varreza masive, të vrarët po i varrosin ashtu siç po mundnin në grupe sa që nuk dihet se kush ku është i varrosur...

Mediet po njoftojnë se presidenti amerikan u ka dhënë ultimatium serbëve që t'i tërheqin forcat e tyre ushtarake brenda një jave. Kjo më gëzoi shumë. Deri më tani nuk e kam dëgjuar emrin e Meritës edhe pse kanë vrarë shumë njerëz në qytetin tim. Forcat serbe po tërhiqeshin dhe në tërheqje e sipër vritnin njerëz. Një ditë para se të hynin forcat e NATO-s në Kosovë, në lajme ndoqa një informacion për qytetin tim në të cilin në ditët e fundit kishte pasur më së shumti ekzekutime. Pamjet i tregonin varrezat e qytetit përplot njerëz të vrarë. M'u ndal fryma kur në mesin e të vrarëve lexova edhe emrat e fëmijëve të motrës së Halimit. Që të katërtit i kishin vrarë me gjithë nënën e tyre, ndërsa emri i babait nuk figuronte askund apo unë nuk e kam parë nga lotët që ma kishin zënë dritën e syve. Më janë dhimbsur të gjithë. Qaja edhe për njerëz që nuk i njihja, por dhimbja për dikë që e njej paska dallim nga dhimbja për ata që nuk i njej. Sa e çuditshme qenka jeta. Edhe pse nuk ndihesha mirë, edhe pse më dhimbseshin shumë ata fëmijë dhe motra e Halimit dhe për secilin këndova nga një Elham. Më duhet ta pranoj se ndihesha më lehtësuar që nuk e kisha dëgjuar emrin e vajzës sime! Të nesërmen mediet lajmëronin për hyrjen e trupave të NATO-s në Kosovë. Të gjithë ata që kishin mbetur gjallë, i madh e i vogël, kishin dalë

t'u shprehin mirëseardhje shpëtimtarëve të tyre. Mbanin pllakate të mëdha me fotografi të Bill Klintonit duke thënë se “Zoti është Një dhe Klintoni i dyti”. Disa qanin nga gëzimi që kishin shpëtuar, ndërsa të tjerët i qanin anëtarët e vvarë të familjes. Kishte të tjerë që këndonin dhe vallëzonin...

Mua më ishin përzier ndjenjat. Natyrisht që gëzohesha që kishte marrë fund lufta, por mendjen e kisha te Merita për fatin e së cilës nuk dija ende asgjë. Flitej për fëmijë që i kishin humbur prindërit, për gra që ua kishin marrë burrat dhe ua kishin djegur shtëpitë, shumica e tyre nuk i dinin se ku i kanë varret e të afërmeve. Më së vështiri e kishin ata që nuk dinin asgjë për njerëzit e tyre. Familjarët e të zhdukurve thoshin se kishin një dëshirë të vetme, që t'i gjenin të gjallë apo të vdekur, ta dinë së paku ku e kanë varrin e jo të zhiduken sikur të mos kishin ekzistuar asnjëherë. Sa herë që i telefonoja Teutës, prisja të merrja ndonjë lajm për Meritën, por ajo sikur donte t'i shmangej kësaj teme. Fillova të mos i përcillja as lajmet, nga frika se mund ta dëgjoja emrin e vajzës sime.

XXI

Iu ktheva punës dhe nisa pak ta merrja veten. Kjo zgjati disa javë. Kur kisha kohë të lirë, planifikoja se si do t'ia arrija qëllimit ta takoja Meritën, si mund të flisja me të, t'ia përkëdhelja flokët e ta përqafoja. Më duhej t'ia bëja disi që ta afroja dhe dalëngadalë të filloja t'ia tregoja të vërtetën. Ajo duhet ta dijë se është personi kryesor në jetën time, se nuk e kam harruar kurrë, se e dua shumë dhe se më ka munguar tepër shumë gjatë këtyre viteve. Po e pres me padurim atë ditë kur të bëhemi bashkë. Kur unë t'i kem 34 vjet ajo do të jetë 17 vjeçare. Nuk dua asnjë pasuri tjetër përveç saj...

Ka disa ditë që nuk po shoh më ëndrra! Njëpër medie gjermane filloi të mos përmendej më emri Kosovë. Lajme nga Kosova nuk mund të dëgjoja sepse nuk kisha antenë satelitore. Kjo mbase ishte më mirë për mua, ngase pas lajmeve sillesha si pa kokë dhe shumë herë ma tërhiqnin vërejtjen në punë. Ndonëse kisha kursyer ca të holla, ato nuk i shpenzoja për të dalë në kinema apo teatër, në muzika apo diskoteka. Plagët e zemrës sime ishin ende shumë të njoma për ta bërë një gjë të tillë. Thuhet se koha shëron plagët, por unë e kam humbur besimin. Ndoshta do të më kthehet prapë, por jo aq shpejt. Mbasi kisha kursyer mjaft të holla, vendosa që të mblidhja më shumë informata për vendlindjen time. Teuta nuk më tregonte asgjë të re. Ajo kishte bërë dy vite që nuk kishte qenë në Kosovë. Ndoshta mund të informohesha nëpërmjet internetit, por unë jo vetëm që nuk kisha kompjuter, por nuk dija as ta përdorja internetin!

Nganjëherë mendoja të shoqërohesha me ndonjë shqiptar, por kjo ide nuk më dukej e mirë sepse shqiptarët pyetjen e parë që ta bënin ishte si e ke emrin e mbiemrin, që sa kohë ke ardhur në Gjermani, me kë ke ardhur, sa fëmijë i ke, a të është mbytur kush gjatë luftës...

Po më duket vetja si një e huaj. Fillova të punoja edhe më shumë, vetëm që të mos kisha kohë të mendohesha deri në momentin që po e prisja me mall! Nganjëherë isha e bindur se çdo gjë do të bëhet

mirë, e ndonjëherë më humbnin shpresat. Jeta më dukej si një film ku të gjithë ishin kundër meje. Lehtësohesha pak kur lexoja ndonjë roman, ngase kjo më bënte ta kuptoja se kishte edhe njerëz tjerë që kishin përjetuar të tilla gjëra. U zhyta thellë në botën e librave. Nëpërmjet tyre udhëtova gjithkrah nëpër botë dhe u njoha me vende të ndryshme, kultura të ndryshme, fe të ndryshme, tradita dhe ngjyra të lëkurës së njerëzve. Mësova t'i dalloja njerëzit me sy se nga e kishin prejardhjen. Librat m'u bënë pjesë e jetës, u miqësova aq shumë me ta dhe mësova aq shumë nga ta. Nëpër fletët e tyre takohesha me njerëz të ndryshëm nga të cilët mësoja shumë. Ka ditë që gjithçka më është bërë monotone, punë-shtëpi, shtëpi-punë, lexim dhe gjumë. Nganjëherë mendoja se nuk isha normale, por s'e di si mund ta zbuloja nëse ishte e vërtetë. E kush i thotë vetes se është i çmendur?! Pasi që nuk ma ka thënë kush në punë mendoj se jam në rregull.

E kisha zbuluar një park shumë të bukur që nuk ishte fort larg banesës sime. Kjo ndodhi rastësisht një ditë kur nuk më lexohej, nuk kisha vullnet të bëja ndonjë punë në banesë, dhe nuk më linte diçka të qetë. Meqë nuk më zinte vendi vend, vendosa të dal dhe të ec rrugës pa kurrfarë orientimi. As vetë nuk e di se si kam ecur dhe kam arritur deri te ai park. Më pushuan sytë kur pashë lule të ndryshme. Pak më tej gjendej një liqe dhe njerëz të moshave të ndryshme që shëtisnin. Syri më zinte çifte të dashuruara, nëna që i kishin nxjerrë në shëtitje fëmijët e tyre të cilët vraponin, loznin e qeshnin. Kjo ma përkujtonte kohën kur shkonim e gjithë klasa në shëtitje. Më në fund gjeta edhe unë një vend ku mund të çlodhesha, ku çdo gjë dukej e lumtur dhe pa brenga. E gjeta edhe unë një stol për t'u ulur dhe për t'i kënaqur sytë në këtë bukuri të rrallë. I vështroja të gjithë. Nuk e di se sa orë kishin kaluar por u trazova kur dielli nisi të përshëndetej dhe t'ia lëshonte vendin hënës dhe yjeve. Nuk më shkohej në shtëpi. Më dukej herët për të shkuar në shtrat. Prita derisa të terrohej mirë dhe kisha vendosur ta shfletoja një revistë të cilën e kishte lënë dje në punë një mysafir shqiptar. E njoha prej së

largu që ishte shqiptar ngase i kishte vendosur bërrylat mbi tavolinë dhe revistën e kishte kthyer nga fytyra. E shërbeva pa i dhënë të kuptonte se isha shqiptare. Gjuhën e kisha mësuar shumë mirë dhe rrallëkush e dinte prejardhjen time, madje edhe disa prej kolegëve të punës mendonin se isha italiane ose franceze. Kur më pyeste dikush prej mysafirëve, ua tregoja të vërtetën. Vetëm kur më pyeste ndonjë mashkull shqiptar u thosha se nënën e kam italiane ndërsa babën gjerman dhe të gjithë më besonin pasi që italishten e flisja nga pak dhe kjo mjaftonte që të mos vazhdonin më me pyetje e fjalë. Pasi që kishte paguar mysafiri shqiptar, e kishte lënë revistën e tij mbi tavolinë. Nuk besoja se e kishte harruar por më dukej se e kishte lënë me qëllim, ngase kishte përtuar ta gjuante në vendin e caktuar. Kur e pastrova tavolinën, revistën e hodha në koshin e mbeturinave, por e mora prapë, ngase kishte kaluar kohë që nuk kisha lexuar në gjuhën shqipe. E futa në çantën time dhe kisha vendosur ta shfletoja kur të arrija në banesë...

Nisa ta shfletoja faqe për faqe duke i lexuar fillimisht vetëm titujt. Kur arrita në njërën nga faqet, sytë m'u bllokuan sikur të më kishte kapur ndonjë magnet i fortë. Këtu ishte një titull i cili jo vetëm që të binte në sy por të prekte në shpirt. Mendja më thoshte që ta lexoja në shtëpi ndërsa zemra me tërë fuqinë e saj mundohej të më detyronte që ta lexoja menjëherë. Këtë titull nuk do ta harroj derisa të jam gjallë "PLUMBAT NË KOKËN E ENGJËJVE", ishte titulli me shkronja të mëdha dhe ky shkrim bënte fjalë pikërisht për qytetin tim:

"Dalëngadalë edhe në këtë qytet po ringjallet jeta me të gjitha plagët e saja të thella. Qytetarët e këtij vendi, e kaluara e tyre e hidhur gjatë luftës i bën sot shumë më të matur. Vetëm së bashku mund ta përballojmë këtë dhimbje shpirtërore. Lugetërit tashmë kanë ikur, nuk do të shpëtojnë por do të përfundojnë gjithsesi në varrin e tyre të zi". Ky ishte nëntitulli që ma futi frikën në shpirt, diçka m'u ngulfat në fyt dhe nuk kisha guxim ta lexoja tekstin më poshtë. Në kokë fillova të bluaja mendime të ndryshme. Atëherë mendova që të mos

ia prishja qetësinë kësaj pasditeje të bukur që po e përjetoja në park pas një kohe shumë të gjatë. Nuk mund ta mbyllja e ta fusja në çantë, por as nuk doja ta lexoja. Kureshtja dhe frika shtyheshin në mes vete. Kureshtja më thoshte që ta lexoja, ndërsa frika më thoshte mos se do të lexosh diçka të keqe. Çudi unë kisha arritur shumë të këqija deri më tani dhe tash i frikohem një tregimi në një revistë! Më dukej se qëllimisht humbja kohën derisa të bie muzgu e ta kisha një arsye shtesë për të mos e lexuar. Nuk mund ta kuptoja se çka më shtyri ta merrja këtë revistë nga ai njeri i panjohur. Çka më shtyri që ta nxjerrja prapë pasi e kisha hedhur në shportë. Në një formë nisa ta urreja mysafirin shqiptar pse kishte ardhur mu aty ku punoja unë. Nuk dija nëse këto gjëra po ndodhnin rastësisht apo ky është fati. Vallë çka do të përmbajë ai tregim për qytetin tim, a është rrezik të ma thyejë zemrën me gjëra të pikëlluara? Si mos ta lexoja tregimin për vendin ku kam shkuar në shkollë, ku kam mësuar të dashuroj, në këtë vend ku jetonte Shkëlqimi që gjithmonë do të jetë pjesë e jetës sime. Nuk ishte vend i ëndrrave të mia por në këtë vend kam mësuar gëzimin dhe hidhërimin. Kam mësuar të qesh dhe të qaj, kam mësuar të ec e të vrapoj, në këtë vend kam mësuar nderin dhe respektin, ngrohtësinë dhe afërsinë, kam mësuar si të sillem dhe si të shprehem. Në këtë vend dielli i parë më ka ngrohur, shiu i parë më ka lagur, bora e parë më ka mërdhirë. Këtu mësova dallimin ndërmjet imagjinatës dhe reales, i mësova rregullat e jetës. Këtu mësova ta shqiptoj fjalën nënë, këtu më përkëdheli në fytyrë dielli për herë të parë dhe më puthi në faqe. Kah do që të shkoj, këtë qytet do ta kem vendlindje por më e rëndësishmja është se në këtë qytet gjendet engjëlli im i dashur, gjendet Merita. Vendosa ta lexoj dhe ia nisa:

Në orët e hershme të mëngjesit, më datën 9 maj të vitit 1999, forcat kriminale serbe kanë ekzekutuar tetë anëtarë të kësaj familjeje, pesë prej të cilëve nën moshën 15 vjeçare. Në këtë shtëpi tani banon Fatlumja dhe vëllai i saj i cili ditën e krimit për fat

nuk ndodhi në shtëpi. T'ia lëmë fjalën Fatlumes e cila na uroi mikpritje në shtëpi.

E diel, 9 maj.

Me gjithë rrezikun që i kanosej rrugës, Fatlumja kishte vendosur që t'i vizitonte prindërit. Një ndjenjë e pakuptimtë e shtynte ta bënte këtë. Rrugës kishte parë shumë njerëz të armatosur dhe ajo nuk e dinte se cilëve formacione u takonin, veçse e dinte se secili shante e ofendonte në mënyrën e vet. Djali i saj i vogël ishte frikësuar shumë derisa kalonin pranë njerëzve të armatosur. Në dorë mbante një çokollatë të cilën kishte vendosur ta ndante me të gjithë sapo të arrinin te gjyshi. Duke më shkuar mendimet në drejtime të ndryshme, unë e djali arritëm deri te dera e shtëpisë e cila për çudi qëndronte e hapur. (Fatlumja merr frymë thellë dhe vazhdon) pasi e gjetëm derën të hapur, nuk më bënin këmbët të hyja brenda. Djali vrapoi në dhomën e fëmijëve dhe pas pak doli... Kishte krejt një pamje tjetër, sikur e ndiqte diçka e tmerrshme nga prapa pastaj belbëzoi: mami Merita... dhe ia plasi të qarit. Këtu Fatlumja e humb forcën e shpirtit të saj të fortë. Në kujtesën e saj tani rishfaqet një skenë tmerrri dhe dhimbjeje. Së pari iu afrova tre djemve. Më i madhi gjendet në mes të vëllezërve dhe sikur donte t'i mbronte ata. Ai e kishte gjoksin e skuqur me gjak, një vrimë kishte në kokë dhe dy të tjera në anën e djathtë të kraharorit. Afër tij kishin rënë dy vëllezërit më të vegjël me sy të mbyllur. Të dy kishin nga dy vrima në gjoks dhe nga një prapa kokës. Kurse Arieta dhe Merita ishin në pjesën tjetër të dhomës, afër-njëra tjetrës, thuajse flinin. Të dyja kishin nga dy plumba në trup dhe nga një në kokë. Prindërit dhe motra ishin në një dhomë tjetër dhe kishin përjetuar të njëjtin fat si fëmijët. Ky ishte vetëm një rrëfim për krimin e që fatkeqësisht nuk është i vetmi në tokën tonë.

Përnjëherë më kapluan djersë të ftohta. U shtanga në vend, mundohesha ta merrja veten me të mirë duke thënë se kjo ishte vetëm një rastësi, dhe sikur doja të bindesha se kjo nuk mund të

ishte e vërtetë, vazhdova ta shfletoja revistën në faqen tjetër ku gjendeshin pesë fotografi që ilustronin tregimin e sapolexuar. Humba kontrollin mbi emocionet, mbi ndjenjat, mbi lotët. I humba të gjitha shpresat. Kam qarë shumë herë por këtë herë ishte ndryshe, kam ndier dhimbje shumë herë por ato nuk krahasoheshin me këtë dhimbje që ndiej tani. Nuk mund të rrija më ulur dhe instinktivisht u nisa drejt banesës. E shihja se po më shikonin të gjithë me habi por kjo nuk më bënte përshtypje aspak...

Padyshim këta ishin fëmijët e motrës së Halimit. Dy të mëdhenjtë i njoha menjëherë. Fotografia e fundit ishte e Meritës. Dukej si një engjëll, sytë i ndriçonin si të xixëllonjës dhe kishte një buzëqeshje të ngrohtë si nëpër përralla. Gojë të ëmbël e të vogël si llokumi, flokë të zeza e të gjata. Të gjithëve ua kishin shënuar nën fotografi emrin dhe mbiemrin dhe në kllapa emrin e babës, datën e lindjes dhe të ekzekutimit, ndërsa nën fotografinë e Meritës gjendej vetëm emri dhe mbiemri i saj dhe në kllapa emri i Halimit, pa datë të lindjes dhe të ekzekutimit. Nuk e njoha nga pamja e parë Meritën, ngase kishte kaluar një kohë e gjatë, por tashmë ishte e qartë se ishte ajo me të vërtetë. Duke ecur për në shtëpi nuk e di sa herë e kam shikuar atë fotografi me shpresën se e kisha lexuar emrin gabim, por për fat të keq kjo nuk ndryshonte edhe sikur ta shikoja 1000 herë. E mallkova jetën, e mallkova veten, e mallkova çdo gjë dhe çdo njëri. Më dukej se më tërhiqte toka nën këmbë. Sapo hyra në banesë mbylla derën mbrapa dhe u ula në tokë. Fillova të qaja me zë e t'i drejtohesha Zotit: pse o Zoti i madh as Ti nuk pate mëshirë për mua? Pse ma more Meritën? Pse në këtë mënyrë... Vijonin pyetjet njëra pas tjetrës të cilat ia parashtroja Zotit, jetës, fatit. Shkova deri te telefoni dhe e thirra Teutën. Fillova ta qortoja pse nuk më kishte treguar se e kishin ekzekutuar edhe Meritën. Teuta mundohej të më qetësonte duke u arsyetuar se nuk e kishte ditur. I vërsulesha me fjalë dhe pyetje pa ndërprerë sikur ajo të ishte përgjegjëse për të gjitha. Dikur edhe ajo filloi të qajë. Ia mbylla telefonin duke i thënë se të gjithë janë gënjeshtarë. U bëra si e hipnotizuar, lotët nuk ndaleshin, por këtë

herë dëshiroja që të mos ndaleshin sepse edhe Merita kushedi sa here dhe sa shumë ka qarë. Dëshiroja të ndodhte ndonjë katastrofë natyrore që të hapet toka e të na përpinte të gjithëve! Nuk kisha më për kë të jetoja, për kë të mundohesha, për kë të ekzistoj. Jeta nuk kishte për mua më kurrfarë kuptimi pa Meritën time që ishte krijesa e vetme që e desha, e pata dhe e humba. Nuk e dalloja më ditën prej natës. U mbylla në banesë dhe nuk më interesonte më për asgjë. Le të ndodhte çfarë të ndodhë, për mua ishte krejt njëjtë. Qava tërë ditën, tërë mbrëmjen dhe tërë natën. Më përsëriteshin pa ndërprerë në kokë rreshtat që i kisha lexuar. E mallkova babain që nuk më ka marrë edhe mua me kohë në Zvicër, i mallkova të gjithë ata që më kane prurë deri në këtë gjendje, mallkova veten pse e kisha lënë Meritën te Halimi. Dyshoja se nuk isha përpjekur sa duhet për ta marrë atë. Si nuk paskam pasur fat unë e shkreta. Habitem si kam arritur t'u përballoj të gjitha këtyre përjetimeve. Mallkuar qoftë ajo ditë në të cilën linda dhe u bëra pjesë e kësaj bote mashtruese. Çfarë kuptimi ka më jeta për mua? U linda dhe u rrita pa babë, ndërsa nënën nuk e kanë lënë dertet e veta që ta përjetoj siç i përjetonin fëmijët tjerë nënat e tyre. Më ndanë nga Shkëlqimi dhe shkolla. Vëllai i madh, në vend që të ishte shembull për mua, më ka traumatizuar qysh në vitet e hershme të fëmijërisë, njëjtë kishte ndodhur edhe me djalin e hallës për veprimet e të cilit ndaj meje nuk guxoja t'i tregoja askujt. Në vazhdim, pikërisht këta të dy që ishin shoqëruar me Halimin, më hedhën në gojë të ujkut. Pa e ditur të vërtetën më përjashtuan nga familja dhe më akuzuan për vepra të cilat nuk i kisha bërë. Më dhunuan, më rrahën, më ofenduan derisa më erdhi shpirti në fyt dhe vendosa t'i jepja fund jetës. Por ndoshta për të vuajtur edhe më shumë mbeta e gjallë! Më në fund vendosa që t'iu jepja fund të gjithave duke u munduar që të mos bëhesha unë shkak për ndonjë bela, që të mos bëheshin gjaqe, dhe me shpresë se do të vinte ajo ditë kur kurrë më nuk do të ndahesha nga vajza ime.

Tashmë e humba edhe atë dhe për mua kurrë më nuk do të këndojnë zogjtë por vetëm kukuvajkat. Më duket se më ka harruar

edhe Zoti. Nuk e di sa ditë kishin kaluar pa dalë fare nga banesa. Më nuk i dalloja ditën dhe natën, kur binte shi e kur ngrohte dielli. Në zemrën time mbretëronte furtuna dhe acari. Telefoni cingëronte pandërprerë dhe nuk i përgjigjesha. E dija që është dashur që së paku t'i lajmëroja në punë se nuk do të shkoja por këtë herë nuk më interesonte asgjë. Le të më përjashtonin menjëherë po të duan. Le të më harrojë edhe Teuta sikur që më kanë harruar të gjithë të tjerët.

Më në fund vendosa ta hapja telefonin. Ishin ata të punës. Nisen me një zë të vrazhdë duke më qortuar pse nuk kisha telefonuar. Më thanë gjithçka që iu erdhi nëpër gojë e prita derisa i të gjitha fjalët ai farë parapunëtori.

Fola vetëm një fjalë: më përjashtoni menjëherë nëse doni, vetëm më lini të qetë. Ai me një zë krejt tjetër, më të zbutur dëshironte ta vazhdonte bisedën. Ia përsërita edhe një herë të njëjtat fjalë dhe e lëshova dëgjuesen. Njërin e hoqa qafe, tashmë më mbetet vetëm edhe Teuta, e atëherë nuk më pengon kush. Pasi që t'i mbyll sytë përgjithmonë, nuk më intereson se çka do të ndodhë me mua. Le të më djegin po të duan, le të më gjuajnë në ujë që të bëhem ushqim për peshqit, le të më hedhin në ndonjë mal e të bëhem ushqim për egërsirat. Pak është e rëndësishme se si do të më tretet trupi pasi që nuk ka pasur rëndësi si më është tretur shpirti. Teutën e thirra vetë pa llogaritur se me sjelljen time ndoshta po e lëndoja. I thashë shkurt dhe qartë, më fal motër që nuk kam dashur ta hap telefonin, por kjo nuk ka të bëjë me ty. Deshi të më thoshte diçka por ia ndërpreva fjalën duke iu falënderuar për të gjitha dhe i dëshirova fat e lumturi në jetë. Mbylla telefonin që të mos më shqetësonin më. Nuk mund t'ia ndaja sytë fotografisë së Meritës që e kisha shkëputur nga revista. Asgjë nuk më kishte mbetur tjetër nga ajo përveç tregimit në revistë, kësaj fotografie dhe shenjave të shtatzënësisë në pjesë të ndryshme të trupit. Tashmë kisha vetëm një dëshirë të fundit, që sa më shpejt të shkoja te Merita.

Që nga ajo ditë nuk kam dalë më nga banesa. Nuk haja, nuk pija, trupi kishte nisur të më lodhej, nuk mund të përqendrohesha dhe të

orientohesha. Kisha filluar të përgatitesha për të shkuar rrugës që më bashkon njëherë e përgjithmonë me vajzën time të dashur. Tash po e kuptoja pse nuk e kisha ëndërruar që shumë kohë, qysh prej asaj ëndrre të fundit kur na ndau dikush... I premtoja që nuk e lë vetëm dhe se do të shkoj tek ajo sa më shpejt. Gjumi i fundit po afrohet dhe po e pres me padurim. Mbylla sytë dhe së bashku me gjumin u nisa në rrugën e pakthim. Më bëhej se notoja nëpër ujë të turbullt. E kërkoja Meritën por vetëm dëgjoja zëra të ndryshëm. Nuk e dija se ku gjendesha por kërkoja nga ta që të më tregonin se ku e kisha vajzën... U zhyta në gjumë të thellë... Ndonjëherë dëgjoja vetëm zëra e nganjëherë më bëhej se po shihja fytyra. Gjithçka më dukej turbull. Doja të zgjohesha por nuk kisha fuqi. Doja të flisja por nuk më dilyn fjalët nga goja... Gjatë tërë kohës isha e sigurt se kisha ndërruar jetë, se kisha kaluar në botën tjetër dhe me padurim prisja ta gjeja Meritën deri në momentin kur dëgjoja dhe dallova zërin e Teutës. Fillova ta pyesja veten se çka po kërkonte Teuta këtu? Doja që të më linte të qetë së paku këtë herë, të mos përziheshin në planet e mia. Sa herë jam lutur që të ma marrë Zoti shpirtin. Jam munduar edhe vetë t'i jepja fund jetës, por mbeta prapë e gjallë. Kur'ani thotë se pa të ardhur koha nuk do të shkosh nga kjo botë, pavarësisht se çka përjeton. Në këtë gjë fillova të besoj tani.

XXII

Në spital më mbanin nën përkujdesje të plotë. E urreja atë që nuk më la të më plotësohet së paku dëshira e fundit. Më rrinin mbi kokë derisa e haja ushqimin dhe i përpija barërat, pas të cilave më merrte gjumi. Natën m' i lidhnin duart për shtrati sikur të isha ndonjë e çmendur. Nuk e di sa kohë kishte kaluar që isha aty, nuk e di kush ka hyrë në banesën time të më marrë, nuk e kam dëgjuar askënd. Mbase për një kohë të shkurtër edhe kam qenë në botën tjetër! Ta kisha parë së paku njëherë Meritën e ta pyesja se si ka ndodhur. Të më tregonte se si ishte jeta e saj pa mua. Ta pyesja se a i kanë treguar se kë e ka nënë, a dinte diçka për mua, a janë kujdesur për të, a i kam munguar, mos e kanë përqeshur fëmijët tjerë? Pyetja më e rëndësishme që nuk do të ma lë kurrë shpirtin e qetë ishte se a është frikësuar shumë kur e kanë rrëmbyer katilët serbë, ku do të ketë qenë në atë kohë? Kë e kanë vrarë së pari? Çfarë ka përjetuar derisa i ka ardhur radha asaj? Ku e ka goditur plumbi i parë? Sa i është munduar ajo zemër e njomë derisa ka pushuar së rrahuri? A i ka mbyllur sytë apo ka dhënë shpirt me sy të hapur?... të gjitha këto pyetje por edhe shumë të tjera do të mbesin pa përgjigje. Sikur ta dinin këta njerëz se sa shumë vuaja, në të vërtetë nuk do të më kishin munduar edhe më shumë dhe nuk do të më kthenin prapë në jetë, në këtë jetë e cila nuk ka më kurrfarë kuptimi për mua.

Para se të më lironin nga spitali më kanë udhëzuar të shkoja në një vend tjetër i cili, sipas tyre, ishte i domosdoshëm për mua. Ky vend nuk kishte dallim të madh prej spitalit, vetëm se këtu nuk mund ta dalloja në fillim se cili është mjeku, cili psikologu e cili psikiatri. O Zoti i madh, tash kam përfunduar te spitali i të çmendurve. Nuk mund ta kuptoja pse po më konsideronin të sëmurë vetëm pse nuk kisha vullnet për jetë. Po më jepnin barna për qetësim pandërprerë. Ky vend qenka spital i psikiatrisë, me dyer dhe dritare të hekurta. Çdo lëvizje vëzhgohej me anë të kamerave. Nuk bisedoja me askënd, barërat që m' i jepnin më shndërronin në tjetër njëri. Doja

të flisja ndonjëherë por më mungonin fjalët. Doja të qaja por as lot më nuk kisha, me duket se dhe ata e kanë humbur rrugën e vet, isha bërë si një cung. Përjetoja gjëra që nuk i kisha përjetuar kurrë më parë. Aty kishte njerëz të moshave të ndryshme nga të dy gjinitë. Qeshnin lidhje pa lidhje. Disave iu kishin vendosur pampersa që të mos e kryenin nevojën vend e pa vend. Për herë të parë mësova se kishte pampersa edhe për të rritur. Një grua e moshës mesatare rrinte gjithmonë e zhveshur në pjesën e epërme të trupit, ishte e gërditshme ta shihje një grua me gjinj të mëdhenj e të varur deri në kërthizë por edhe më e keqe ishte pamja kur ajo përkulej dhe dukej si një lopë vetëm me dy cica! Disa i ushqenin, të tjerët që mund të hanin vetë, i pritnin derisa të ngopen sepse ndodhte që shumë herë të gjuheshin apo pështyheshin në mes vete. As netët nuk ishin të qeta. Shumë herë nuk mund të flija dhe shëtisja nëpër korridor. Çka nuk më shihnin sytë e nuk më dëgjonin veshët. Disa gërhitnin, të tjerë qanin, disa të tjerë bërtisnin. Kishte edhe të tjerë që qeshnin por edhe të tillë që bënin marrëdhënie seksuale dhe lëshonin britma si kafshë...

O Zot, me çka nuk më provoi kjo jetë e imja. Psikologja për çdo ditë bisedonte me mua, herë më gjatë e herë më shkurt. Ndodhte që bisedonte edhe nga dy-tri herë në ditë dhe kjo gjë më bënte edhe më të pasigurt sepse nuk mund ta dalloja a e ka këtë për detyrë apo gjendesha në gjendje jostabile. Nuk kisha menduar ndonjëherë se do të përfundoja në psikiatri. Për herë të parë në jetën time më shpjegohej që nuk isha unë fajtorë për gjërat që kanë ndodhur dhe se jetës nuk i dihet se çka sjell me vete. Pa dyshim që nuk ishte e lehtë të konfrontohesha me situata të tilla që ta lëndojnë shpirtin e ta thyejnë zemrën. Përkujdesja ndaj meje ishte e nivelit të lartë. Psikologët më thoshin se kjo është një përkujdesje normale e jo e posaçme siç mendoja unë. Nuk di si ta kuptoj atëherë, si ta përshkruaj tërë gjendjen e deritanishme. Kam arritur në atë shkallë që i ngjan kohës së parashkollimit. Kur fillojmë të shprehemi, fillojmë t'i bëjmë dallimet, t'i mësojmë ngjyrat, të mësojmë të jemi të sigurt, të

trimërohem i jo t'i lëmë përparësi frikës. Po më mësojnë që të mos i respektoj nëse nuk jam e respektuar, që të mos jap më shumë sesa duhet dhe sesa kam, por gjithashtu që të them po por edhe jo nëse nuk më konvenon. Po ashtu, sipas tyre, është shumë me rëndësi të kuptoja që nuk isha përgjegjëse. Të gjitha këto gjëra ndoshta duket se tingëllojnë të thjeshta dhe qesharake por për mua është shumë e rëndësishme t'i shndërroja në vepra. Është e vështirë ta kuptosh nëse nuk e përjeton vetë, sepse këto gjëra e kanë për detyrë të na i mësojnë prindërit apo të afërmit, e jo t'i mësojmë nga të huajt si unë në moshë të rritur. Gënjej nëse them se asgjë nuk paskam mësuar para se të vija këtu, por e vërteta është se më paskan munguar gjërat më elementare të cilat mungojnë pa masë në rrugën e jetës. Fakt është se rruga e jetës sime ishte shumë më e vështirë sesa që është dashur të ishte. Nganjëherë bota po më duket si një laborator i madh ku me disa njerëz, ndër të tjerët edhe unë, bëhen eksperimente të ndryshme.

Para disa ditësh kam dashur t'i jepja fund jetës. Për herë të dytë doja ta përfundoja jetën me gjithë dëshirë, ndërsa sot po mundohem t'i kuptoj gjërat. Nuk e di se kush ka ndikuar, barnat apo psikologët? Nuk po mund ta kuptoj se sa poshtë paskam rënë. Nuk e di se sa kohë më duhet të rri këtu? Po më thonë derisa të shërohem plotësisht. Të shërohem edhe pse nuk kisha plagë që shiheshim me sy! Këta i thonë shërim momentit që unë mësohem t'i përballoj situatat e ndryshme dhe arrij ta përpunoj të kaluarën time prej fëmijërisë e deri më tash. Në secilën pjesë të tregimit mbi jetën time, shumë herë më duhej të bëja nga një pauzë ngase më dukej se po më bllokoheshin truri, zemra dhe goja. Shumë herë, pa dashje, më rridhnin lotët dhe më vinte inat që nuk arrija t'i kontrolloja ndjenjat e mia. Nganjëherë më kaplonte malli e nganjëherë mërzia. Nganjëherë më vinin e nganjëherë më humbnin shpresat, nganjëherë qaja e nganjëherë qeshja. Me një fjalë mbretëronte një kaos i ndjenjave, gjë që shumë herë më shtynte të bëhesha agresive apo depresive. Kisha kaluar shumë sprovë dhe më kishte ngelur vetëm edhe një, që të bëhem

mashkull dhe të shkoja ushtar! Po më thonë se jam femër e zgjuar dhe inteligjente. Po të isha e tillë, nuk do të isha këtu në mesin e të çmendurve dhe në mbikëqyrjen e psikiatërve dhe barërave që duhet t'i marr rregullisht. Më thoshin që gjendja ime gradualisht po shkon duke u përmirësuar por njëkohësisht ma bënin të qartë se është një procedurë e gjatë përpunimin i të gjitha përjetimeve që nga fëmijëria. Më me dëshirë do t'i kisha fshirë shumicën e këtyre përjetimeve sikur të mos kishin ekzistuar fare, por për fat të keq një gjë e tillë nuk është e mundur. Kohën e kaloja duke i kryer detyrat që më parashtroheshin, si gjimnastikë, punë të ndryshme sipas dëshirës sime... Ishte shumë e rëndësishme të merrja pjesë në grupe të ndryshme ku secili e tregonte arsyeën pse gjendej këtu. Nuk i vinte asnjërit lehtë të tregonte për jetën e vet para të tjerëve, por kjo ishte një nga metodat më të suksesshme që të mësohesh mos t'i mbash gjërat për vete dhe të mos kesh frikë për asgjë. Këtu mësohesha se si të sillmë së pari ndaj vetvetes, ndaj trupit tim, ndaj ndjenjave të mia, gjë që nuk e kisha bërë kurrë më parë. Sa më shumë që arrija të tregoja për jetën time, aq më e lirë ndihesha. Më mësonin që të mos synoja më në vetëvrasje. Duhet të paramendoja që diku ka njerëz që më duan dhe unë nuk bën t'ua lëndoja zemrat atyre. Më treguan se Teuta shpesh po thërriste në telefon dhe po interesohej për gjendjen time, dhe se me padurim po e priste çastin kur do të vinte dita që të më shihte e përqafohte. Shpesh herë isha bërë nervoze pse nuk më ka vizituar, derisa e kam kuptuar se çdo kontakt ishte rreptësisht i ndaluar derisa gjendesha nën terapi. Çastet më të vështira për mua ishin kur duhej të flisja për Meritën. Ditët e para më dilnin vetëm lotët nga sytë, ndërsa fjalët më humbnin. Por, me kalimin e kohës dhe me durim filluan të më ktheheshin fjalët, ndonëse nën praninë e lotëve. Rrëfimi niste prej momentit të mbetjes shtatzënë e deri në atë ditë të mallkuar kur e kisha lexuar revistën. Më dukej që po e përjetoja prapë atë kohë të vështirë që i ka dhënë domethënie tjetër jetës sime. Mbase mund të ndodh në jetën time ndonjë mrekulli por më vjen vështirë ta besoj derisa nuk e përjetoj. Jam ndarë nga Merita

në një ceremoni tërësisht të ndryshme nga ajo tradicionalja. Në një ceremoni shumë të thjeshtë, me disa lule të majit dhe një qiri të ndezur në dhomën time. Për herë të parë që nuk përpiquesha t'i kontrolloja ndjenjat duke e shikuar fotografinë e vetme që kisha, ndërsa lotët më rridhnin rrëke. E utha, e ledhatova atë fotografi që e kisha prerë dhe e kisha vendosur në një amulete, ku do ta mbaj në qafë derisa të jetë jeta. I kërkova falje që isha aq e re dhe kam pasur frikë ndoshta më shumë se që është dashur. U mundova t'ia shpjegoja të gjitha me radhë, siç e kisha planifikuar t'ia tregoja kur të takohemi prapë një ditë. E luta që kurrë të mos jetë e pikëlluar sepse ajo është një engjëll, e engjëjt meritojnë të jenë të lirë dhe të gëzuar. I premtova që kurrë nuk do t'ia zë vendin askush asaj në zemrën time. Duhet ta kishte të qartë engjëlli im se është i pazëvendësueshëm. I thashë që zemra ime i takon vetëm asaj dhe kurrë të mos frikësohet se do të bëhem nënë vetëm për dikë tjetër. Ma bën hallall shpirti im i vogël. Po mbes me shpresë që të takohemi një ditë. Vendosa amuletin në qafë dhe nuk do ta heq nga aty me asnjë kusht.

Gjërat që i kam mësuar në këtë klinikë ishin një shkollë e paguar shumë shtrenjtë. Sa kam mësuar këtu për disa javë, nuk kam mësuar gjatë gjithë jetës sime. Pas pak ditësh do të lirohem nga klinika, por më duhej të shkoj rregullisht në psikoterapi. Përgatitesha për ta filluar një jetë të re. Do t'i largoj të gjitha gjërat, t'i ndërroj të gjitha vendet dhe, nëse ka nevojë, do ta ndërroj edhe identitetin, vetëm e vetëm që të mos kthehem në të kaluarën. Kisha mësuar se nuk mund të ecja para, po të shikoja mbrapa.

XXIII

Për fat të mirë gjeta punë në një restorant italian ku njëherësh edhe mund të banoja. Kisha një dhomë mesatare me banjë, më shumë për këtë fillim as që më duhej. Ma mundësuan që ta përdor edhe rrobalarësen e tyre që ishte në bodrum, ku kishte edhe makinë për tharjen e rrobave. Për herë të parë mësoja se ekzistonte një makinë e tillë. Kjo gjë më lehtësonte jetën shumë, ngase nuk doja të banoja më në vendin që m' i përkujtonte vetëm gjërat negative dhe më bënte të ndihesha e pikëlluar. Shkova edhe në restorantin ku kisha punuar më parë, ndonëse më vinte vështirë ta shihja tavolinën ku ishte ulur ai mysafiri shqiptar dhe e kishte lënë atë revistën e cila u bë shkak që unë të përfundoja në psikiatri. Por i thashë vetës, Trëndafille bëhu e fortë, bëhu burrneshë dhe hyr brenda. Për fat timin shefi ishte aty dhe m' u duk pak i habitur kur më pa. Më përshëndeti ngrohtë dhe me dashamirësi. I kërkova falje për sjelljen time jokorrekte ndaj tij, ndaj kolegëve dhe vendit të punës. Ma ndërpreu fjalën me një përqaftim duke më thënë se i vinte shumë keq për atë që më kishte ndodhur. Por koha i shëron plagët, ndoshta jo të gjitha, por e rëndësishme është se unë jam më mirë dhe di si të sillem ndaj vetvetes, ndaj plagëve të shpirtit derisa ato të shërohen. Më tha që për mua dera e tij është gjithmonë e hapur dhe se do të jam e mirëseardhur në çdo kohë, qoftë si mysafire qoftë për të punuar. U ndjeva e lehtësuar nga fjalët e tij të ngrohta dhe më përshkoi një ndjenjë e mirë. Nga banesa i mora vetëm gjërat personale, ndërsa të tjerat i lashë aty. Disa prej tyre i bleu qiraxhiu që do të banonte aty, disa ia fala, ndërsa pjesën tjetër i vendosa në kontejnerë të Kryqit të Kuq. E shita edhe veturën pasi që nuk më duhej më, por edhe sepse i takonte të kaluarës e cila nuk duhej të kishte vend më në jetën time. Me Teutën fillova prapë të dëgjohesha në telefon, ndonëse në fillim më mungonin fjalët, nuk dija as çfarë ta pyesja e as çfarë t' i tregoja. Teuta arriti prapë të rikthehet në zemrën time, aty ku edhe e ka vendin. Fat i madh dhe pasuri e madhe është që të kesh një motër si kjo e imja. Ia dhashë

fjalën që të mos brengosej se nuk do ta përsërisja prapë një vepër të tillë. Kisha një problem të madh por isha e bindur se me ndihmën e Zotit do ta zgjidh edhe këtë. Shkova një ditë te avokatja ime dhe ia shpjegova të gjitha që kishin ndodhur ndër kohë. Ia bëra të qartë se më nuk e kisha ndërmend të kthehesha në Kosovë, qoftë edhe nëse duhej ta shëtisja tërë botën derisa ta gjeja një vend për mua.

- Trëndafile, nuk do ta kemi lehtë, por unë dhe ti jemi një ekip shumë i fortë dhe do ta gjejmë një rrugëdalje për këtë punë. Vetëm me një kusht që kurrë të mos tentosh ta bësh ndonjë vepër budallaqeje. Këtë plan nuk bën ta dijë askush përveç meje, teje dhe Zotit! A u kuptuam?!

Që nga këtu jeta ime mori kahe tjetër. Pas një kohe Teuta me dhëndrin ma mbushën mendjen edhe një herë që të kontaktoja me prindërit duke qenë të mendimit se këtë herë prindërit do të gëzoheshin për telefonatën time. Edhe pse më vinte shumë vështirë, vendosa ta kryeja obligimin tim që kisha ndaj prindërve, por edhe t'ia plotësoja dëshirën motrës sime të dashur. Dëshiroja t'ia dëshmoja asaj me vepër se vërtet e doja shumë. Ma dha numrin e telefonit të prindërve dhe e caktuam kohën që t'i thërrisja në çastin që gjendeshin aty për vizitë (gjoja rastësisht). Dy herë formova numrin dhe e ndërpreva lidhjen. Vetëm herën e tretë, pasi mora frymë thellë, ua cingërova telefonin dhe prisja.

- Urdhëroni, - dëgjohej zëri i Adrianit nga ana tjetër e telefonit.

- Mirëdita, Trëndafilja këtu... Ende pa filluar bisedë me të, nisi të më pyeste pse kisha telefonuar.

- A ka mundësi të flas me babin në telefon, ia ktheva me zë të ftohtë. Pas pak u dëgjua zëri i babait.

- Mirëdita babi, Trëndafilja këtu... Edhe ky ma ndërpreu fjalën njëjtë si Adriani: Çka po kërkon ti këtu?

- Mos u friko babi, nuk po kërkoj asgjë nga ju, desha vetëm të telefonoja e të bisedoja me ty, por më duket se kjo gjë po të pengon. Më falni për pengesën, iu dëshiroj të gjithëve një ditë të mirë, dhe e mbylla telefonin. Derisa flisja, isha e shqetësuar por e kontrolloja

veten. Ndonëse nuk kisha ndjenja të mira, u pikëllova që nuk deshën të dinin fare për mua, por njëherësh edhe u lehtësova që e bëra hapin e parë. Tash e tutje ata janë vetë përgjegjës dhe nëse mund të pajtohen me ndërgjegjen e tyre që të mos më respektojnë si fëmijë të tyre, atëherë gjithçka është në rregull, edhe pse për mua kjo nuk do të jetë gjithmonë e lehtë.

Pa kaluar as gjysmë ore më thirri Teuta e cila ishte e shqetësuar pa masë. Më fal Trëndafilë, nuk e kam menduar se do të sillen ashtu ndaj teje. Të lutem mos u pikëllo, në e kemi njëra-tjetrën. Kam menduar se babait i kanë ardhur mendtë, por më paskan tradhtuar ndjenjat e mia...

Nuk isha gjitha q e pikëlluar sepse në një mënyre isha e përgatitur se do të ndodhte kështu. Të gjitha gjërat që më mundonin apo nuk i kuptoja, i bisedoja me psikologun time e cila më ndihmonte shumë që t'i kuptoja sjelljet e njerëzve. Teutës nuk iu hidhërova sepse e dija që është munduar të bënte mirë. Nuk jam e hidhëruar as me prindërit e mi sepse, sipas mendimit tim, ata kurrë nuk kanë mësuar që bëhet edhe ndryshe. Atyre iu mungon edukimi dhe shkollimi, andaj nuk mund t'i urrej për këto veprime. I kam prindër, të mirë apo të këqij, ata janë të mitë dhe nuk tjetërsohen. E kam kuptuar që nuk mund ta zgjedhim kë ta kemi prind.

Teuta më informonte për gjërat kryesore që ndodhnin në familje, dhe në një mënyrë indirekte edhe unë isha bërë pjesë e familjes. Ka raste kur më pyet dikush për familjen, dhe unë nuk i mohoj ata, u tregoj se sa vëllezër e motra kam, u tregoj se i kam dy prindërit që jetojnë në Zvicër, por nuk i tregoj gjithkujt se nuk isha në kontakt me ta.

NË VEND TË EPILOGUT

Sa e çuditshme qenka jeta, përplot me befasi! Një mysafire e rregullt gjermane, zonja Wuher Edith, e cila e dinte që jam nga Kosova, më kishte sjellë një revistë gjermane për ta lexuar. Donte ta dinte nga unë se a ishin të vërteta gjërat e shkruara në atë tregim. U mundova t'ia shpjegoja me fjalë të zgjedhura që disa gjëra janë të vërteta, por në asnjë mënyrë nuk doja që ta përqeshja popullin, kulturën e fenë time. I thashë që, sipas mendimit tim, disa gjëra gjithmonë kanë ekzistuar dhe do të ekzistojnë, për fat të keq. Kjo rastësi më bëri të qartë që edhe pas shumë viteve disa gjëra ende nuk paskan ndryshuar. Po befasohem që as lufta nuk ka ndikuar që të ndryshojnë sjelljet e njerëzve. Ndoshta nuk e kanë pasur keq të mençurit që kanë thënë se 'pa u bë kiameti që të pastrohet kjo dynja, e të nisë gjithçka nga fillimi, rehati nuk ka'. Ju gënjej nëse them se i kam harruar të gjitha dhe jam e lumtur, por gjithashtu ju gënjej nëse ju them që jam e pakënaqur. E kam gjetur rrugën e jetës sime dhe e bëj një jetë të qetë. Nuk besoj se jam bërë fetare më e madhe sesa që kam qenë deri më tani, por fati i jetës sime e ka vërtetuar se vetëm Zoti është një dhe Ai të merr dhe të jep kur të dojë dhe çfarë të dojë vetë. Por edhe jam shumë e bindur që i gjithë njerëzimi do ta

vërtetojë këtë gjë. Nuk ishte e lehtë që të arrija këtu ku jam sot. Më është mundësuar që të kem të drejtë të jetoj në mënyrë të rregullt në Gjermani, gjë që ka shumë rëndësi për mua. Vendlindje e kam Kosovën, por këtu e kam shtëpinë. Jam krenare që jam shqiptare e Kosovës, por shtëpia është aty ku jeton, ku të pushon zemra dhe shpirti. Punoj në vende të zgjedhura të punës, dhe realizoj të ardhura të mira. E kam motrën më të mirë në botë dhe kam krijuar shoqëri të dashur dhe të sinqertë. Më ka takuar fati me shokun më të mirë të cilin njëkohësisht e kam të dashur. Ai i ka dhënë jetës sime ngjyrë dhe kuptim. Ai më kupton dhe me të mund të bisedoj për gjithçka. Ai ma ka kthyer buzëqeshjen dhe më ka lënë të kuptoj se të gjithë meshkujt nuk janë të njëjtë. E dua shumë, e dua ndoshta më shumë se vetveten, por jo më shumë se Zotin! Se çfarë do të sjellë jeta ime më vonë, nuk e di sepse nuk jam profet, por do të sillem me këta njerëz si me një thesar që është më i shtrenjti në botë sepse këta njerëz më mbajnë në jetë, këta njerëz janë jeta ime.

Meritën po e mbaj në zemër dhe në amulete. 30 dhjetori dhe 9 maji janë ditë të bardha dhe të zeza për mua... Më kujtohet çasti kur isha bërë nënë, edhe pse shumë e re dhe e papërvojë. Në atë moment për pak çaste isha një nënë e lumtur që mbante yllin e vet në gjoks. Për një nënë nuk ka ditë më të bardhe në jetë se kjo! Shumë kam vuajtur dhe jam munduar që të bashkohem prapë një ditë me engjëllushen time, sa po më duket se gjatë asaj kohe kam harruar se ekziston vetëm një Zot i madh, pa vendimin e të cilit nuk arrihet asgjë. Sot po i lutem dhe po i kërkoj falje për atëherë. Gjithçka që vjen nga ai, është e mirëseardhur. Gjithçka që ka ardhur nga njerëzit dhe më ka bërë të vuaj pa masë, ua ktheftë Allahu ashtu siç di vetë dhe siç e kanë merituar secili. Mua, edhe po të më jepet rasti, nuk do t'i bëj kujt keq dhe të padrejtë sepse nuk dua ta ngarkoj shpirtin tim me mëkate të huaja. Secilit do t'i kthehet ajo që ka bërë, dikujt më herët e dikujt më vonë. Ndoshta nuk do t'i përjetojë të gjitha menjëherë, por Zoti nuk është mace që të grithë. Ai ta kthen atëherë kur ti nuk e pret dhe aty ku ty të dhemb më së shumti.

RRËFIM TRONDITËS PËR JETËN E NJERIUT

Sapo mbyll faqen e fundit të këtij rrëfimi, të duket sikur je ngritur prej një ëndrre të keqe dhe menjëherë mendja të shkon te fati njerëzor, fati që i përcaktohet një kolektivi njerëzor, një populli të pambrojtur nga askush, as nga shteti, as nga e drejta universale, as nga vetvetja, madje, dhe që ky fat ngjizet, kur e kur, në jetën tragjike të individit...

Trëndafilja është gjithkush prej nesh, është fati ynë i dhimbshëm, është ajo skemë jete e ndërtuar nga dhunimi, dhunimi prej pushtuesit, dhunimi prej mentalitetit, poshtërimi e marrja nëpër këmbë e jetës së njeriut prej mosdijes dhe injorancës, intrigës e zemërligësisë.

Edhe dashuria e pastër për Shkëlqimin e kësaj vajze që u poq shumë-shumë e re si fruta që piqet herët prej kushteve anormale të natyrës, ra sa hap e mbyll sytë, siç bie sakaq fruta e pjekur para kohe.

Ky rrëfim i kësaj vajze me emrin Trëndafilja, ka tri rreze drite a vegime që rrezatojnë tej përtej librin.

Drita e parë, që vjen prej Shkëlqimit, djalit që Trëndafilja e

deshi me gjithë shpirt, që e përmend nis e sos, por që kurrë nuk u materializua për shkak të rrethanave që ne i përvijua më lart. Pengu i mosputhjes me djalin që deshi e mundon kryepersonazhen që nga fillimi e deri në fund, jo si një akt i zakonshëm njerëzor, por si një mesazh i jetës.

Drita e dytë, është ardhja në jetë e Meritës, fëmijës që i mbush me kuptim jetën e mjerë Trëndafiles, e këtij fëmije që ashtu sikurse e ëma, është e detyruar t'i nënshtrohet fatit kolektiv si në kompleksin e Edipit.

Drita e tretë, është mosdurimi popullor i cili konkretizohet me lindjen e organizmit ushtarak që do të bëjë të mundur ëndrrën shekullore për çlirim, që më në fund do të zhdukë të gjitha këto peripeci që sintetizohen në jetën e personazhit tonë. Mosngurimi, pa mëdyshje, për të qenë edhe ajo pjesëmarrëse e kontribuuese në këtë formacion, dëshmon shpresën e besimin që ka në ardhjen e lirisë së munguar për breza të tërë në vendin ku ka lindur.

Pastaj ky libër nuk ka më dritë jete e shpirti, edhe pse autorja mundohet në faqet e fundit që, si një e verbër, të kërkojë gjilpërën në kashtë, por tanimë idhtësia e jetës e ka përpirë, e ka çuar deri në pragun e çmendurisë.

Është me shumë domethënie që të hulumtojmë në shkaqet e kësaj jete tragjike, jo vetëm të Trëndafiles, por të mijëra trëndafileve shqiptare.

Së pari, shkatërrimi i strukturës familjare i ardhur për shkak të dhunimit fatal të një jete kolektive. Kjo ka ndodhur tragjikisht për fatin e keq tonin si popull. Të dhunuar, të pavlerësuar, të poshtëruar. Kjo qe jeta jonë, e veçanta e karakteristika kolektive. Jetë e cila reflektoi në praktikën e përditshme jetësore. Fëmijë të rritur jetimë me prindër të gjallë, pa praninë e autoritetit prindëror, pa ushqimin e domosdoshëm të edukimit. Kësisoj, pastaj rëndom kanë ndodhur moskuptimet familjare, mungesa e një sistemi të përcaktuar edukimi e mirërritje të brezit të lindur në këto rrethana. E tillë është heroina jonë që ka emrin Trëndafile. Babai i saj është individi i devijuar

prej traditës tonë të edukimit familjar. I pashkolluar, i pakuptuar, i infektuar me virusin e thashethemnajës allashqiptarçe, jo i ngrohtë. Ai nuk e njej fëmijën e tij dhe rrjedhimisht nuk ia di rëndësinë dhe për këtë nuk ka faj. Ai vepron krejt gabimisht kundrejt fëmijës së vet dhe për këtë nuk ka faj. Nuk ka faj, se është pjellë e rrethanave specifike të jetës ku ka lindur, të deformimeve të personalitetit dhe të shkatërrimit të konstitucionit shpirtëror kolektiv të një populli, i cili është i pushtuar dhe i dhunuar fizikisht e psikologjikisht prej një pushtuesi të huaj që nuk ka asnjë pikëlidhje me mentalitetin tonë. Trëndafilja e kupton këtë handicap të babait të saj dhe të sjelljes së tij dhe në fundin e rrëfimit e justifikon në një farë mënyre, sepse ai nuk vepron sipas konceptit të vet, por sipas formimit botëkuptimor shekullor të një populli të tërë. Ai është i paditur, naiv, i pashkolluar dhe i ndikuar dhe i varur plotësisht prej opinionit negativ, ndaj dhe vepron krejt anormalisht me pjellën e vet.

Ky devijim psikologjik kolektiv shihet qartë edhe te pjesëtarët e tjerë të familjes së vet, por edhe të Halimit. Prandaj babai i Trëndafilës përbën tip, i cili ashtu është dhe mund të ndryshojë vetëm nëse ndryshojnë rrethanat sociale në vendin e vet dhe nëse ai ndërpret emigrimin dhe i bashkohet evoluimit të natyrshëm të psikologjisë dhe mentalitetit të popullit të cilit i përket. Dalja në skenë e UÇK dhe e çlirimit të Kosovës është drita në tunelin e errët të jetës së vështirë të shqiptarit nën pushtim.

Së dyti, shprishja e individit që mbartet prej Halimit. Kjo shprishje ndodh kur deformohen shoqëritë. Halimi është mbartës i të këqijave njerëzore. Ai është mashtrues, shpirtkazmë dhe i pamoralshëm. I ka të gjitha të zezat që mund t'i ketë një njeri. Ky shpirt i zhveshur prej virtyteve ia nxin jetën Trëndafilës duke i sjellë tragjeditë varg e vijë. Gruan nuk e sheh si shpirt, por si send me të cilin mund të bëjë ç'të dojë. Gruaja për të është thjesht objekti ku shfryhen epshet shtazarake seksuale, ku demonstron dhuna e egërsia njerëzore që buron prej skutave të errëta të metempsikozës njerëzore. Ky personazh është shembulli më i mirë ku tregohet se si nuk duhet

të jetë njeriu, si nuk duhet të sillet ai. Por mjerisht në mesin tonë ende edhe sot kemi plot të tillë. Ai nuk e gjen veten askund edhe pse i pasur. I dhënë pas jetës së shfrenuar, pas qejfeve mes femrave të përdala, alkoolit dhe tymit të duhanit, fati i tij, sigurisht që do të kishte fund tragjik për Trëndafilën dhe vajzën e saj.

Trëndafilës nuk i mbetet tjetër veçse ta ngushëllojë shpirtin e saj të plagosur te dashuria e paarrirë asnjëherë për Shkëlqimin, te ardhja në jetë e Meritës të cilën kurrë nuk e gëzoi dhe te ndriçimi i shpirtit me spiritualizëm. Të tre këta faktorë i dhanë forca që të ikë prej familjes së të çmendurve dhe ta rinisë jetën si një mision i shenjtë. Te kjo ringritje buron edhe optimizmi për jetën, dashuria për të.

Romani “Lotët e Trëndafilës” kuptohet se nuk është shkruar nga një dorë e sprovuar artisti, gjë që reflektohet qartë që nga mangësitë kompozicionale e deri te përdorimi i fjalës pa ndonjë pretendim artistik. E rëndësishme është se ky libër shkruhet prej dorës së femrës që e ka ndier për së afërmi këtë dramë njerëzore. Prandaj emocioni dhe zemërdridhja e përshkon tej e mbanë rrëfimin, emocion i cili mban peshë secilin që e shfleton këtë libër.

Prishtinë, gusht 2010
Demir Reshiti

SHËNIME PËR AUTOREN

Barbara-Burbuqe Heim, është e lindur më 1 nëntor 1975 në Rahovec. Shkollën fillore dhe dy vjet të shkollës së mesme i ka kryer në vendlindje, ndërkaq prej moshës 18 vjeçare jeton në Gjermani. Burbuqja thotë se në të dy shtetet ndihet si në shtëpi, e lumtur dhe e lirë. Besën shqiptare e ka trashëguar nga vendlindja, ndërsa disiplinën dhe saktësinë në punë nga vendi ku jeton aktualisht. Beson në Zot. Kohën e lirë e kalon duke lexuar, duke shëtitur në natyrë, duke u marrë me sport, e ndonjëherë duke medituar. Thotë se e preferon kuzhinën italiane, i ka merak pemët dhe perimet, e në veçanti shalqirin. Pija e saj e preferuar është uji, sidomos ai i Kosovës. I adhuron të gjitha ngjyrat dhe të gjitha stinët e vitit. Në çdo vend të Kosovës ndihet si në shtëpi të saj, andaj thotë se Kosovën e ka shtëpi! I do dhe i përkrah njerëzit që dinë çfarë duan nga jeta. E urren padrejtësinë, rrenën, egoizmin, paragjykimet dhe korrupsionin.

Shprehja e saj filozofike që e përdor edhe si moto në jetë është: Këmisha e fundit nuk ka xhep dhe as në parajsë nuk është mirë nëse je e vetme!

“Lotët e Trëndafiles” është libri i saj i parë.

U shtyp në shtypshkronjën
BLENDI
Prizren

Katalogizimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare dhe Universitare e Kosovës

821.18-31

Heim, Barbara- Burbuqe

Lotët e Trëndafilit: roman / Barbara-Burbuqe Heim.

Prizren: Fidani, 2010. - 156 f.; 21 cm.

Rrëfim tronditës për jetën e njeriut / Demir Reshiti: f. 151-154.

- Shënime për autoren: f. 155

ISBN 978-9951-444-60-6